



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
Kuvendi

PROJEKT LIGJ

Nr. \_\_\_\_/2026

PËR

EFIÇENCËN ENERGETIKE<sup>1</sup>

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë

V E N D O S I:

KREU I  
PARIME TË PËRGJITHSHME

Neni 1  
Qëllimi

- Qëllimi i këtij ligji është të përcaktojë një kuadër të përgjithshëm masash për promovimin dhe përmirësimin e efiçencës energjetike në Republikën e Shqipërisë.
- Zbatimi i këtyre masave synon arritjen e objektivave kombëtare dhe të detyrimeve të ndërmarra në kuadër të marrëveshjeve ndërkombëtare në fushën e efiçencës energjetike, duke kontribuar në zhvillimin e një ekonomie konkurruese, arritjen e neutralitetit klimatik dhe në rritjen e sigurisë së furnizimit me energji, përmes reduktimit të varësisë nga importet e energjisë dhe burimet fosile.

Neni 2  
Objekti

- Ky ligj ka për objekt:
  - zbatimin e parimit “efiçenca energjetike në krye” në planifikimin dhe vendimmarrjen e sektorit energjetik si dhe në sektorët e tjerë;
  - identifikimin dhe eliminimin e pengesave në tregun e energjisë, si dhe adresimin e mangësive të tregut që pengojnë efiçencën energjetike në furnizimin, transmetimin,

<sup>1</sup>“Ky ligj për afron plotësisht Direktivën (BE) 2023/1791 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 13 Shtator 2023 “Për Efiçencën Energjetike”. Numri CELEX 32023L1791, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, Seria L, nr. 231, datë 20.09.2023, fq. 1-111.”

- shpërndarjen, ruajtjen dhe përdorimin e energjisë;
- c) përcaktimin e objektivave dhe kontributeve kombëtare për kursimin e energjisë dhe rritjen e sigurisë së furnizimit me energji;
  - ç) nxitjen e përdorimit eficient të energjisë dhe rritjen e konkurrueshmërisë së operatorëve;

### **Neni 3 Fusha e zbatimit**

1. Ky ligj do të zbatohet për subjektet e mëposhtme:
  - a) personat juridikë që ushtrojnë veprimtaritë e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes, furnizimit dhe ruajtjes së energjisë;
  - b) personat fizikë dhe/ose juridikë, publikë ose privatë, që janë konsumatorë fundorë të energjisë;
  - c) personat fizikë dhe/ose juridikë që ofrojnë shërbime energjetike dhe zbatojnë masa për përmirësimin e efikasitetit energjetik;
  - ç) organet publike, në kuadër të përmbushjes së detyrimeve të tyre për përmirësimin e efikasitetit energjetik, në përputhje me dispozitat e këtij ligji.

### **Neni 4 Përkufizime**

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Agregatori” është një pjesëmarrës tregu që ushtron aktivitete agregimi;
2. “Auditim energjetik” është procedura që ndiqet për mbledhjen e të dhënave të nevojshme për profilin ekzistues të konsumit të energjisë së një ndërtese ose një grupi ndërtesash, të një objekti dhe/ose instalimi industrial, në pronësi ose përgjegjësi administrimi të një personi juridik, publik ose privat, me qëllim identifikimin dhe përlllogaritjen e kostove dhe kursimeve të energjisë, raportimin e rezultateve dhe evidentimin e masave që duhen marrë në funksion të përmirësimit të efikasitetit të energjisë;
3. “Autoritet kontraktor” ka të njëjtin kuptim sikurse përcaktohet në ligjin në fuqi për prokurimin publik;
4. “Autoritet publik zbatues” është një organ publik i cili është përgjegjës për kryerjen ose monitorimin e taksimit të energjisë ose karbonit, skemat financiare dhe instrumentet, stimujt fiskalë, standardet dhe normat, skemat e etiketimit të energjisë, trajnimit ose edukimit;
5. “Efikasitet energjetik” është raporti i prodhimit të performancës, shërbimit, mallrave ose energjisë ndaj energjisë hyrëse;
6. “Efikasitet i përgjithshëm” është shuma vjetore e prodhimit të energjisë elektrike dhe mekanike dhe prodhimit të nxehtësisë së dobishme, e pjesëtuar me konsumin e karburantit të përdorur për nxehtësinë e prodhuar në një proces koogjenerimi dhe prodhimin bruto të energjisë elektrike dhe energjisë mekanike.
7. “Efikasiteti i Sistemit” është përzgjedhja e zgjidhjeve efikase energjetike aty ku ato gjithashtu mundësojnë një rrugë dekarbonizimi me kosto efektive, fleksibilitet shtesë dhe përdorim eficient të burimeve;
8. “Energji elektrike nga kogjenerimi” është energjia elektrike e prodhuar në një proces të lidhur me prodhimin e nxehtësisë së dobishme dhe llogaritjet në përputhje me parimet e përgjithshme të përcaktuara në shtojcën II;
9. “Energji” është çdo formë energjie e disponueshme në treg, përfshirë energjinë elektrike,

- gazin natyror (përfshirë gazin natyror të lëngshëm), gazin e lëngshëm të naftës, çdo lëndë djegëse për ngrohje dhe ftohje (përfshirë ngrohjen dhe ftohjen e përqendruar e rajonale), qymyrin dhe linjtin, torfën, karburantet për transport (duke përfshirë karburantet e përdorura në aviacion dhe transportin detar), biomasën, energjinë diellore, energjinë e erës, energjinë gjeotermale dhe energjinë nga mbetjet bashkiake;
10. “Energjia e ambientit” ka të njëjtin kuptim sikurse përcaktohet në ligjin në fuqi për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme;
  11. “Entet kontraktore” ka të njëjtin kuptim sikurse përcaktohet në ligjin në fuqi për prokurimin publik.;
  12. “Kërkesë e justifikueshme ekonomikisht” është një kërkesë që nuk i tejkalon nevojat për ngrohje ose ftohje dhe që përndryshe do të kënaqeshin me kushtet e tregut nga energjia me proceset e gjenerimit të ndryshme nga koogjenerimi;
  13. “Kogjenerim” është gjenerimi i njëkohshëm në një proces të energjisë termike dhe energjisë elektrike ose mekanike;
  14. “Kogjenerim me efikasitet të lartë” do të thotë bashkëprodhim që përmbush kriteret e përcaktuara sipas legjisllacionit në fuqi.
  15. “Kompanitë e shitjes me pakicë të energjisë” janë persona fizik ose juridik që i shesin energji klientit fundor;
  16. “Kontrata shërbimesh me përmbajtje të konsiderueshme energjie” janë ato kontrata në të cilat konsumi i energjisë përbën një pjesë të rëndësishme të kostos së përgjithshme ose është element thelbësor i ofrimit të shërbimit;
  17. “Konsumator përfundimtar” është një person fizik ose juridik që blen energji për përdorim përfundimtar;
  18. “Konsumator i madh i energjisë” është një konsumator përfundimtar, i cili ka konsum vjetor të energjisë më të madh se 3 TJ energji ekuivalente në vit.
  19. “Konsumi i energjisë primare” ose “PEC” është energjia bruto e disponueshme, duke përfshirë bunkerët detarë ndërkombëtarë, konsumin përfundimtar jo-energjetik dhe energjinë e ambientit;
  20. “Konsumi i energjisë finale” ose “FEC” është e gjithë energjia e furnizuar në industri, në transport, duke përfshirë konsumin e energjisë në aviacionin ndërkombëtar, për familjet, për publikun dhe shërbimet private, për bujqësinë, për pylltarinë, për peshkimin dhe për sektorë të tjerë të përdorimit përfundimtar, duke përfshirë konsumin e energjisë në bunkerët detarë ndërkombëtarë, energjinë e ambientit dhe dërgesat në sektorin e transformimit dhe në sektorin e energjisë, dhe humbjet për shkak të transmetimit dhe shpërndarjes;
  21. “Kontraktim i performancës së energjisë” është një marrëveshje kontraktuale ndërmjet përfituesit dhe ofruesit të një mase për përmirësimin e efikasitetit të energjisë, e cila verifikohet dhe monitorohet gjatë gjithë kohëzgjatjes së kontratës, ku punimet, furnizimi ose shërbimi paguhet në lidhje me një nivel të kontraktuar të përmirësimit të efikasitetit të energjisë ose një kriter i miratuar i performancës së energjisë, siç janë kursimet financiare;
  22. “Kursime energjie” është një sasi energjie e kursyer e përcaktuar nga matja ose vlerësimi i konsumit, ose të dyja, para dhe pas zbatimit të një mase për përmirësimin e efikasitetit të energjisë, duke siguruar njëkohësisht normalizimin për kushtet e jashtme që ndikojnë në konsumim e energjisë;
  23. “Masë politike” është një dispozitë rregullatore, financiare, fiskale, vullnetare ose informative instrumentale e krijuar dhe zbatuar zyrtarisht në një Shtet Anëtar për të krijuar një mbështetje kornizë, kërkesë ose nxitje për aktorët e tregut për të siguruar dhe blerë energji, shërbimet dhe të ndërmerren masa të tjera për përmirësimin e efikasitetit të energjisë;
  24. “Mikrondërmarrje” është një ndërmarrje sipas ligjit që ka më pak se 10 punonjës dhe vlera

totale e aktiviteteve të saj, përfshirë edhe ato të ndërmarrjeve të lidhura, është më pak se 2 milionë euro;

25. "Ndërmarrje të vogla dhe të mesme" janë të gjitha entitetet që janë ndërmarrje sipas ligjit dhe që kanë më pak se 250 punonjës dhe që kanë një vlerë të përbashkët të totalit të aktiviteteve të tyre, përfshirë edhe ato të ndërmarrjeve të lidhura, është më pak se 50 milionë euro;
26. "Ngrohje dhe ftohje efçente" është një opsion ngrohjeje dhe ftohjeje që, krahasuar me skenarin bazë që pasqyron një situatë normale funksionimi, redukton në mënyrë të matshme konsumin e energjisë primare të nevojshme për të furnizuar një njësi me energji të shpërndarë brenda një kufiri përkatës të sistemit në një mënyrë kosto-efektive, siç vlerësohet në analizën kosto-përfitim të përmendur në këtë Vendim, duke marrë parasysh energjinë e nevojshme për nxjerrjen, shndërrimin, transportin dhe shpërndarjen;
27. "Ngrohje dhe ftohje individuale efçente" është opsioni i furnizimit individual të ngrohjes dhe ftohjes që, në krahasim me ngrohjen dhe ftohjen qendrore efçente, redukton në mënyrë të matshme inputin e energjisë primare jo të rinovueshme që nevojitet për të furnizuar një njësi me energji të shpërndarë brenda një kufiri përkatës të sistemit ose kërkon të njëjtin konsum të energjisë primare jo të rinovueshme por me një kosto më të ulët, duke marrë parasysh energjinë e nevojshme për nxjerrjen, konvertimin, transportin dhe shpërndarjen;
28. "Ngrohje dhe ftohje qendrore efçente" është një sistemi i ngrohjes ose ftohjes qendrore që përmbush kriteret e përcaktuara në nenin 24;
29. "Njësi kogjenerimi" është një njësi që është në gjendje të operojë në opsionin e kogjenerimit;
30. "Njësi kogjenerimi në shkallë të vogël" është një njësi bashkëgjenerimi me kapacitet të instaluar nën 1 MWe;
31. "Njësi mikro-kogjenerimi" është një njësi kogjenerimi me një kapacitet maksimal nën 50 kWe;
32. "Nxehtësi e dobishme" është nxehtësia e prodhuar në një proces kogjenerimi për të kënaqur ekonomikisht kërkesat e justifikueshme për ngrohje ose ftohje;
33. "Ofruer i shërbimit të energjisë" është një person fizik ose juridik që ofron shërbime energjetike ose masa për përmirësimin e efçencës së energjisë në objektin ose ambientet e një konsumatori përfundimtar;
34. "Operatori i Sistemit të Shpërndarjes" ka të njëjtin kuptim sikurse përcaktohet në ligjin Nr 43/2015 të përditësuar "Për sektorin e energjisë elektrike";
35. "Operatori i Sistemit të Transmetimit" ka të njëjtin kuptim sikurse përcaktohet në ligjin Nr 43/2015 të përditësuar "Për sektorin e energjisë elektrike";
36. "Organ publik" ka të njëjtin kuptim sikurse përcaktohet në ligjin Nr 44/2015 "Kodi i procedurave administrative i republikës së shqipërisë";
37. "Palë e besuar" është një person juridik me pushtet të deleguar nga një qeveri ose një tjetër organ publik për të zhvilluar, menaxhuar ose operuar një skemë financimi në emër të qeverisë ose një organi tjetër publik;
38. "Palë e detyruar" është një shpërndarës energjie, një kompani e shitjes me pakicë të energjisë ose një operator të sistemit të transmetimit, i cili është i detyruar nga skemat kombëtare të detyrimit të efçencës së energjisë të përmendura në nenin 11;
39. "Palë pjesëmarrëse" është një ndërmarrje ose organ publik që është zotuar për arritjen e objektivave të caktuara sipas një marrëveshjeje vullnetare, ose që mbulohet nga një instrument politik rregullator.;
40. "Parimi "Efçenca në krye"" parimi sipas të cilit, në procesin e planifikimit të energjisë, si dhe gjatë hartimit të politikave dhe marrjes së vendimeve për investime, merret në konsideratë në mënyrë parësore zbatimi i masave alternative për rritjen e efçencës së

energjisë që janë me kosto të përballueshme, me qëllim optimizimin e kërkesës dhe furnizimit me energji.

41. “Përdorues përfundimtar” është një person fizik ose juridik që blen ngrohje, ftohje ose energji për ngrohje të ujit sanitar për përdorimin e tyre përfundimtar, ose një person fizik ose juridik që zë një ndërtesë individuale ose një njësi në një ndërtesë me shumë apartamente ose me shumë qëllime e pajisur me ngrohje, ftohje ose ujë të ngrohtë sanitar nga një burim qendror, ku një person i tillë nuk ka direkt apo individual kontrata me furnizuesin e energjisë;
42. “Përmirësimi i efikasitetit të energjisë” është një rritje e efikasitetit energjetik si rezultat i ndonjë ndryshimi teknologjik, të sjelljes ose ekonomik;
43. “Pjesë statistikisht e rëndësishme dhe mostër përfaqësuese e masave të përmirësimit të efikasitetit të energjisë” është një proporcion dhe mostër e tillë që kërkon krijimin e një nëngrupi të një popullate statistikore të masave të kursimit të energjisë në pyetje në mënyrë të tillë që të pasqyrojë të gjithë popullsinë e të gjitha masave të kursimit të energjisë, dhe kështu të lejojë për përfundime të arsyeshme të besueshme në lidhje me besimin në tërësinë e masave;
44. “Qendër të Dhënash” (Data Center) përcaktohet si një qendër e specializuar fizike ose mjedisi virtual i cili përdoret për të ruajtur dhe menaxhuar të dhënat kompjuterike dhe burimet e tjera të komunikimit, të tilla si serverat, rrjete, dhe pajisjet e tjera të nevojshme për operimin e sistemeve të teknologjisë së informacionit. Qendrat e të Dhënave janë ambiente të sigurta dhe të mbrojtura, të cilat ofrojnë kushte të përshtatshme për ruajtjen dhe përpunimin e të dhënave në shkallë të madhe. Këto qendra janë të përdorura për shërbime të rrjetit, shpërndarjen e përmbajtjes, ruajtjen e të dhënave, backup, dhe shërbime të tjera të lidhura me IT. Përdorimi i qendrave të të dhënave është i zakonshëm në industrinë e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit;
45. “Raporti fuqi ndaj ngrohjes” është raporti i energjisë elektrike nga bashkëprodhimi ndaj nxehtësisë së dobishme kur operimi në opsionin e kogjenerimit të plotë duke përdorur të dhënat operative të njësisë specifike;
46. “Rinovim i konsiderueshëm” është një rinovim ku kostoja e të cilit kalon 50% të kostos së investimit për një njësi të re;
47. “Shërbim energjetik” është përfitimi fizik, dobia, ose e mira që rrjedh nga një kombinim i energjisë me teknologjinë me efikasitet energjetik ose me veprim, i cili mund të përfshijë operacionet, mirëmbajtjen dhe kontrollin e nevojshëm për të ofruar shërbimin, i cili ofrohet në bazë të një kontratë dhe në rrethana normale kanë rezultuar të verifikueshme dhe të matshme ose përmirësim i vlerësuar i efikasitetit të energjisë ose kursime primare të energjisë;
48. “Shpërndarës i energjisë” është një person fizik ose juridik, duke përfshirë një operator të sistemit të shpërndarjes, i cili është përgjegjës për transportimin e energjisë me qëllim dërgimin e saj te klientët fundorë ose te stacionet e shpërndarjes që shesin energji te klientët fundorë;
49. “Sipërfaqja totale e dobishme e dyshemesë” është sipërfaqja e dyshemesë të një ndërtesë, ose një pjesë të një ndërtesë, ku energjia përdoret për të kushtëzuar klimën e brendshme;
50. “Sistemi energjetik” është një sistem i projektuar kryesisht për të furnizuar shërbime energjetike për të kënaqur kërkesat e sektorëve të përdorimit përfundimtar për energji në formën e ngrohjes, lëndëve djegëse dhe energjisë elektrike;
51. “Sistemi i matjes inteligjente” ka të njëjtin kuptim sikurse përcaktohet në ligjin në fuqi për sektorin e energjisë elektrike, për sistemet e energjisë elektrike dhe në ligjin në fuqi për sektorin e gazit natyror, për sistemet e furnizimit me gaz natyror;
52. “Sistemi i menaxhimit të energjisë” është një grup elementësh të ndërlidhur ose ndërveprues të një strategjie e cila përcakton një objektiv të efikasitetit të energjisë dhe një

- plan për të arritur këtë objektiv, duke përfshirë monitorimin e konsumit aktual të energjisë, veprimet e ndërmarra për rritjen e efikasitetit të energjisë dhe matjen e progresit;
53. “Standard ndërkombëtar” është një standard i miratuar nga Organizata Ndërkombëtare për Standardizimin, i cili vihet në dispozicion për përdorim publik;
  54. “Standard Evropian” është një standard i miratuar nga Komiteti Evropian për Standardizimin, Komiteti Evropian për Standardizim Elektroteknik ose Instituti Evropian i Standardeve të Telekomunikacionit, i cili vihet në dispozicion për përdorim publik;
  55. “Stimuj të ndarë” është mungesa e shpërndarjes së drejtë dhe të arsyeshme të detyrimeve financiare dhe shpërblimet në lidhje me investimet në efikasitetin e energjisë midis aktorëve të interesuar, për shembull pronarët dhe qiramarrësit ose pronarët e ndryshëm të njësisë të ndërtesave, ose pronarët dhe qiramarrësit ose pronarët e ndryshëm të ndërtesave me shumë apartamente ose me shumë qëllime;
  56. “Strategjia e angazhimit” është një strategji që përcakton objektivat, zhvillon teknika dhe përcakton procesin me të cilin përfshihen të gjithë aktorët përkatës në nivel kombëtar ose nivel lokal, duke përfshirë përfaqësuesit e shoqërisë civile si organizatat e konsumatorëve, në politikë bërjen e procesit, me qëllim rritjen e ndërgjegjësimit dhe marrjen e reagimeve për politika të tilla dhe përmirësimin e pranimit të tyre në publik;
  57. “Varfëri energjetike” është mungesa e aksesit të një familjeje në shërbimet thelbësore të energjisë, ku shërbime të tilla ofrojnë nivele bazë dhe standarde të mira të jetesës dhe të shëndetit, duke përfshirë ngrohje adekuate, ujë të nxehtë, ftohje, ndriçim dhe energji për të fuqizuar pajisjet, në kontekstin përkatës kombëtar, politikën sociale ekzistuese kombëtare dhe të tjera politika përkatëse kombëtare, të shkaktuara nga një kombinim faktorësh, duke përfshirë të paktën mospërbalueshmërinë, të ardhura të pamjaftueshme të disponueshme, shpenzime të larta të energjisë dhe efikasitet të dobët të energjisë në banesa;
  58. “Veprim individual” është një veprim që çon në përmirësime të verifikueshme dhe të matshme ose të vlerësueshme, të efikasitetit të energjisë dhe që ndërmerret si rezultat i një mase politike.

## **KREU II**

### **OBJEKTIVAT DHE PARIMI I POLITIKAVE TË EFIÇENCËS ENERGJETIKE**

#### **Neni 5**

#### **Parimi “Efikasiteti energjetik në krye”**

1. Parimi “Efikasiteti energjetik në krye” përcakton trajtimin e efikasitetit energjetik si një element thelbësor për t’u konsideruar në mënyrë sistematike përpara realizimit të çdo procedure që lidhet me planifikimin energjetik, hartimin e politikave dhe planeve kombëtare si dhe vendimmarrjen për investime.
2. Zbatimi i parimit sipas pikës 1, realizohet përmes identifikimit dhe vlerësimit të masave alternative, të cilat sjellin përfitime ekonomike, teknike apo mjedisore, dhe që zëvendësojnë pjesërisht ose plotësisht masat e parashikuara të planifikimit, politikave dhe investimeve, pa ndryshuar objektivat e vendimeve përkatëse.
3. Në përputhje me pikat 1 dhe 2 të këtij neni, organet publike marrin masa që të sigurojnë që zgjidhjet e efikasitetit të energjisë, përfshirë veprimet që rregullojnë konsumin energjetik të konsumatorëve fundorë sipas nevojave të sistemit si dhe aftësinë e sistemit energjetik për t’u përshtatur me ndryshimet në furnizimin dhe kërkesën për energji, të vlerësohen në proceset e planifikimit, hartimit të politikave dhe vendimmarrjes për investime të mëdha, me një vlerë mbi 9 miliard lekë për secilin rast, ose mbi 16 miliard lekë për projektet e infrastrukturës së transportit, në sektorët si në vijim:
  - a) sektorin energjetik – që përfshinë prodhimin, transmetimin, shpërndarjen dhe

- përdorimin fundor të energjisë;
- b) në sektorët joenergjetik – ku këta sektorë kanë ndikim në konsumin e energjisë dhe efikasitetin e energjisë si:
    - i. transporti;
    - ii. ujësjellës kanalizime;
    - iii. sektorin publik dhe komercial;
    - iv. ndërtesat;
    - v. industria;
    - vi. bujqësia;
    - vii. infrastruktura dhe teknologjitë e komunikimit dhe informimit.
4. Në të njëjtën mënyrë me organet publike, institucionet financiare publike dhe subjektet financiare që operojnë në Republikën e Shqipërisë marrin në konsideratë parimin “efikasiteti energjetik në krye” në financimin e projekteve që ndikojnë në konsumin e energjisë, në përputhje me këtë ligj dhe aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij.
  5. Këshilli i Ministrave, me propozim të ministrit përgjegjës për energjinë, miraton rregullat, procedurat dhe metodologjinë për zbatimin e parimit “efikasiteti energjetik në krye”.
  6. Vendimi sipas pikës 5 të këtij neni, ndër të tjera:
    - a) promovon dhe siguron zbatimin e parimit “efikasiteti energjetik në krye”;
    - b) përcakton zbatimin e metodologjive për vlerësimin e zgjidhjeve rentabël të efikasitetit energjetik, si dhe garanton publikimin e tyre, me qëllim vlerësimin e plotë të përfitimeve që sjellin, duke marrë parasysh koston gjatë gjithë ciklit jetësor, perspektivën afatgjatë, efikasitetin e sistemit dhe të kostove, sigurinë e furnizimit, si dhe ndikimet shoqërore, shëndetësore, ekonomike dhe mjedisore, në përputhje me objektivat e qëndrueshmërisë dhe tranzicionit drejt neutralitetit klimatik;
    - c) përcakton kërkesa për vlerësimin dhe adresimin e ndikimit të masave në varfërinë energjetike.
    - ç) përcakton mekanizmat për monitorimin e zbatimit të parimit “efikasiteti energjetik në krye” dhe për identifikimin e barrierave rregullatore dhe jorregullatore që pengojnë zbatimin e tij;
  7. Agjencia përgjegjëse për efikasitetin energjetik monitoron zbatimin e parimit “efikasiteti energjetik në krye”, si dhe vlerëson ndikimin e kuadrit rregullator, përfshirë rregullat financiare, planifikimin, politikën dhe vendimet e investimeve sipas pikës 3 të këtij neni, në konsumin e energjisë, efikasitetin energjetik dhe sistemet energjetike.
  8. Agjencia përfshin në raportin vjetor mbi efikasitetin energjetik sipas nenit 52, të këtij ligji, informacionin mbi zbatimin e parimit “efikasiteti energjetik në krye”.
  9. Bazuar në informacionin e raportuar nga Agjencia përgjegjëse për efikasitetin energjetik, ministria përgjegjëse për energjinë i raporton Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë, në kuadër të raporteve kombëtare të progresit për energjinë dhe klimën, informacion mbi mënyrën se si parimi “efikasiteti energjetik në krye” është marrë parasysh në planifikimin, politikën dhe vendimet për investime të mëdha në nivel kombëtar dhe, kur është e zbatueshme, në nivel rajonal dhe vendor, që lidhen me sistemet kombëtare dhe rajonale të energjisë.

## **Neni 6**

### **Objektivat kombëtare për efikasitetin energjetik**

1. Republika e Shqipërisë kontribuon në arritjen e objektivave për efikasitetin e energjisë në përputhje me detyrimet që rrjedhin nga acquis i Traktatit të Komunitetit të Energjisë.
2. Me qëllim zbatimin e pikës 1 të këtij neni, Këshilli i Ministrave përcakton kontributin

kombëtar për efikasitetin energjetik i cili:

- a) shprehet në terma të konsumit final të energjisë;
  - b) shoqërohet me një vlerë absolute të konsumit primar të energjisë;
  - c) përfshin një trajektore orientuese për arritjen e tij.
3. Në përcaktimin e kontributit kombëtar, merren në konsideratë:
- a) objektivi i konsumit final të energjisë dhe objektivi i konsumit primar të energjisë sikurse përcaktohet nga Sekretariati i Komunitetit të Energjisë;
  - b) masat e parashikuara në legjislacionin për efikasitetin energjetik, përfshirë ligjin për performancën energjetike të ndërtesave dhe aktet nënligjore në zbatim të tyre;
  - c) masa të tjera ekzistuese dhe të planifikuara për promovimin e efikasitetit energjetik, në nivel kombëtar dhe në kuadër të Traktatit të Komunitetit të Energjisë;
  - ç) faktorë të tjerë të rëndësishëm që ndikojnë në përpjekjet për përmirësimin e efikasitetit të energjisë si:
    - i. përpjekjet dhe masat e ndërmarra më parë në fushën e efikasitetit të energjisë;
    - ii. nevojën për një shpërndarje të drejtë dhe të balancuar të përpjekjeve, në përputhje me detyrimet që rrjedhin nga Traktati i Komunitetit të Energjisë;
    - iii. intensitetin energjetik të ekonomisë;
    - iv. potencialin e mbetur të kursimeve të energjisë, që janë ekonomishtë të justifikueshme.
  - d) rrethana të tjera kombëtare që ndikojnë në konsumin e energjisë, në veçanti:
    - i. zhvillimet dhe projeksionet makroekonomike, përfshirë produktin e brendshëm bruto dhe ndryshimet demografike;
    - ii. ndryshimet në importet dhe eksportet e energjisë, si dhe zhvillimet në përzierjen energjetike dhe përdorimin e karburanteve të qëndrueshme;
    - iii. zhvillimet në burimet e rinovueshme energjetike, energjinë bërthamore si dhe në teknologjitë e kapjes dhe ruajtjes së dioksidit të karbonit;
    - iv. dekarbonizimin e sektorëve me intensitet të lartë energjie;
    - v. nivelin e ambicies në politikat dhe planet kombëtare për dekarbonizimin dhe arritjen e neutralitetit klimatik;
    - vi. potencialin ekonomik të kursimeve të energjisë;
    - vii. kushtet klimatike aktuale dhe projeksionet për ndryshimet klimatike.
4. Si pjesë e kontributit kombëtar për efikasitetin e energjisë, ministria përgjegjëse për energjinë siguron që të përcaktohen dhe raportohen:
- a) pjesët përkatëse të konsumit primar dhe final të energjisë sipas sektorëve të përdorimit fundor, përfshirë, të paktën sektorin:
    - i. industrial;
    - ii. rezidencial;
    - iii. e shërbimeve;
    - iv. e transportit;
  - b) projeksionet e konsumit të energjisë në sektorin e teknologjive të informacionit dhe komunikimit (TIK).
5. Kontributi kombëtar dhe trajektorja respektive përcaktohen në Planin Kombëtar për Energjinë dhe Klimën (NECP), si dhe në përditësimet periodike të tij, në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi për mekanizmin qeverisës dhe i dërgohen për bashkërendim Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë.
6. Sekretariati i Komunitetit të Energjisë vlerëson projekt-vendimin e Planit Kombëtar për Energjinë dhe Klimën dhe nëse kontributi kombëtar i Republikës së Shqipërisë për

- efiçencën e energjisë është i mjaftueshëm për të kontribuar në arritjen e objektivave të Komunitetit të Energjisë, në përputhje me detyrimet që rrjedhin nga Traktati i Komunitetit të Energjisë.
7. Në rast se, në bazë të këtij vlerësimi, konstatohet se kontributi kombëtar është i pamjaftueshëm, Sekretariati i Komunitetit të Energjisë paraqet rekomandime përkatëse.
  8. Ministria përgjegjëse për energjinë merr në konsideratë rekomandimet e Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë dhe i reflekton ato në përditësimin e Planit Kombëtar për Energjinë dhe Klimën, si dhe në masat përkatëse për arritjen e kontributit kombëtar.
  9. Në rast se, në bazë të vlerësimeve të kryera kryesisht ose nga Sekretariati i Komunitetit të Energjisë, konstatohet se progresi drejt arritjes së kontributit kombëtar për efiçencën e energjisë është i pamjaftueshëm, ministria përgjegjëse për energjinë merr masat e nevojshme për të siguruar rikthimin në trajektoren e përcaktuar.
  10. Masat sipas pikës 9 të këtij neni, mund të përfshijnë, ndër të tjera:
    - a) forcimin e politikave dhe masave që gjenerojnë kursime shtesë të energjisë, përfshirë mbështetjen për zhvillimin e projekteve të investimeve në efiçencën e energjisë;
    - b) rishikimin dhe rritjen e detyrimeve për kursimet e energjisë;
    - c) rregullimin e detyrimeve për sektorin publik në përmirësimin e performancës energjetike;
    - ç) rritjen e mbështetjes financiare për efiçencën e energjisë, përfshirë kontributin në Fondin Kombëtar të Efiçencës Energjetike, në vijim Fondi, ose instrumentet financiare të tjera.
  11. Masat shtesë përcaktohen në mënyrë proporcionale me shkallën e devijimit nga trajektorja dhe reflektohen në përditësimet e Planit Kombëtar për Energjinë dhe Klimën dhe dokumentet përkatëse strategjike.
  12. Në rast se konsumi final i energjisë tejkalon trajektoren orientuese, ministria përgjegjëse për energjinë përfshin në raportin e progresit për Planin Kombëtar për Energjinë dhe Klimën:
    - a) një shpjegim të devijimit nga trajektorja e përcaktuar;
    - b) masat që do të ndërmerren për të mbuluar diferencën dhe për të siguruar arritjen e kontributit kombëtar për efiçencën e energjisë;
    - c) vlerësimin e kursimeve të energjisë që pritet të realizohen nga këto masa.
  13. Ministri përgjegjës për energjinë miraton udhëzimin për llogaritjen e kontributit kombëtar të efiçencës energjetike.
  14. Gjatë zbatimit të kërkesave të përcaktuara në pikën 3 të këtij neni, ministria përgjegjëse për energjinë siguron që kontributi kombëtar në Mtoe të mos jetë më shumë se 2,5% mbi atë që rezulton nga përlllogaritja sipas pikës 13 të këtij neni.

### **KREU III**

#### **MODELI SHEMBULLOR I SEKTORIT PUBLIK**

##### **Neni 7**

##### **Efiçenca energjetike në sektorin publik**

1. Duke filluar nga data 11 Tetor 2027, konsumi final total i energjisë i të gjitha organeve publike, të marra së bashku, reduktohet çdo vit me të paktën 1.9%, krahasuar me vitin 2021.
2. Agjencia përgjegjëse për efiçencën energjetike përcakton dhe llogarit referencën krahasuese të konsumit energjetik në përputhje me metodologjinë e miratuar me urdhër të ministrit përgjegjës për energjinë.
3. Metodologjia e përcaktuar në pikën 2 të këtij neni përfshin:

- a) përcaktimin dhe llogaritjen e referencës krahasuese të konsumit energjetik;
  - b) matjen, verifikimin dhe raportimin e kursimeve vjetore të energjisë;
  - c) përcaktimin e faktorëve korigjues, përfshirë variacionet klimatike dhe faktorë të tjerë që ndikojnë në konsumin e energjisë.
4. Në llogaritjen e referencës krahasuese të konsumit të energjisë nuk përfshihet energjia e përdorur nga:
- a) sektori i transportit publik;
  - b) forcat e armatosura;
  - c) organet publike në njësitë e qeverisjes vendore me popullësi më të vogël se 50'000 banorë deri më 31 dhjetor 2026.
  - ç) organet publike në njësitë e qeverisjes vendore me popullësi më të vogël se 5'000 banorë deri më 31 dhjetor 2029.
5. Pavarësisht se sektorët ose organet publike sipas pikës 4 të këtij neni nuk përfshihen në përcaktimin e referencës krahasuese të konsumit të energjisë, kursimet e energjisë të arritura në to merren në konsideratë për përmbushjen e detyrimeve për reduktimin e konsumit të energjisë.
6. Ministria përgjegjëse për energjinë merr masa që në dokumentet strategjike dhe planet kombëtare për energjinë dhe klimën të përfshihet reduktimi i konsumit energjetik në sektorin publik, i ndarë sipas sektorëve përkatës, si dhe masat e planifikuara për arritjen e këtij objekti.
7. Gjithashtu në përputhje me Nenin 14/1, të ligjit nr. 155/2020 “Për ndryshimet klimatike”, të ndryshuar, njësitë e qeverisjes vendore, në hartimin ose përditësimin e planeve vendore për energjinë, klimën dhe përshtatjen, përfshijnë masa konkrete për përmirësimin e efijencës energjetike në të gjithë sektorët e shërbimeve bashkiake.
8. Hartimi dhe përditësimi i këtyre planeve kryhet nëpërmjet proceseve të konsultimit me palët e interesuara dhe publikun, duke përfshirë në mënyrë të veçantë grupet vulnerabël të prekura nga varfëria energjetike.
9. Gjatë hartimit dhe zbatimit të masave për përmirësimin e efijencës energjetike, identifikohen dhe merren masa për zbutjen e ndikimeve të mundshme negative, të drejtpërdrejta ose të tërthorta, mbi familjet në varfëri energjetike, familjet me të ardhura të ulëta dhe grupet vulnerabël.
10. Ministria përgjegjëse për energjinë, në bashkëpunim me agjencinë përgjegjëse për efijencën energjetike, mbështet organet publike në zbatimin e masave për përmirësimin e efijencës së energjisë përmes:
- a) rritjes së kapaciteteve nëpërmjet trajnimeve;
  - b) përgatitjes së udhëzimeve, programeve kompjuterike dhe metodologjive;
  - c) zhvillimit dhe përforcimit të kompetencave në mbledhjen e të dhënave, planifikimin energjetik dhe zbatimin e proceseve të monitorimit, raportimit dhe verifikimit
11. Organet publike marrin në konsideratë, në aktivitetet e tyre investuese dhe në hartimin e politikave, emetimet e karbonit gjatë ciklit të jetës, si dhe përfitimet ekonomike dhe sociale. Zbatimi i kësaj pike mbështetet në udhëzimet dhe metodologjitë përkatëse, përfshirë udhërrëfyesin për prokurimin publik të gjelbër dhe llogaritjen e kostos gjatë ciklit jetësor.
12. Organet publike përmirësojnë performancën energjetike të ndërtesave në pronësi ose në përdorim të tyre, në përputhje me legjislacionin në fuqi për performancën energjetike të ndërtesave, përfshirë zëvendësimin e sistemeve të vjetra dhe joeficiente të ngrohjes.

13. Ministria përgjegjëse për energjinë, në bashkëpunim me Agjencinë përgjegjëse për Eficiencën energjetike, monitoron dhe raporton në Sekretariatit e Komunitetit të Energjisë, mbi reduktimin vjetor të konsumit final të energjisë në sektorin publik si dhe në kuadër të raportimit të progresit mbi zbatimin e Planit Kombëtar për Energjinë dhe Klimën.

## **Neni 8**

### **Roli shembullor i ndërtesave të organeve publike**

1. Ndërtesat në pronësi ose në përdorim të organeve publike luajnë një rol shembullor në zbatimin e masave për përmirësimin e eficiencës energjetike.
2. Për këtë qëllim, çdo vit rinovohet të paktën 3% (tre për qind) e sipërfaqes totale të ndërtesave me ngrohje dhe/ose ftohje, në pronësi dhe të zëna prej organeve publike, me qëllim përmirësimin e performancës energjetike në përputhje me kërkesat për ndërtesa pa emetime sipas legjislacionit në fuqi për performancën energjetike të ndërtesave.
3. Me qëllim arritjen e objektivit të përcaktuar në pikën 2, të këtij neni, Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për energjinë, miraton programin kombëtar për rinovimin e ndërtesave publike dhe rregullat e detajuara për përmbushjen e rolit shembullor të ndërtesave të organeve publike.
4. Vendimi i Këshillit të Ministrave i përcaktuar në pikën 3 të këtij neni përfshin, ndër të tjera:
  - a) drejtimet kryesore, prioritetet, fazat e zbatimit, institucionet përgjegjëse, burimet e mundshme të financimit dhe mekanizmat e monitorimit të programit kombëtar për rinovimin e ndërtesave publike;
  - b) rregullat për përzgjedhjen e ndërtesave që përfshihen në procesin e rinovimit, duke marrë në konsideratë analizën multi-kriteriale teknike dhe atë financiare të raportit përfitim-kosto të masave të rinovimit të ndërtesave;
  - c) kërkesat për kategoritë e ndërtesave të përcaktuara në vijim, të cilat mund të jenë të ndryshme nga ato të përcaktuara në pikën 2 të këtij neni;
    - i. ndërtesat e mbrojtura zyrtarisht si pjesë e një zone të caktuar ose për shkak të vlerave të veçanta arkitekturore ose historike, në rastet kur përmbushja e kërkesave për performancën energjetike cenon në mënyrë të papranueshme karakterin ose pamjen e tyre;
    - ii. ndërtesat në pronësi të forcave të armatosura ose të qeverisë qendrore, të përdorura për qëllime të mbrojtjes kombëtare, pa përfshirë ndërtesat individual të banimit dhe ndërtesat e përdorura për qëllime zyre për forcat e armatosura dhe personelin e punësuar nga autoritetet e mbrojtjes;
    - iii. ndërtesat e adhurimit dhe ato të përdorura për aktivitete të tjera fetare;
  - ç) kriteret, metodologjitë dhe procedurat për identifikimin e rasteve kur ndërtimi i ndërtesave të reja është me përfitime më të mëdha se kostot dhe më i qëndrueshëm në aspektin e konsumit të energjisë dhe emetimeve të CO<sub>2</sub> gjatë ciklit të jetës, krahasuar me rinovimin e ndërtesave ekzistuese
  - d) rregullat për krijimin dhe publikimin e inventarit të ndërtesave me ngrohje dhe/ose ftohje në pronësi ose në përdorim të organeve publike, me sipërfaqe të dobishme mbi 250 m<sup>2</sup>, i cili përmban të paktën:
    - i. sipërfaqen e dobishme të ndërtesës, në metra katrorë (m<sup>2</sup>);
    - ii. konsumin vjetor të matur të energjisë për ngrohje, ftohje, energji elektrike dhe ujë të ngrohtë sanitar, kur këto të dhëna janë të disponueshme;
    - iii. certifikatën e performancës energjetike për secilën ndërtesë, të lëshuar në përputhje me legjislacionin në fuqi për performancën energjetike të ndërtesave.

5. Banesat sociale përjashtohen nga detyrimi për t'u rinovuar sipas pikës 2 të këtij neni, në rastet kur këto ndërhyrje nuk janë me leverdi financiare ose çojnë në rritje të kostove për banorët.
6. Përjashtimi nuk zbatohet në rastet kur rritja e kostove për banorët është e barabartë ose më e ulët se kursimet ekonomike të arritura në faturat e energjisë.
7. Në rastet kur organet publike përdorin ndërtesa që nuk janë në pronësi të tyre, ato janë të detyruara të negociojnë me pronarin e ndërtesës, në veçanti në momentet e rinovimit të kontratës së qirasë, ndryshimit të përdorimit ose gjatë kryerjes së punimeve të rëndësishme të mirëmbajtjes apo riparimit, me qëllim përfshirjen e klauzolave kontraktuale për transformimin e ndërtesës në ndërtesë pa emetime.
8. Objektivi prej të paktën 3% (tre për qind) llogaritet mbi sipërfaqen totale të ndërtesave me sipërfaqe të dobishme mbi 250 m<sup>2</sup>, në pronësi të organeve publike, të cilat nuk përmbushin kërkesat e performancës energjetike për ndërtesat pa emetime.
9. Inventari sipas shkronjës "d" të pikës 4 të këtij neni hartohet nga agjencia përgjegjëse për efikasitetin energjetik dhe përditësohet të paktën çdo dy vjet. Inventari lidhet me të dhënat për stokun e ndërtesave dhe planet e rinovimit të ndërtesave, në përputhje me legjislacionin në fuqi për performancën energjetike të ndërtesave dhe bazat përkatëse të të dhënave si dhe shërben si bazë për monitorimin dhe raportimin e progresit në përmirësimin e performancës energjetike të ndërtesave publike.
10. Organet publike mund të vendosin të mos rinovojnë ndërtesa të caktuara, në rastet kur vlerësohet se transformimi i tyre nuk është teknikisht, ekonomikisht ose funksionalisht i realizueshëm sipas rregullave të përcaktuara në vendimin e pikës 3 të këtij neni.
11. Në këto raste, ndërtesat përkatëse nuk përfshihen në llogaritjen e objektivit të përcaktuar në pikën 2 të këtij neni.
12. Në rastet kur në një vit të caktuar rinovohet një sipërfaqe më e madhe se 3% (tre për qind) e sipërfaqes totale të ndërtesave në përputhje me pikën 2 të këtij neni, diferenca mbi këtë nivel mund të përdoret për përmbushjen e objektivit vjetor të viteve pasuese. Për periudhën deri më 31 dhjetor 2026, kjo diferencë mund të përdoret për tre vitet pasuese, ndërsa për periudhën pas 1 janarit 2027, për dy vitet pasuese.
13. Ndërtesat e reja në pronësi të organeve publike merren në konsideratë për përmbushjen e objektivit vjetor të rinovimit, në rastet kur ato zëvendësojnë ndërtesa të prishura të organeve publike brenda dy viteve të mëparshme.
14. Kjo zbatohet vetëm kur, mbi bazën e një vlerësimi të dokumentuar, ndërtimi i ndërtesave të reja është më kosto-efektiv dhe më i qëndrueshëm në aspektin e konsumit të energjisë dhe emetimeve të CO<sub>2</sub> gjatë ciklit të jetës, krahasuar me rinovimin e ndërtesave ekzistuese.
15. Kriteret, metodologjitë dhe procedurat e përgjithshme për të identifikuar rastet sipas pikave 13 dhe 14 miratohen me urdher të ministrit përgjegjës për energjinë.

## **Neni 9**

### **Efiçenca energjetike në prokurimin publik**

1. Autoritetet dhe entet kontraktuese gjatë lidhjes së kontratave publike dhe koncesioneve me vlerë të njëjtë ose më të madhe se kufijtë e lartë monetarë të përcaktuara në legjislacionin për prokurimin publik, prokurojnë vetëm produkte, shërbime, ndërtesa dhe punime me performancë të lartë energjetike sipas kërkesave specifike në vijim:
  - a) kur një produkt mbulohet nga një akt nënligjor i miratuar sipas nenit 7, të Ligjit Nr. 52/2024 "Për etiketimin e produkteve me ndikim në energji", autoritetet

kontraktore prokurojnë dy klasat më të larta të efijencës së energjisë, të disponueshme gjerësisht, ose klasat më të larta siç përcaktohet në aktet nënligjore për produkte specifike.

- b) kur një produkt që nuk mbulohet nga shkronja (a) mbulohet nga një masë zbatuese sipas ligjit që përcakton kërkesat e projektimit ekologjik për produkte të qëndrueshme, prokurojnë vetëm produkte që përputhen me kufinj të efijencës energjetike të specifikuar në atë masë zbatuese respektive;
  - c) kur një produkt ose një shërbim mbulohet nga kriteret e prokurimit publik të gjelbër ose nga kriteret ekuivalente kombëtare të disponueshme, që lidhen me treguesin e përcaktuar të efijencës energjetike të produktit ose shërbimit, autoritetet kontraktore prokurojnë vetëm produkte dhe shërbime që respektojnë të paktën standardet teknike të përcaktuara në nivel "thelbësor" në kriteret përkatëse të prokurimit publik të gjelbër të Bashkimit Evropian ose kriteret kombëtare të disponueshme ekuivalente, duke përfshirë, ndër të tjera, qendrat e të dhënave, dhomat e serverëve dhe shërbimet cloud, ndriçimin rrugor dhe sinjalet e trafikut, kompjuterat, monitorët e tabletave dhe telefonave inteligjent;
  - ç) të prokurojnë vetëm goma që përputhen me kriterin për të patur klasën më të lartë të efijencës së konsumit të karburantit sipas aktit nënligjor të miratuar sipas nenit 7, të Ligjit Nr. 52/2024 "Për etiketimin e produkteve me ndikim në energji". Ky detyrim nuk do të pengojë organet publike të blejnë goma me klasën më të lartë të kapjes në lagështirë ose me klasën më të ulët të zhurmës së jashtme të rrotullimit kur justifikohet nga arsye sigurie ose shëndeti publik;
  - d) të kërkojnë në tenderët për kontratat e shërbimit, që ofruesit e shërbimeve të përdorin, për qëllime të ofrimit të shërbimeve në fjalë, vetëm produkte që përputhen me shkronjat (a), (b) dhe (ç). Kjo kërkesë zbatohet vetëm për produktet e reja të blera nga ofruesit e shërbimeve pjesërisht ose tërësisht për qëllimin e ofrimit të shërbimit që prokurohet.
  - dh) të blejnë ose të bëjnë marrëveshje të reja qiraje për ndërtesa që përputhen të paktën me nivelin e performancës energjetike të ndërtesave pa emetime, përveç rasteve kur qëllimi i blerjes është:
    - i. për t'iu nënshtruar një rinovimi të konsiderueshëm ose shkatërrimit;
    - ii. në rastin e organeve publike, për të rishitur ndërtesën pa e përdorur atë për qëllimet e veta; ose
    - iii. për ta ruajtur ndërtesën si një objekt të mbrojtur zyrtarisht si pjesë e një zone të caktuar ose për shkak të vlerave të saj të veçanta arkitekturore ose historike.
2. Autoritetet dhe entitetet kontraktuese, gjatë lidhjes së kontratave publike dhe koncesioneve me vlerë të barabartë ose më të madhe se pragjet e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, zbatojnë parimin "efijenca energjetike në krye", në përputhje me nenin 5, të këtij neni, përfshirë edhe në rastet kur për këto kontrata ose koncesione nuk parashikohen kërkesa specifike sipas pikës 1 të këtij neni.
3. Autoritetet dhe entitetet kontraktuese, gjatë prokurimit të kontratave të shërbimeve me përmbajtje të konsiderueshme energjie, vlerësojnë fizibilitetin e lidhjes së kontratave afatgjata të performancës energjetike që sigurojnë kursime afatgjata të energjisë.
4. Autoritetet dhe entitetet kontraktuese, kur është e përshtatshme dhe në përputhje me kërkesat përkatëse, marrin në konsideratë kriteret e prokurimit publik të gjelbër të Bashkimit Evropian ose kriteret ekuivalente kombëtare, në veçanti ato që lidhen me efijencën energjetike.

5. Për qëllim të transparencës në zbatimin e kërkesave për efikasitetin e energjisë në procesin e prokurimit, autoritetet dhe entitetet kontraktuese bëjnë publike informacionin mbi ndikimin në efikasitetin e energjisë të kontratave me vlerë të barabartë ose më të madhe se pragjet e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, nëpërmjet publikimit të këtij informacioni në njoftimet përkatëse të prokurimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi për prokurimin publik.
6. Agjencia përgjegjëse për prokurimin publik mbështet zbatimin e kërkesave për efikasitetin energjetike në nivel qendror dhe vendor përmes:
  - a) hartimit dhe publikimit të rregullave të qarta, udhëzimeve dhe metodologjive, përfshirë ato për vlerësimin e kostove gjatë ciklit jetësor dhe ndikimeve mjedisore;
  - b) zhvillimit të kapaciteteve
  - c) nxitjes së bashkëpunimit ndërmjet autoriteteve kontraktuese, përfshirë edhe në nivel ndërkuftar;
7. Këshilli i Ministrave me propozimin e ministrit përgjegjës për energjinë në bashkëpunim me ministritë dhe institucionet përgjegjëse për prokurimin, buxhetimin dhe kontabilitetin publik rishikon kuadrin ligjor, rregullator dhe praktikën administrative në fushën e prokurimit, buxhetimit dhe kontabilitetit publik për të larguar pengesat e marrëveshjeve kontraktore afatgjata për autoritetet kontraktuese në:
  - a) kryerjen e investimeve për përmirësimin e efikasitetit energjetike;
  - b) përdorimin e kontratave të performancës energjetike;
  - c) përdorimin e mekanizmave të financimit nga palë të treta.
8. Këshilli i Ministrave me propozimin e ministrit përgjegjës për energjinë dhe transportin miraton vendimin për promovimin e automjeteve me emetim të ulët dhe performancë të lartë të efikasitetit energjetike në transportin e udhëtarëve.
9. Vendimi sipas pikës 9 të këtij neni, përcakton ndër të tjera:
  - a) fushën e zbatimit dhe automjetet që përjashtohen;
  - b) objektivat minimale të automjeteve me emetim të ulët dhe performancë të lartë të efikasitetit energjetike në transportin e udhëtarëve;
  - c) raportimin dhe mbikëqyrjen mbi zbatimin e detyrimeve.
10. Detyrimet e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni nuk zbatohen në rastet kur:
  - a) provohet se përmbushja e këtyre kërkesave nuk është teknikisht e realizueshme dhe justifikohet në dokumentacionin përkatës të prokurimit;
  - b) zbatimi i tyre do të cenonte sigurinë publike ose do të pengonte reagimin efektiv ndaj emergjencave shëndetësore;
  - c) zbatimi i tyre krijon konflikt me natyrën dhe qëllimin kryesor të veprimtarisë së forcave të armatosura;
  - ç) kontratat kanë për objekt furnizimin me pajisje ushtarake, sipas legjislacionit përkatës në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë.

## **KREU IV**

### **DETYRIMET PËR ARRITJEN E KURSIMEVE TË ENERGJISË**

#### **Neni 10**

#### **Skema detyruese për efikasitetin energjetike**

1. Skema detyruese për efikasitetin energjetike ka si qëllim përcaktimin dhe arritjen e objektivit të kursimeve kumulative të energjisë tek përdoruesit fundorë nëpërmjet zbatimit

- të masave të qëndrueshme dhe të verifikueshme për përmirësimin e efikasitetit të energjisë nga palët e detyruara, si dhe përmes masave të tjera alternative.
2. Skema detyruese hartohet me qëllim arritjen e kursimeve vjetore në konsumin final të energjisë, si më poshtë:
    - a) për periudhën nga 1 janar 2026 deri më 31 dhjetor 2027, kursime vjetore në nivelin 1,5 % të konsumit vjetor të energjisë në përdorimin final, të llogaritura si mesatare e tre viteve më të fundit përpara datës 1 janar 2019;
    - b) për periudhën nga 1 janar 2028 deri më 31 dhjetor 2040, kursime vjetore në nivelin 1,9 % të konsumit vjetor final të energjisë në përdorimin final, të llogaritura si mesatare e tre viteve më të fundit përpara datës 1 janar 2019.
  3. Skema detyruese për efikasitetin energjetik, miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave me propozim të ministrit përgjegjës për energjinë dhe përcakton:
    - a) objektivin e kursimeve vjetore si dhe kontributin në përqindje për arritjen e objektivit ndërmjet kontributit nga masat alternative dhe kontributit nga palët e detyruara;
    - b) kriteret për identifikimin dhe përzgjedhjen e palëve të detyruara;
    - c) ndarjen e kontributit të kursimeve të energjisë tek përdoruesit fundorë për çdo palë të detyruar;
    - ç) përzgjedhjen e përdoruesve fundorë dhe prioritizimin e tyre;
    - d) masat e miratuara për arritjen e kursimeve;
    - dh) formatin e raportimit të masave të zbatuara për përmirësimin e efikasitetit energjetik;
    - e) procedurat sipas të cilave një palë e detyruar mund të blejë pjesërisht ose plotësisht detyrimin e saj duke transferuar tek Fondi, shumën korresponduese me një normë të sheshtë për ktoe;
    - ë) mënyrën e kontrollit, matjes, verifikimit dhe raportimit nga agjencia përgjegjëse për efikasitetin energjetik;
    - f) veprimet dhe procedurat që ndërmerren nga ministria përgjegjëse për energjinë për të siguruar se palët e detyruara transferojnë shumën korresponduese tek Fondi për kursimet e përcaktuara të energjisë;
    - g) kontributin e kursimeve të arritura nga palët e detyruara tek përdoruesit fundorë që klasifikohen si familje në nevojë, familje në varfëri energjetike ose familje që përfitojnë mbështetje sociale;
    - gj) procedurat për shmangien e mbivendosjeve të ndikimit të masave të politikave apo vendimeve individuale dhe si rezultat, mënjanimin e numërimit të dyfishtë të kursimeve të energjisë;
    - h) mekanizmat e fleksibilitetit, duke përfshirë certifikatat e kursimeve të energjisë.
  4. Skema detyruese për efikasitetin e energjisë, si dhe monitorimi dhe verifikimi i kursimeve të energjisë të arritura në kuadër të kësaj skeme dhe masave alternative, realizohen nga Agjencia përgjegjëse për efikasitetin e energjisë, në përputhje me nenin 13 të këtij ligji.
  5. Në zbatimin e skemës detyruese për efikasitetin energjetik, përparësi u jepet, ndër të tjera, personave të prekur nga varfëria energjetike, klientëve vulnerabël, familjeve me të ardhura të ulëta dhe, kur është e zbatueshme, personave që jetojnë në banesa sociale.
  6. Masat e politikave të zbatuara sipas këtij neni nuk duhet të kenë efekte negative ndaj kategorive të përcaktuara në pikën 5 dhe duhet të kontribuojnë në një tranzicion energjetik të drejtë dhe gjithëpërfshirës.
  7. Për qëllim të pikës 6 të këtij neni, ministri përgjegjës për energjinë siguron përdorimin optimal të burimeve financiare, përfshirë fondet publike, mekanizmat financiarë të krijuar

- në nivel të Bashkimit Evropian, si dhe të ardhurat nga tregtimi i kuotave të emetimeve, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
8. Për arritjen e objektivave të kursimeve të energjisë, ministria përgjegjëse për energjinë konsideron dhe promovon rolin e komuniteteve të energjisë nga burime të rinovueshme dhe komuniteteve qytetare të energjisë në hartimin dhe zbatimin e masave politike.
  9. Një pjesë e sasisë së kontributit të kërkuar të kursimeve kumulative të energjisë në përdorimin final sigurohet nëpërmjet masave të dedikuara dhe të verifikueshme ndërmjet personave të prekur nga varfëria energjetike, konsumatorëve vulnerabël, familjeve me të ardhura të ulëta dhe, sipas rastit, personave që jetojnë në banesa sociale.
  10. Pjesa e kontributit të kursimeve e përcaktuar në pikën 9 të këtij neni nuk është më e ulët se përqindja e familjeve në varfëri energjetike, e përcaktuar në Planin Kombëtar të Energjisë dhe Klimës.
  11. Për vlerësimin e varfërisë energjetike në përputhje me pikën 9 të këtij neni merren në konsideratë, ndër të tjera, treguesit e mëposhtëm:
    - a) pamundësia për të mbajtur banesën në temperaturë të përshtatshme;
    - b) detyrimet e prapambetura në pagesat e faturave të energjisë dhe shërbimeve;
    - c) jetesa në banesa me probleme strukturore, përfshirë çati që rrjedh, lagështi në mure, dysheme ose themele, apo degradim të dritareve dhe dyshemeve;
    - ç) përqindja e popullsisë në rrezik varfërie, bazuar në pragun 60% të të ardhurave mesatare ekuivalente pas transfertave sociale.
  12. Në mungesë të një vlerësimi të përqindjes së familjeve në varfëri energjetike në Planin Kombëtar të Energjisë dhe Klimës, kontributi i kursimeve sipas pikës 9 përcaktohet të paktën sa mesatarja aritmetike e indikatorëve të përcaktuar në pikën 11, bazuar në të dhënat më të fundit të disponueshme, duke marrë si referencë vitin 2019 ose, në mungesë të tij, mbi bazën e trendit të tre viteve të fundit të disponueshme.
  13. Ministria përgjegjëse për energjinë siguron përfshirjen në përditësimet e Planit Kombëtar të Energjisë dhe Klimës, në planet pasuese dhe në raportet kombëtare të progresit për energjinë dhe klimën, të informacionit mbi:
    - a) treguesit e përdorur për vlerësimin e varfërisë energjetike;
    - b) përqindjen mesatare aritmetike të këtyre treguesve;
    - c) rezultatet e masave të politikave të zbatuara në përputhje me këtë nen.
  14. Ky informacion paraqitet në përputhje me kërkesat për raportim të vendimit mbi mekanizmin qeverisës të parashikuar nga ligji Nr. 155/2020 “Për ndryshimet klimatike”.

## **Neni 11**

### **Kontributi i palëve të detyruara në skemën detyruese**

1. Kontributi kumulativ i kursimit të energjisë tek konsumatorët fundor për t'u arritur përmes zbatimit të masave nga ana e palëve të detyruara përcaktohet në vendimin sipas pikës 3 të nenit 10, të këtij ligji.
2. Subjektet e detyruara mund të përmbushin, tërësisht ose pjesërisht, detyrimin e tyre për kursimet e energjisë përmes kontributit financiar në Fondin Kombëtar për Eficiencën e Energjisë në përputhje me pikën 3 të nenit 10, të këtij ligji.
3. Palët e detyruara përcaktohen në bazë të kriterëve objektive dhe jodiskriminuese, midis operatorëve të sistemit të transmetimit, operatorëve të sistemit të shpërndarjes, shpërndarësve të energjisë, kompanive të shitjes me pakicë të energjisë dhe shpërndarësve të karburantit të transportit ose shitësve me pakicë të karburantit të transportit që operojnë në Shqipëri.
4. Palët e detyruara janë përgjegjëse për arritjen e kursimeve të energjisë te konsumatorët

fundorë, në përputhje me detyrimet e përcaktuara në vendimin e pikës 3 të nenit 10 të këtij ligji.

5. Detyrimi sipas pikës 4 të këtij neni përmbushet:
  - a) drejtpërdrejt nga subjektet e detyruara; ose
  - b) përmes kursimeve të energjisë të realizuara nga palë të treta dhe të verifikuara dhe certifikuara nga organet përgjegjëse.
6. Në rast se shoqëritë e shitjes me pakicë të energjisë klasifikohen si palë të detyruara, atyre u ndalohet, gjatë përmbushjes së detyrimeve të tyre, të krijojnë pengesa që kufizojnë ose vështirësojnë të drejtën e konsumatorëve për të ndryshuar furnizuesin e energjisë.
7. Për mbrojtjen e personave të prekur nga varfëria energjetike, konsumatorëve vulnerabël dhe sipas rastit, personave që jetojnë në banesa sociale, agjencia përgjegjëse për efikasitetin e energjisë nxit palët e detyruara të ndërmarrin masa për përmirësimin e efikasitetit të energjisë, përfshirë:
  - a) rinovimin e ndërtesave, përfshirë banesat sociale;
  - b) zëvendësimin e pajisjeve;
  - c) mbështetjen financiare dhe skemat e incentivave;
  - ç) auditimet e energjisë.
8. Agjencia përgjegjëse për efikasitetin e energjisë siguron që masat e përcaktuara në pikën 7 të këtij neni të jenë të zbatueshme edhe për njësi banimi individuale brenda ndërtesave me shumë apartamente.
9. Agjencia përgjegjëse për efikasitetin e energjisë vlerëson dhe, sipas rastit, merr masa për të minimizuar ndikimin e kostove direkte dhe indirekte të skemës detyruese për efikasitetin e energjisë mbi konkurrueshmërinë e industrive me intensitet të lartë energjie që janë të ekspozuara ndaj konkurrencës ndërkombëtare.

## **Neni 12**

### **Kontributi përmes masave alternative në skemën detyruese**

1. Përmbushja e objektivit të kursimeve të energjisë në kuadër të skemës detyruese mbështetet edhe përmes zbatimit të masave alternative të politikave, të cilat kontribuojnë në arritjen e kursimeve të matshme dhe të verifikueshme të energjisë në përdorimin final.
2. Masat alternative përfshijnë, ndër të tjera, programe financimi dhe mbështetjeje, masa fiskale, standarde dhe rregullime ligjore, si dhe iniciativa të tjera publike që synojnë përmirësimin e efikasitetit të energjisë.”
3. Kontributi i kursimit të energjisë tek konsumatorët fundor për tu arritur përmes masave alternative përcaktohet në vendimin sipas pikës 3 të nenit 10, të këtij ligji.
4. Masat alternative hartohen dhe zbatohen në mënyrë të tillë që:
  - a) të prodhojnë kursime të matshme dhe të verifikueshme të energjisë;
  - b) të përcaktojnë qartë përgjegjësitë e palëve pjesëmarrëse ose autoriteteve zbatuese;
  - c) kursimet e arritura të përcaktohen në mënyrë transparente;
  - ç) të shmangët numërimi i dyfishtë i kursimeve të energjisë;
  - d) të demonstron materialitetin e masave në arritjen e kursimeve;
  - dh) të mos kenë efekte negative mbi personat në varfëri energjetike dhe grupet vulnerabël.
5. Në rast se raportohen masa që lidhen me tatimin, ministria përgjegjëse për energjinë siguron që të demonstron efektivitetin e sinjalit të çmimit në hartimin e këtyre masave, përfshirë nivelin e normës tatimore dhe parashikueshmërinë e saj në kohë. Në rast të uljes së normës tatimore, ministria përgjegjëse për energjinë justifikon nëse masat tatimore vazhdojnë të rezultojnë në kursime të reja të energjisë.

### Neni 13

#### Monitorimi dhe raportimi mbi zbatimin e skemës detyruese

1. Verifikimi dhe monitorimi i kursimeve të energjisë të arritura në kuadër të skemës detyruese dhe masave alternative realizohet nga ministria përgjegjëse për energjinë, në bashkëpunim me agjencinë përgjegjëse për eficientë energjetike.
2. Këshilli i Ministrave, me propozim të ministrisë përgjegjëse për energjinë, miraton metodologjitë, parimet, procedurat dhe format e raportimit për llogaritjen, monitorimin, kontrollin dhe verifikimin e kursimeve të energjisë në kuadër të skemës detyruese dhe masave alternative
3. Kursimet e energjisë për çdo palë të detyruar shprehen në terma të konsumit të energjisë primare ose të konsumit të energjisë finale. Metoda e zgjedhur për shprehjen e këtij detyrimi përdoret gjithashtu për llogaritjen e kursimeve të energjisë të deklaruara nga subjektet e detyruara.
4. Në rast të konvertimit të kursimeve të energjisë, zbatohen vlerat kalorifike neto dhe faktorët e energjisë primare të përcaktuar në legjislacionin në fuqi, përveç rasteve kur përdorimi i faktorëve të tjerë të konvertimit justifikohet në mënyrë të arsyeshme dhe dokumentohet.
5. Institucionet përgjegjëse sipas pikës 1 të këtij neni sigurojnë verifikimin e dokumentuar mbi të paktën një pjesë statistike të konsiderueshme dhe përfaqësuese të masave për përmirësimin e eficientë së energjisë të zbatuara nga palët e detyruara, palët pjesëmarrëse, palët e ngarkuara ose autoritetet publike zbatuese, sipas rastit.
6. Ministria përgjegjëse për energjinë siguron që në dorëzimet në sekretariatit e Komunitetit të Energjisë pra, përditësimet e Planit Kombëtar të Energjisë dhe Klimës, në planet pasuese dhe në raportet kombëtare të progresit për energjinë dhe klimën të përfshihet, sipas rastit:
  - a) sasia e kërkuar e kursimeve të energjisë në përdoruesit fundor;
  - b) përshkrimi i masave të politikave që do të zbatohen për arritjen e këtyre kursimeve;
  - c) metodologjia e përdorur për llogaritjen e sasisë së kursimeve të energjisë që duhet të arrihen gjatë periudhës së zbatimit;
  - ç) norma vjetore e kursimeve e aplikuar, sipas rastit;
  - d) baza e llogaritjes së përdorur;
  - dh) mënyra dhe shkalla e përdorimit të fleksibiliteteve të lejuara;
  - e) treguesit e përdorur për vlerësimin e varfërisë energjetike;
  - ë) përqindja mesatare aritmetike e këtyre treguesve;
  - f) rezultatet e masave të politikave të zbatuara në përputhje me nenet 10, 11 dhe 12 të këtij ligji.
7. Ministria përgjegjëse për energjinë raporton në Sekretariatit e Komunitetit të Energjisë, në kuadër të raporteve kombëtare të progresit për energjinë dhe klimën, informacionin mbi sistemet e matjes, kontrollit dhe verifikimit të vendosura, përfshirë metodat e përdorura, problematikat e identifikuara dhe mënyrën e adresimit të tyre.
8. Agjencia përgjegjëse për eficientë energjetike publikon në faqen zyrtare të internetit çdo vit kursimet e energjisë të arritura nga çdo palë e detyruar ose sipas nënkategorive të tyre, si dhe kursimet totale të arritura në kuadër të skemës detyruese dhe masave alternative.
9. Në rast se, nga monitorimi dhe vlerësimi i progresit, konstatohet se masat e politikave nuk sigurojnë arritjen e sasisë së kërkuar të kursimeve kumulative të energjisë në përdorimin final deri në fund të periudhës së detyrimit, ministria përgjegjëse për energjinë merr masat korrigjuese të nevojshme për garantimin e arritjes së objektivave të përcaktuara.
10. Në rast se deri në fund të një periudhe detyrimi nuk arrihet niveli i kërkuar i kursimeve

kumulative të energjisë në përdorimin final, sasia e papërmbyshur e kursimeve realizohet shtesë ndaj detyrimit për periudhën pasuese.

11. Në rast se deri në fund të një periudhe detyrimi arrihen kursime kumulative të energjisë mbi nivelin e kërkuar, ministria përgjegjëse për energjinë mund të lejojë transferimin në periudhën pasuese të një pjese të kësaj teprice, në një nivel që nuk tejkalon 10% të sasisë së tepërt të kursimeve, pa rritur objektivin përkatës të periudhës pasuese.
12. Ministria përgjegjëse për energjinë siguron që, në përditësimet e Planit Kombëtar të Energjisë dhe Klimës, në planet pasuese dhe në raportet kombëtare të progresit për energjinë dhe klimën, të faktohet me prova dhe llogaritje:
  - a) se, në rast të mbivendosjes së ndikimit të masave të politikave ose veprimeve individuale, nuk ka numërim të dyfishtë të kursimeve të energjisë;
  - b) mënyra se si kursimet e energjisë kontribuojnë në arritjen e objektivave kombëtare për efikasitetin e energjisë;
  - c) se masat e politikave të vendosura për përmbyshjen e detyrimeve për kursimet e energjisë janë hartuar në përputhje me këtë ligj dhe janë të përshtatshme për të siguruar arritjen e sasisë së kërkuar të kursimeve kumulative të energjisë deri në fund të çdo periudhe detyrimi.
13. Për konvertimin e kursimeve të energjisë ministri përgjegjës për energjinë miraton urdhërin që përcakton faktorët e konvertimit për çdo bartës energjetik sipas pikës 1 të nenit 53 të këtij ligji.

## **KREU IV EFIÇENCA NË PËRDORIMIN E ENERGJISË**

### **Neni 14 Sistemet e menaxhimit të energjisë dhe auditimet energjetike**

1. Konsumatorët e mëdhenj të energjisë me një konsum mesatar vjetor më të lartë se 85 TJ energji gjatë tre viteve të mëparshme, duke marrë së bashku të gjithë bartësit energjetik, realizojnë ngritjen e një sistemi të menaxhimit të energjisë. Ngritja e sistemit të menaxhimit të energjisë konsiderohet e realizuar pasi certifikohet nga një organ i pavarur, në përputhje me standardet përkatëse evropiane ose ndërkombëtare.
2. Konsumatorët e mëdhenj të energjisë sipas pikës 1 të këtij neni, detyrohen të kenë një sistem të menaxhimit të energjisë të certifikuar, deri më 11 tetor 2027.
3. Konsumatorët e mëdhenj të energjisë me një konsum mesatar vjetor më të lartë se 3 TJ energji gjatë tre viteve të mëparshme, duke marrë së bashku të gjithë bartësit energjetik, të cilët nuk zbatojnë një sistem të menaxhimit të energjisë, i nënshtrohen procesit të auditimit energjetik.
4. Auditimi energjetik kryhet në mënyrë të pavarur nga ekspertët e certifikuar ose të akredituar, në përputhje me nenin 17 të këtij ligji;
5. Konsumatorët e mëdhenj të energjisë, sipas pikës 3 të këtij neni kryejnë auditimin e parë energjetik deri më 31 mars 2027 dhe auditimet pasuese të energjisë kryhen të paktën çdo tre vjet.
6. Konsumatorët e mëdhenj të energjisë, brenda 60 ditëve pas realizimit dhe dorëzimit të raportit të auditimit tek agjencia përgjegjëse për efikasitetin energjetik, hartojnë një plan veprimi konkret dhe të realizueshëm mbi bazën e rekomandimeve që rezultojnë nga procesi i auditimit. Plani i veprimit identifikon masat për t'u zbatuar sipas rekomandimeve të procesit të auditimit, në rastet kur këto masa janë teknikisht të realizueshme dhe ekonomikisht të justifikuara.
7. Plani i veprimit hartohet nga menaxheri i energjisë i punësuar pranë konsumatorit të madh të energjisë dhe një kopje e tij dërgohet tek agjencia përgjegjëse për efikasitetin e energjisë.

8. Plani i veprimit hartohet në përputhje me objektivat e përgjithshëm për kursimin e energjisë, të parashikuara në Planin Kombëtar të Energjisë dhe Klimës për zbatimin e masave të përzgjedhura prej tij, duke garantuar arritjen e një kursimi të energjisë prej të paktën 4% të energjisë ekuivalente totale të konsumuar prej tij, kur është teknikisht dhe ekonomikisht e realizueshme.
9. Plani i veprimit përmban masat e përzgjedhura për zbatim, arsyen e përzgjedhjes, koston dhe afatin e realizimit për çdo masë dhe kursimet e pritshme të energjisë para investimit. Plani regjistrohet në regjistrin kombëtar që administron agjencia përgjegjëse për eficientë të energjisë.
10. Konsumatorët e mëdhenj të energjisë janë të detyruar të publikojnë në raportin vjetor të ndërmarrjes Planin e Veprimit dhe nivelin e zbatimit të rekomandimeve, si dhe t'i bëjnë ato të aksesueshme për publikun, duke respektuar legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e sekreteve tregtare dhe konfidencialitetit.
11. Konsumatorët e mëdhenj të energjisë, që kanë certifikuar sistemin e tyre të menaxhimit të energjisë sipas standardit ISO 50001 nga një organ certifikues i sistemeve të menaxhimit të energjisë i akredituar, përjashtohen nga detyrimet e pikës 2 të këtij neni, por raportojnë brenda datës 31 mars të çdo viti masat e zbatuara dhe kursimet e arritura gjatë vitit paraardhës pranë agjencisë përgjegjëse për eficientë të energjisë.
12. Format i planeve të veprimit të konsumatorëve të mëdhenj dhe i raportit vjetor të progresit miratohet nga ministri përgjegjës për energjinë, me propozim të agjencisë përgjegjëse për eficientë të energjisë.
13. Ministri përgjegjës për energjinë, me propozimin e agjencisë përgjegjëse për eficientë të energjetike miraton urdhrin për identifikimin e konsumatorëve të mëdhenj të energjisë si dhe mënyrën e raportimit të tyre periodik mbi konsumin për çdo bartës energjetik.
14. Agjencia përgjegjëse për eficientë të energjetike dhe Fondi zhvillojnë programe për të inkurajuar dhe ofruar mbështetje teknike për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, në vijim NVM-të që nuk i nënshtrohen pikës 1 ose 3 të këtij neni për t'iu nënshtrohet auditimeve të energjisë dhe për të zbatuar më pas rekomandimet që dalin nga ato auditime.
15. Programet e përmendura në pikën 14 të këtij neni, përfshijnë:
  - a) mbështetjen për NVM-të në përcaktimin sasior të përfitimeve të shumëfishta të masave të eficientë të energjetike brenda funksionimit të tyre, në zhvillimin e udhërrëfyesve të eficientë të energjetike dhe në zhvillimin e rrjeteve të eficientë të energjisë për NVM-të, të lehtësuar nga ekspertët e certifikuar;
  - b) nxitjen e konsumatorëve fundorë që nuk janë NVM dhe që nuk klasifikohen sipas pikave 1 ose 3 të këtij neni, për t'iu nënshtrohet procesit të auditimit energjetik dhe të zbatojnë më pas rekomandimet që dalin nga ato auditime;
  - c) shembuj konkretë se si sistemet e menaxhimit të energjisë mund të ndihmojnë bizneset e tyre.
16. Auditimi i energjisë konsiderohet se është në përputhje me pikën 4 të këtij neni, kur:
  - a) kryhet në mënyrë të pavarur, në bazë të kriterëve minimale të përcaktuara në Nenin 18 të këtij ligji;
  - b) zbatohet sipas marrëveshjeve vullnetare ndërmjet palëve të interesuara dhe një organi të mbikëqyrur nga autoritetet kompetente.
17. Aksesi në treg i pjesëmarrësve që ofrojnë shërbime energjetike bazohet në kriterë transparente dhe jodiskriminuese.
18. Konsumatorët e mëdhenj të energjisë që zbatojnë një kontratë për performancën energjetike përjashtohen nga detyrimet e përcaktuara në pikat 1 dhe 2 të këtij neni, me kusht që kontrata të përfshijë elementet e nevojshme të sistemit të menaxhimit të energjisë dhe të jetë në përputhje me kërkesat e përcaktuara në legjislacionin përkatës në fuqi.
19. Konsumatorët e mëdhenj të energjisë që zbatojnë një sistem të menaxhimit mjedisor, të

certifikuar nga një organ i pavarur në përputhje me standardet përkatëse evropiane ose ndërkombëtare, përjashtohen nga detyrimet e përcaktuara në pikat 1 dhe 2 të këtij neni, me kusht që ky sistem të përfshijë një auditim energjetik në përputhje me kriteret minimale të përcaktuara në legjislacionin përkatës në fuqi.

## **Neni 15**

### **Auditimi energjetik**

1. Auditimet energjetike kryhen nga auditues energjetikë të certifikuar ose nga persona juridikë, që kanë të punësuar auditues energjetikë të certifikuar, në përputhje me përcaktimet e këtij ligji.
2. Auditimi energjetik shoqërohet me një raport që përfshin:
  - a) një vlerësim të nivelit aktual të konsumit të energjisë për objektin e auditimit energjetik;
  - b) propozimin e masave të kursimit të energjisë që duhen marrë, përfshirë justifikimin ekonomik;
  - c) të dhëna për sasinë totale të kursimeve të mundshme;
  - ç) opinionin përfundimtar të audituesit energjetik për potencialin për rritjen e efikasitetit të energjisë dhe masat teknike përkatëse.
3. Audituesi dërgon një kopje të raportit të auditimit energjetik tek agjencia përgjegjëse për efikasitetin energjetik për ata konsumatorë që janë subjekt i auditimit të detyrueshëm.
4. Audituesit e energjisë sigurojnë që çdo auditim i realizuar prej tyre:
  - a) të bazohet në të dhëna operationale të përditësuara, të matura, të gjurmueshme të konsumit të energjisë dhe profilet e ngarkesës (për energjinë elektrike);
  - b) të përfshijë një analizë të detajuar të profilit të konsumit energjetik të ndërtesave ose grupeve të ndërtesave, operationeve industriale ose instalimeve, duke përfshirë transportin;
  - c) të identifikojë masat e efikasitetit energjetik për të ulur konsumin e energjisë;
  - ç) të identifikojë potencialet me kosto efektive ose prodhimin e energjisë përmes burimeve të rinovueshme;
  - d) të përdoret për vlerësimin e masave të efikasitetit energjetik, kurdoherë që është e mundur, analiza e kostos përgjatë ciklit jetësor në vend të periudhave të thjeshta të kthimit, në mënyrë që të merren parasysh kursimet afatgjata, vlerat e mbetura të investimeve afatgjata dhe normat e skontimit;
  - dh) të jetë proporcional dhe mjaft përfaqësues për të lejuar pasqyrimin e një tabloje të besueshme të performancës së përgjithshme të energjisë dhe identifikimin e besueshëm të mundësive më të rëndësishme për përmirësim.
  - e) të lejojë llogaritjet e detajuara dhe të vërtetuara për masat e propozuara në mënyrë që të sigurohet informacion i qartë mbi kursimet e pritshme.
5. Të dhënat e përdorura në auditimet energjetike arkivohen nga agjencia përgjegjëse për efikasitetin energjetik për analiza historike dhe gjurmimin e performancës.
6. Auditimet e energjisë nuk përfshijnë klauzola që pengojnë transferimin e gjetjeve të auditimit të ndonjë ofruesi i kualifikuar ose i akredituar i shërbimeve energjetike, me kusht që klienti të mos kundërshtojë.
7. Auditimi energjetik është i detyrueshëm për:
  - a) çdo person juridik, publik ose privat, që kategorizohet si konsumator i madh energjie sipas pikës 1 dhe 3 të nenit 14;
  - b) të gjithë personat fizikë dhe/ose juridikë, që aplikojnë për një program të financuar nga Fondi për nxitjen dhe përmirësimin e efikasitetit energjetik në objektet e tyre.

8. Formati i auditimit energjetik përcaktohet në rregulloren e hartuar nga agjencia përgjegjëse për efikasitetin energjetik dhe të miratuar nga ministri përgjegjës për energjinë.

### **Neni 16** **Menaxheri i energjisë**

1. Personat juridikë, publikë ose privatë, që kategorizohen si konsumatorë të mëdhenj energjie, sipas pikës 1 dhe 3 të nenit 14 të këtij ligji si dhe njësitë e qeverisjes vendore janë të detyruar të punësojnë të paktën një menaxher energjie.
2. Menaxheri i energjisë është përgjegjës për menaxhimin dhe monitorimin e konsumit të energjisë, mirëmbajtjen e pajisjeve që konsumojnë çdo formë energjie, përmirësimin dhe mbikëqyrjen e mënyrave të përdorimit të energjisë dhe kryerjen e detyrave të tjera për përdorimin racional të energjisë në ndërtesa dhe industri.
3. Një menaxher energjie nuk punësohet në të njëjtën kohë në më shumë se një konsumator të madh energjie ose njësi të qeverisjes vendore.
4. Menaxherët e energjisë raportojnë në mënyrë periodike tek agjencia përgjegjëse për efikasitetin e energjisë lidhur me zbatimin e masave për rritjen e efikasitetit energjetik në ndërmarrjet ose institucionet në të cilat janë punësuar.
5. Menaxherët e energjisë certifikohen në përputhje me pikën 4 të nenit 17, të këtij ligji.

### **Neni 17** **Certifikimi i audituesve dhe menaxherëve energjetik**

1. Ekspertët certifikohen në përputhje me vendimin sipas pikës 3 të këtij neni.
2. Për qëllim të këtij neni ekspertët e pavarur certifikohen si:
  - a) Auditues energjetik për instalime industriale;
  - b) Auditues energjetik në transport;
  - c) Menaxher energjie.
3. Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për energjinë, miraton procedurën, kategoritë, kushtet, kërkesat e kualifikimit dhe të eksperiencës profesionale për personin, të cilit i lëshohet certifikata, sipas pikës 2 të këtij neni.
4. Vendimi i Këshillit të Ministrave, sipas përmbajtjes së pikës 3 të këtij neni, përcakton:
  - a) kategoritë dhe kërkesat minimale të kualifikimit të ekspertëve së bashku me autorizimin e tyre për të kryer shërbimet energjetike në objekte të ndryshme;
  - b) kriteret për përzgjedhjen e institucioneve të miratuara të edukimit dhe/ose trajnimit, të cilat janë të autorizuar nga ministria përgjegjëse për energjinë, të kryejnë trajnime, duke përfshirë kualifikimet minimale, kapacitetet dhe objektet që këto institucione duhet të zotërojnë
  - c) një listë të trajnimeve të detyrueshme profesionale që duhet të përfshijnë të paktën trajnimin për legjisllacionin përkatës kombëtar, standardet kombëtare, evropiane dhe ndërkombëtare në fushën e auditimit energjetik dhe menaxhimit energjetik, trajnime teknike për teknikat e auditimit energjetik, teknikat e analizës së kostove, teknikat e shkrimit të një raportit auditimi;
  - ç) parashikimin e kryerjes së testimeve përfundimtare, vlerësimin e rezultateve dhe certifikimin e atyre që kanë përfunduar me sukses programet e trajnimit;
  - d) rregullat dhe kriteret për ngritjen e komisioneve të testimit;
  - dh) rregulla procedurale për njësimin e certifikatave të ekspertëve të lëshuara nga institucione të huaja;
  - e) kodin e sjelljes;
  - ë) raportimet e detyrueshme;

- f) metodat e procedurat për kontrollin e cilësisë së auditimeve dhe vlerësimeve energjetike, bazuar në kontrollin të paktën të një përqindjeje statistikore të raporteve të auditimit energjetik dhe raportimeve periodike sipas fushës së përgjegjësisë;
  - g) vendosjen e kriterëve minimale transparente dhe jo diskriminuese për të garantuar cilësinë e lartë të shërbimeve energjetike të ofruara;
  - gj) arsyet dhe procedurat për vendosjen e masave administrative, për shkak të performancës së dobët ose shkeljes së kodit të sjelljes.
  - h) kredite mbi trajnimet e zhvillimit profesional
5. Agjencia dhe Ministria përgjegjëse për efikasitetin e energjisë, publikojnë listën e ekspertëve të certifikuar në faqen e tyre të internetit.
  6. Audituesit energjetik për instalime industriale dhe transport nuk kryejnë shërbime energjetike në kundërshtim me fushën e certifikimit të tyre ose në kushtet e konfliktit të interesit, në:
    - a) shoqëri në të cilat zotërojnë aksione ose kuota;
    - b) shoqëri në të cilën janë anëtar të një organi drejtues ose janë të punësuar nga personi të cilit i kërkohet të realizojë secilin nga shërbimet energjetike për të cilin ato janë certifikuar;
    - c) rezultojnë të afërm të shkallës së dytë me personat që ju ofrojnë secilin nga shërbimet energjetike për të cilin ato janë certifikuar;
    - ç) në një konsumator të madh energjie të audituar prej tyre gjatë dy periudhave të njëpasnjëshme auditimi.
    - d) çdo rast tjetër të parashikuar nga legjislacioni në fuqi për parandalimin e konfliktit të interesit.
  7. Audituesi energjetik mban konfidenciale të gjitha të dhënat lidhur me personin fizik ose juridik, të përfuara në kuadrin e auditimit të kryer në objektet e konsumatorëve të mëdhenj të energjisë. Audituesi energjetik nuk duhet të përfitojë nga këto të dhëna dhe nuk duhet t'i përdorë në interes ose në dëm të subjektit të audituar apo të një pale të tretë. Detyrimi i konfidencialitetit mund të hiqet me miratimin me shkrim nga personi fizik ose juridik, objekt i auditimit energjetik, ose nëse bërja publike e tyre parashikohet nga një ligj tjetër.
  8. Ministria dhe agjencia përgjegjëse për efikasitetin e energjisë vendosin në dispozicion të palëve të interesuara informacionin mbi trajnimet dhe certifikimet e disponueshme.

## **Neni 18**

### **Mbikqyrja e audituesve dhe menaxherëve energjetik të certifikuar**

1. Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për energjinë, miraton vendimin për procedurën, kriteret minimale, kushtet, kërkesat dhe autoritetet përgjegjëse për mbikëqyrjen e shërbimeve të kryera nga audituesit dhe menaxherët energjetik e certifikuar sipas nenit 17 të këtij ligji.
2. Procesi i mbikëqyrjes realizohet nga ekspertët e certifikuar nga ministria përgjegjëse për energjinë sipas procedurës së parashikuar në pikën 4 të nenit 17, të cilët janë punonjës prej më shumë se tre vitesh në institucionet publike që ngarkohen me përgjegjësinë e realizimit të procesit të mbikëqyrjes.
3. Ekspertët e certifikuar të punësuar pranë institucioneve publike përgjegjëse për realizimin e procesit të mbikëqyrjes u ndalohet ofrimi i shërbimeve energjetike ose kryerja e veprimtarive profesionale në fushën e auditimit ose menaxhimit energjetik jashtë ushtrimit të detyrave të tyre zyrtare.
4. Vendimi sipas pikës 1 përcakton në mënyrë të detajuar kriteret dhe kushtet për klasifikimin e shkeljeve të konstatuara gjatë procesit të mbikëqyrjes në:

- a) Shkelje – e cila shoqërohet me masë administrative
  - b) Shkelje e rëndë – për të cilën ekspertit të pavarur përveç masës administrative sipas shkronjës a) i revokohet certifikata për një periudhë trevjeçare.
5. Ekspertëve të pavarur, të cilëve iu është revokuar certifikata, sipas pikës 4, shkronja (b), të këtij neni, kanë të drejtë të aplikojnë për certifikatë të re jo më herët se tre vjet nga data e marrjes së vendimit të mësipërm. Në rast se të njëjtit person i revokohet certifikata për herë të dytë, atëherë ky person nuk ka më të drejtë të aplikojë për certifikatë.
  6. Procedura për komunikimin e shkeljeve sipas pikës 4 (a dhe b) përcaktohet në vendimin sipas pikës 1.
  7. Ekspertët e certifikuar detyrohen të vendosin në dispozicion të autoritetit mbikëqyrës të gjithë materialin dhe dokumentacionin e nevojshëm për realizimin e procesit të mbikëqyrjes, respektivisht fushës së përgjegjësisë që përfshin:
    - a) Raportin e auditimit;
    - b) Planin e veprimit për rritjen e efijencës energjetike;
    - c) Të dhënat energjetike të konsumatorit të madh të energjisë;
    - d) Masat e realizuara në zbatim të planit të veprimit për rritjen e efijencës energjetike
  8. Ekspertët e certifikuar të cilët nuk vendosin në dispozicion të autoritetit mbikëqyrës materialin sipas pikës 7, të këtij neni, ndaj tyre zbatohen masat e parashikuara sipas pikës 3, shkronja (b).

## **Neni 19**

### **Qendrat e të dhënave**

1. Duke nisur nga viti 2027, pronarët ose administratorët e qendrave të të dhënave me fuqi të instaluar më të madhe se 500 kW, bëjnë publik informacionin e kërkuar sipas pikës 10 të këtij neni me përjashtim të informacionit që mbrohet nga legjislacioni kombëtar për mbrojtjen e sekreteve tregtare dhe konfidencialitetit.
2. Detyrimi sipas pikës 1 të këtij neni nuk do të zbatohet për qendrat e të dhënave, përdorimi i të cilave lidhet vetëm me mbrojtjen kombëtare ose civile.
3. Agjencia përgjegjëse për efijencën e energjisë, krijon nje regjister të dhënash me informacionin e komunikuar nga qendrat e të dhënave që kanë detyrimin e publikimit të informacionit sipas pikes 1 te ketij neni. Agjencia përgjegjëse për efijencën e energjisë bashkepunon me Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP) dhe Autoriteti Kombëtar për Sigurinë Kibernetike (AKSK)/Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI) për identifikimin e qendrave të të dhënave që operojnë në Shqipëri.
4. Agjencia përgjegjëse për efijencën e energjisë harton dokumentin e praktikave më të mira me qëllim nxitjen e efijencës energjetike në menaxhimin e qendrave të të dhënave me kapacitet të barabartë ose më të madh se kapaciteti i përcaktuar në pikën 1 të këtij neni.
5. Dokumenti i praktikave më të mira bëhet publik në faqen zyrtare të internetit të agjencisë përgjegjëse për efijencën energjetike si dhe ju dërgohet pronarëve ose administratorëve të qendrave të të dhënave.
6. Agjencia përgjegjëse për efijencën e energjisë, paraqet pranë Ministrisë përgjegjëse për energjinë, një raport mbi zbatimin e detyrimit sipas pikës 1 dhe 3 të këtij neni, brenda 12 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji.
7. Ministri përgjegjës për energjinë e dërgon raportimin sipas pikës 6 të këtij neni tek Sekretariati i Komunitetit të energjisë
8. Agjencia përgjegjëse për efijencën e energjisë, kur është e nevojshme i propozon ministrit përgjegjës ndërmarrjen e nismave ligjore për përmirësimin e mëtejshëm të efijencës së energjisë për qendrat e të dhënave.

9. Këshilli i Ministrave, me propozim të ministrisë përgjegjëse për energjinë dhe ministrisë përgjegjëse për digjitalizimin, miraton skemën për vlerësimin e qëndrueshmërisë së qendrave të të dhënave. Skema përcakton përkufizimin e treguesve të qëndrueshmërisë së qendrës së të dhënave, treguesit kryesorë të performancës dhe metodologjinë për matjen e tyre.
10. Informacioni lidhur me performancën energjetike të qendrave të të dhënave përfshinë:
  - a) emrin e qendrës së të dhënave, emrin e pronarit dhe operatorëve të qendrës së të dhënave, datën në të cilën qendra e të dhënave filloi funksionimin e saj dhe bashkinë ku është e bazuar qendra e të dhënave;
  - b) sipërfaqen e dyshemesë së qendrës së të dhënave, fuqinë e instaluar, trafikun vjetor të të dhënave hyrëse dhe dalëse, dhe sasinë e të dhënave të ruajtura dhe të përpunuara brenda qendrës së të dhënave;
  - c) performancën, gjatë vitit të fundit kalendarik të plotë, të qendrës së të dhënave në përputhje me treguesit kryesorë të performancës për, ndër të tjera, konsumin e energjisë, përdorimin e energjisë, pikat e përcaktuara të temperaturës, përdorimin e nxehtësisë së mbeturinave, përdorimin e ujit dhe përdorimin e energjisë së rinovueshme, duke përdorur si bazë, aty ku është e zbatueshme, CEN/CENELEC SSH EN 50600-4 “Teknologjia e informacionit – Objektet dhe infrastrukturat e qendrave të të dhënave”.
11. Informacioni sipas pikës 10, të këtij neni, dërgohet tek agjencia përgjegjëse për eficientë energjetike dhe AKSHI përpara datës 31 mars të çdo viti.

## **KREU V**

### **SISTEMET E MATJES DHE FATURIMIT TË KONSUMIT ENERGJETIK**

#### **Neni 20**

#### **Sistemet e matjes së gazit natyror**

1. Operatori përgjegjës për furnizimin me gaz natyror siguron për të gjithë klientët fundorë pajisjen me matësa individuale me çmime konkurruese që pasqyrojnë me saktësi konsumin aktual të energjisë së konsumatorit fundor dhe që ofrojnë informacion mbi konsumin në kohë reale, për aq sa është e mundur teknikisht, financiarisht e arsyeshme dhe në përpjesëtim me kursimet e mundshme të energjisë.
2. Një matës individual në përputhje me pikën 1, të këtij neni, sigurohet gjithmonë kur:
  - a) një matës ekzistues zëvendësohet, përveç rasteve kur kjo është teknikisht e pamundur ose nuk është me kosto efektive në raport me kursimet e mundshme të energjisë në afatgjatë;
  - b) bëhet një lidhje e re e furnizimit me gaz natyror në një ndërtesë të re;
  - c) një ndërtesë që furnizohet me gaz natyror, i nënshtrohet një rinovimi të konsiderueshëm në përputhje me ligjin për Performancën Energjetike të Ndërtesave.
3. Kur operatorët e sistemit të gazit natyror instalojnë matësa inteligjent në përputhje me nenin 104 të ligjit 102/2015 "Për Sektorin e Gazit Natyror" ata:
  - a) sigurojnë që sistemet matëse t'u ofrojnë klientëve fundorë informacion mbi kohën aktuale të përdorimit dhe se objektivat e eficientë energjetike dhe përfitimet për klientët fundorë janë marrë plotësisht parasysh kur përcaktohen funksionet minimale të njehsorëve dhe detyrimet e vendosura ndaj pjesëmarrësve të tregut;
  - b) garantojnë sigurinë e matësve inteligjentë dhe komunikimit të të dhënave, si dhe privatësinë e klientëve fundorë, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen

- e të dhënave dhe privatësinë;
- c) kërkojnë që klientëve t'u jepen këshilla dhe informacioni i duhur në momentin e instalimit të matësve inteligjentë, veçanërisht në lidhje me potencialin e tyre të plotë në lidhje me menaxhimin e leximit të njehsorëve dhe monitorimin e konsumit të energjisë.
4. Furnizimi dhe faturimi i gazit natyror bazohen në konsumin aktual të matur, sipas rastit. Klientët fundorë kanë akses të rregullt dhe të lehtë në të dhënat e konsumit të tyre, duke përfshirë të dhëna të përditësuara dhe historike, në mënyrë që të mund të monitorojnë dhe menaxhojnë përdorimin e energjisë.

## **Neni 21**

### **Sistemet e matjes dhe ndarja e kostos për ngrohje, ftohje dhe ujë të ngrohtë sanitar**

1. Subjektet përgjegjëse që ofrojnë shërbimin e ngrohjes qendrore, ftohjes qendrore dhe ujit të ngrohtë sanitar, instalojnë tek klientët fundorë matësa me çmime konkurruese që pasqyrojnë me saktësi konsumin e tyre aktual të energjisë.
2. Kur ngrohja, ftohja ose uji i ngrohtë sanitar i furnizohet një ndërtesë nga një burim qendror që furnizon shumë ndërtesa ose nga një sistem ngrohje ose ftohje qendrore, një matës instalohet në shkëmbyesin e nxehtësisë ose në pikën e dorëzimit.
3. Në ndërtesat me shumë apartamente dhe ndërtesat multifunksionale, të pajisura me sistem qendror ngrohjeje ose ftohjeje ose të furnizuara nga një sistem ngrohje ose ftohjeje qendrore, instalohen matësa individuale për të matur konsumin e ngrohjes, ftohjes ose ujit të ngrohtë sanitar për çdo njësi të ndërtesës, kur është teknikisht e mundshme dhe me kosto efektive në raport me kursimet e mundshme të energjisë.
4. Kur ndërtesat me shumë apartamente ose ndërtesat multifunksionale furnizohen përmes sistemeve qendrore të ngrohjes ose ftohjes, ose kur mbizotërojnë sistemet e përbashkëta të ngrohjes ose ftohjes për ndërtesa të tilla, Ministria përgjegjëse për energjinë harton udhëzimin që përcakton rregulla kombëtare për shpërndarjen e kostos së ngrohjes, ftohjes dhe konsumit të ujit të ngrohtë sanitar në ndërtesa të tilla për të siguruar transparencë dhe saktësi në llogaritjen e konsumit individual. Aty ku është e përshtatshme, këto rregulla përfshijnë udhëzime për mënyrën në të cilën përcaktohet kostoja për energjinë që përdoret për:
  - a) ujë të ngrohtë sanitar;
  - b) nxehtësia e rrezatuar nga instalimi i ndërtesës dhe për qëllimin e ngrohjes së ambienteve të përbashkëta, kur shkallët dhe korridoret janë të pajisura me radiatorë;
  - c) ngrohjen ose ftohjen e apartamenteve.
5. Në rast se instalimi i matësve individuale nuk është teknikisht i mundshëm ose nuk është me kosto efektive, përdoren pajisje për ndarjen e kostos së nxehtësisë për çdo radiator, përveç rasteve kur vërtetohet se edhe këto pajisje nuk janë me kosto efektive.
6. Në ndërtesat e reja me shumë apartamente dhe në pjesët rezidenciale të ndërtesave multifunksionale, instalohen matësa individuale për ujin e ngrohtë sanitar.
7. Kriteret, metodologjitë dhe procedurat për përcaktimin e zbatueshmërisë teknike dhe koston efektive miratohen me urdhër të ministrit përgjegjës për energjinë.
8. Sistemet e matjes dhe njësorët e nxehtësisë të instaluar sipas këtij neni, mundësojnë në çdo rast leximin nga distanca.

## **Neni 22**

### **Informacioni në faturimin e gazit natyror**

1. Kur klientët fundorë nuk kanë matës inteligjentë për gazin natyror siç referohet në nenin

- 104 të ligjit 102/2015 "Për Sektorin e Gazit Natyror", shoqëritë e furnizimit me gaz natyror sigurojnë që informacioni i faturimit për gazin natyror të jetë i besueshëm, i saktë dhe i bazuar në konsumin aktual.
2. Për zbatim të pikës 1, të këtij neni, Enti Rregullator i Energjisë miraton kërkesat minimale për faturimin dhe informacionin e përfshirë në faturë bazuar në konsumin aktual të gazit natyror.
  3. Matësit e instaluar në përputhje me ligjin 102/2015 "Për Sektorin e Gazit Natyror", mundësojnë dhënien e informacionit të saktë të faturimit bazuar në konsumin aktual. Shoqëritë e furnizimit me gaz natyror garantojnë që klientët fundorë të aksesojnë lehtësisht informacionin plotësues mbi konsumin historik, duke lejuar vetëkontroll të detajuar.
  4. Informacioni plotësues mbi konsumin historik përfshin:
    - a) të dhëna kumulative për të paktën tre vitet e mëparshme ose periudhën që nga fillimi i kontratës së furnizimit nëse kjo është më e shkurtër;
    - b) të dhëna të detajuara sipas kohës së përdorimit për çdo ditë, javë, muaj dhe vit.
  5. Të dhënat e përmendura në shkronjën (a) të pikës 4 të këtij neni korrespondojnë me intervalet për të cilat është prodhuar informacioni i shpeshtë i faturimit.
  6. Të dhënat e përmendura në shkronjën (b) të pikës 4 të këtij neni vihen në dispozicion klientit përfundimtar nëpërmjet internetit ose ndërfaqes së matësit për të paktën 24 muajt e mëparshëm ose periudhën që nga fillimi i kontratës së furnizimit nëse kjo është më e shkurtër.
  7. Pavarësisht nëse janë instaluar matës inteligjentë, Enti Rregullator i Energjisë:
    - a) kërkon në masën që informacioni mbi faturimin e energjisë dhe konsumin historik i konsumatorëve fundorë është i disponueshëm, ai t'i vihet në dispozicion, me kërkesë të konsumatorit fundor, një ofruesi të shërbimit të energjisë të caktuar nga konsumatori përfundimtar;
    - b) siguron që klientëve fundor t'u mundësohet marrja e informacionit dhe faturave në mënyrë elektronike dhe që ata të marrin, sipas kërkesës, një shpjegim të qartë dhe të kuptueshëm se si është nxjerrë fatura e tyre, veçanërisht kur faturat nuk bazohen në konsumin aktual;
    - c) siguron që informacioni i duhur të vihet në dispozicion me faturën për t'i ofruar klientëve përfundimtarë një llogari të plotë të kostove aktuale të energjisë, në përputhje me pikën 2 të këtij neni;
    - ç) kërkon që informacioni dhe vlerësimet për kostot e energjisë t'u ofrohen konsumatorëve sipas kërkesës në kohën e duhur dhe në një format lehtësisht të kuptueshëm, duke u mundësuar konsumatorëve të krahasojnë marrëveshjet në një bazë të ngjashme.
  8. Klientët fundorë marrin pa pagesë faturat dhe informacionin e faturimit për konsumin e energjisë, si dhe gëzojnë akses të përshtatshëm dhe pa pagesë në të dhënat e tyre të konsumit.
  9. Detyrimi sipas pikës 1, të këtij neni, realizohet edhe përmes një sistemi të vetë-leximit periodik nga klientët fundorë, të cilët komunikojnë leximet e matësit tek furnizuesi i gazit natyror. Vetëm në rast se klienti fundor nuk jep leximin e matësit për një periudhë faturimi, faturimi mund të bazohet në konsum të vlerësuar ose tarifë fikse.

### **Neni 23**

#### **Informacioni i faturimit dhe konsumit për ngrohje, ftohje dhe ujë të ngrohtë sanitar**

1. Kur janë instaluar matësa ose pajisje për ndarjen e kostos së nxehtësisë, shoqëritë e furnizimit me ngrohje, ftohje ose ujë të ngrohtë sanitar sigurojnë që informacioni i faturimit të jetë i besueshëm, i saktë dhe i bazuar në konsumin aktual ose në leximet e

- këtyre pajisjeve, sipas rastit.
2. Detyrimi sipas pikës 1 të këtij neni, mund të përmbushet edhe përmes një sistemi të vetë-leximit periodik nga klientët fundorë, të cilët komunikojnë leximet tek furnizuesi. Vetëm në rast se klienti fundor nuk jep lexim për një periudhë faturimi, faturimi mund të bazohet në konsum të vlerësuar ose tarifë fikse.
  3. Për zbatim të pikës 1 të këtij neni, ministria përgjegjëse për energjinë miraton kërkesat minimale për faturimin dhe informacionin e përfshirë në faturë bazuar në konsumin aktual të ngrohjes, ftohjes dhe ujit të ngrohtë sanitar.
  4. Ministria përgjegjëse për energjinë:
    - a) kërkon që, nëse informacioni mbi faturimin e energjisë dhe konsumin historik ose leximet e alokuesit të kostos së nxehtësisë të konsumatorëve fundorë është i disponueshëm, ai t'i vihet në dispozicion me kërkesë të konsumatorëve fundorë, një ofruesi të shërbimit të energjisë të caktuar nga klienti fundorë;
    - b) siguron që klientëve fundorë t'u ofrohet opsioni i informacionit dhe faturave elektronike të faturimit;
    - c) siguron që informacioni i përfshirë në faturë për të gjithë konsumatorët fundorë të jetë i qartë dhe i kuptueshëm në përputhje me kërkesat e miratuara sipas pikës 3 të këtij neni.
    - ç) promovon sigurinë kibernetike dhe siguron mbrojtjen e privatësisë dhe të dhënave të konsumatorëve fundorë në përputhje me ligjislacionin në fuqi.
  5. Ministria përgjegjëse për energjinë përcakton subjektin përgjegjës për ofrimin e informacionit të përmendur në pikat 1 dhe 4 për klientët fundorë pa një kontratë të drejtpërdrejtë ose individuale, me një ofrues të furnizimit me energji.
  6. Klientët fundorë marrin të gjitha faturat dhe informacionin e faturimit për konsumin e energjisë pa pagesë dhe kanë akses në të dhënat e tyre të konsumit në mënyrën e duhur dhe pa pagesë.
  7. Pavarësisht nga pika 6 e këtij neni, shpërndarja e kostove të informacionit të faturimit për konsumin individual të ngrohjes, ftohjes dhe ujit të ngrohtë sanitar në ndërtesat me shumë apartamente dhe me shumë qëllime, sipas nenit 15, kryhet pa qëllim fitimi. Kostot që rezultojnë nga caktimi i kësaj detyre një pale të tretë, si një ofrues shërbimi ose furnizues lokal i energjisë, që mbulon matjen, shpërndarjen dhe llogaritjen e konsumit aktual individual në ndërtesa të tilla, mund t'u kalohen përdoruesve fundorë vetëm në masën që këto kosto janë të arsyeshme dhe proporcionale.”

## **KREU VI**

### **INFORMIMI DHE FUQIZIMI I KONSUMATORËVE FUNDORË**

#### **Neni 24**

#### **Të drejtat kontraktuale të klientëve fundorë për ngrohjen, ftohjen dhe ujin e ngrohtë sanitar**

1. Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, shoqëritë që ofrojnë furnizimin me ngrohje, ftohje dhe ujë të ngrohtë sanitar, për klientët fundorë, pa cenuar legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e konsumatorit, përfshijnë të drejtat kontraktuale të parashikuara në këtë nen, në çdo kontratë të nënshkruar me klientët fundorë.
2. Klientët fundorë kanë të drejtën e një kontrate me furnizuesin e tyre që specifikon:
  - a) identitetin, adresën dhe detajet e kontaktit të furnizuesit;
  - b) shërbimet e ofruara dhe nivelet e cilësisë së shërbimit të përfshira;
  - c) llojet e shërbimeve të mirëmbajtjes të përfshira në kontratë pa tarifa shtesë;
  - ç) mjetet me të cilat mund të merret informacion i përditësuar mbi të gjitha tarifat e

- zbatueshme, tarifat e mirëmbajtjes dhe produktet ose shërbimet ndërlidhura;
- d) kohëzgjatja e kontratës, kushtet për rinovimin dhe përfundimin e kontratës dhe shërbimeve, duke përfshirë produktet ose shërbimet që janë të përfshira me këto shërbime, dhe nëse lejohet përfundimi i kontratës pa penalitete;
  - dh) çdo marrëveshje kompensimi dhe rimbursimi që zbatohet nëse nivelet e cilësisë së shërbimit të kontraktuar nuk përmbushen, duke përfshirë faturimin e pasaktë ose të vonuar;
  - e) mënyrën e fillimit të një procedure të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve jashtë gjykatës në përputhje me pikën 5 të nenit 25 të këtij ligji;
  - ë) informacion në lidhje me të drejtat e konsumatorit, duke përfshirë informacionin për trajtimin e ankesave dhe të gjithë informacionin e përmendur në këtë paragraf, i cili komunikohet qartë në faturë ose në faqen e internetit të ofruesit të shërbimit dhe përfshin detajet e kontaktit ose lidhjen në faqen e internetit të pikave të kontaktit (të përmendura në shkronjën (d) të pikës 3 të nenit 22;
  - f) detajet e kontaktit që i mundësojnë klientit të identifikojë shërbimet përkatëse me një ndalesë siç përmendet në shkronjën (a) të pikës 3 të nenit 25.
3. Kushtet e furnitorëve do të jenë të drejta dhe do t'u ofrohen klientëve fundorë paraprakisht. Informacioni i përmendur në këtë paragraf jepet përpara lidhjes ose konfirmimit të kontratës edhe në rastet kur kontrata është lidhur përmes ndërmjetësve.
  4. Klientëve fundor ju sigurohet një përmbledhje e kushteve kryesore kontraktuale, duke përfshirë çmimet dhe tarifat, në një mënyrë të kuptueshme dhe në një gjuhë koncize dhe të thjeshtë.
  5. Klientëve fundor ju sigurohet një kopje e kontratës dhe informacion i qartë, në mënyrë transparente, mbi çmimet dhe tarifat e aplikueshme dhe për termat dhe kushtet standarde në lidhje me aksesin dhe përdorimin e shërbimeve të ngrohjes, ftohjes dhe ujit të ngrohtë sanitar. Ministria përgjegjëse për energjinë ofron informacionin e përmendur në këtë pikë për përdoruesit fundorë që nuk kanë kontratë të drejtpërdrejtë me furnizuesin, sipas kërkesës dhe pa pagesë.
  6. Klientët fundor njoftohen për çdo synim për të modifikuar kushtet kontraktuale. Furnizuesit njoftojnë klientët e tyre fundor, në mënyrë transparente dhe të kuptueshme, drejtpërdrejt për çdo ndryshim në çmimin e furnizimit dhe për arsyet dhe parakushtet për rregullimin dhe qëllimin e tij, në një kohë të përshtatshme, përpara se rregullimi të hyjë në fuqi prej:
    - a) jo më vonë se një muaj në rastin e klientëve familjarë, dhe
    - b) jo më vonë se dy javë për klientët e tjerë
  7. Furnizuesit iu ofrojnë klientëve fundor një gamë të gjerë mënyrash pagese. Këto mënyra pagese nuk duhet të bëjnë dallime të padrejta midis klientëve. Çdo ndryshim në tarifat në lidhje me mënyrat e pagesës ose sistemet e parapagimit duhet të jetë objektiv, jodiskriminues dhe proporcional dhe nuk duhet të tejkalojë kostot e drejtpërdrejta të përballuara nga marrësi për përdorimin e një mënyre specifike pagese ose një sistemi parapagimi, në përputhje Ligj nr. 55/2020 “Për shërbimet e pagesave”.
  8. Në bazë të pikës 7 të këtij neni, klientët familjarë që kanë akses në sistemet e parapagimit nuk do të vendosen në disavantazh nga sistemet e parapagimit.
  9. Klientëve fundor dhe, kur është e zbatueshme, përdoruesve fundor u ofrohen terma dhe kushte të përgjithshme të drejta dhe transparente, të cilat do të ofrohen në gjuhë të thjeshtë dhe të qartë dhe nuk do të përfshijnë barriera jokontraktuale për ushtrimin e të drejtave të klientëve, si p.sh. dokumentacioni kontraktor. Përdoruesve përfundimtarë do t'u sigurohet akses në ato terma dhe kushte të përgjithshme sipas kërkesës. Konsumatorët përfundimtarë dhe përdoruesit përfundimtarë do të mbrohen nga metodat e padrejta ose mashtruese të shitjes. Klientëve përfundimtarë me aftësi të kufizuara do t'u jepen të gjitha informacionet

- përkatëse për kontratën e tyre me furnizuesin e tyre në formate të aksesueshme.
10. Klientët fundor dhe përdoruesit fundor do të kenë të drejtën për një standard të mirë shërbimi dhe trajtimin e ankesave nga furnizuesit e tyre. Furnizuesit do t'i trajtojnë ankesat në mënyrë të thjeshtë, të drejtë dhe të shpejtë.
  11. Autoritetet kompetente zbatojnë masat për mbrojtjen e konsumatorit të përcaktuara në këtë ligj dhe veprojnë në mënyrë të pavarur nga çdo interes i tregut.
  12. Në rastin e ndërprerjeve të planifikuara, klientëve fundorë u sigurohet informacioni i duhur për masat alternative, të paktën një muaj para ndërprerjes së planifikuar dhe pa kosto shtesë.

## **Neni 25**

### **Informimi dhe ndërgjegjësimi**

1. Agjencia përgjegjëse për eficientë energjetike, në bashkëpunim me njësitë e qeverisjes vendore, aty ku është e aplikueshme, siguron që informacioni mbi masat e disponueshme për përmirësimin e eficientë energjetike, veprimet individuale dhe kornizat financiare dhe ligjore të jenë transparente, të aksesueshëm dhe të shpërndara gjerësisht për të gjithë palët e interesuara siç janë klientët fundorë, përdoruesit fundorë, organizatat e konsumatorëve, përfaqësuesit e shoqërisë civile, komunitetet e energjisë së rinovueshme, komunitetet energjetike qytetase, autoritetet vendore dhe rajonale, agjencitë e energjisë, ofruesit e shërbimeve sociale, ndërtuesit, arkitektët, inxhinierët, audituesit mjedisorë dhe të energjisë, si dhe instaluesit e elementeve të ndërtesave.
2. Në Planin kombëtar të Energjisë dhe Klimës përfshihen masa për të nxitur dhe lehtësuar përdorimin eficient të energjisë nga konsumatorët fundor dhe përdoruesit fundorë.
3. Masat përfshijnë një sërë instrumentesh dhe politikash për të nxitur ndryshimet e sjelljes si:
  - a) stimujt fiskalë;
  - b) akses në financa, kupona, grante ose subvencione;
  - c) vlerësimet e konsumit të energjisë të mbështetura publikisht dhe shërbimet e synuara këshillimore dhe mbështetja për konsumatorët familjarë, në veçanti njerëzit e prekur nga varfëria energjetike, klientët në nevojë dhe, aty ku është e aplikueshme, njerëzit që jetojnë në banesa sociale;
  - ç) shërbime këshilluese të synuara për NVM-të dhe mikrondërmarrjet;
  - d) dhënien e informacionit në formë të aksesueshme për personat me aftësi të kufizuara;
  - dh) projektet dhe praktikat më të mira;
  - e) aktivitetet në vendin e punës;
  - ë) aktivitetet e trajnimit;
  - f) mjetet digjitale;
  - g) strategjitë e angazhimit.
4. Masat e përmendura në pikën 3 të këtij neni, përfshijnë krijimin e një kuadri mbështetës për palët e interesuara të përmendura në pikën 1 të këtij neni, veçanërisht për:
  - a) krijimin e mekanizmave për ofrimin e këshillave dhe asistencës teknike, administrative dhe financiare për eficientë e energjisë, të tilla si kontrollet e energjisë për familjet, rinovimet energjetike të ndërtesave, informacioni për zëvendësimin e sistemeve të vjetra dhe joeficiente të ngrohjes me pajisje moderne dhe më eficiente, si dhe përdorimin e energjisë së rinovueshme dhe ruajtjes së energjisë për ndërtesat nga klientët fundorë dhe përdoruesit fundorë, veçanërisht ato shtëpiake dhe të vogla jofamiljare, duke përfshirë NVM-të dhe mikrondërmarrjet;

- b) bashkëpunimi me aktorët privatë që ofrojnë shërbime të tilla si auditimet e energjisë dhe vlerësimet e konsumit të energjisë, zgjidhjet e financimit dhe ekzekutimi i rinovimeve të energjisë;
  - c) komunikimin e ndryshimeve me kosto efektive dhe të lehtë për t'u arritur në përdorimin e energjisë;
  - ç) shpërndarjen e informacionit mbi masat e eficientë të energjisë dhe instrumentet e financimit;
  - d) sigurimin e pikave të vetme të kontaktit, për t'u ofruar klientëve përfundimtarë dhe përdoruesve përfundimtarë të gjithë informacionin e nevojshëm në lidhje me të drejtat e tyre, ligjin në fuqi dhe mekanizmat e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në dispozicion të tyre në rast mosmarrëveshjeje. Këto pika të vetme kontakti mund të jenë pjesë e pikave të përgjithshme të informacionit të konsumatorit.
5. Për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve pa përfshirjen e gjykatës, në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e parashikuara në këtë ligj, palët e interesuara i drejtohen strukturës ZAM të krijuar në përputhje me ligjin Nr. 9902, datë 17.4.2008 “Për mbrojtjen e konsumatorëve”.
6. Kur është e nevojshme, struktura ZAM bashkëpunon për të ofruar mekanizma të thjeshtë, të drejtë, transparent, të pavarur, efektiv dhe efikas të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve jashtë gjykatës për çdo mosmarrëveshje që lind nga produkte ose shërbime që janë të lidhura ose të ndërlidhura me çdo produkt ose shërbim që bie nën fushën e zbatimit të këtij ligji.
7. Pjesëmarrja e ndërmarrjeve në mekanizmat e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve jashtë gjykatës për klientët familjarë është e detyrueshme.
8. Agjencia përgjegjëse për eficientë të energjetike krijon dhe administron një sistem informativ të dedikuar për eficientë të energjisë, si pjesë e portalit e-Albania, i cili shërben si pikë e vetme kontakti për informimin, këshillimin dhe orientimin e përdoruesve në lidhje me masat e eficientës së energjisë.
9. Platforma ngarkohet dhe përditësohet në mënyrë të vazhdueshme nga agjencia përgjegjëse për eficientë të energjisë, duke përfshirë informacion mbi praktikatat më të mira, historitë e suksesit dhe zhvillimet në fushën e eficientës së energjisë.
10. Platforma ofron asistencë për përdoruesit përmes një asistenti virtual, i cili mundëson dhënien e përgjigjeve automatike për pyetjet e shpeshta, si dhe trajtimin e kërkesave të personalizuar të përdoruesve.
11. Me propozimin e agjencisë përgjegjëse për eficientë të energjisë, ministri përgjegjës për energjinë miraton formatin, përmbajtjen dhe kërkesat minimale të informacionit që duhet të përfshijë platforma.
12. Informacioni i publikuar në platformë përfshin të paktën:
- a) listën e shoqërive të certifikuar të shërbimeve energjetike (ESCO), të cilat ofrojnë zgjidhje për përmirësimin e eficientës së energjisë përmes kontratave të performancës energjetike, duke përfshirë informacion mbi fushën e veprimtarisë, përvojën, projektet e realizuara dhe kontaktet;
  - b) listën e profesionistëve të certifikuar, duke përfshirë audituesit e energjisë, menaxherët e energjisë dhe ekspertët e tjerë sipas profileve përkatëse;
  - c) informacion mbi masat e mundshme të eficientës së energjisë dhe kursimet e pritshme për secilën prej tyre;
  - ç) këshillim teknik, financiar dhe administrativ për masat e eficientës energjetike;
  - d) periudhën e vetëshlyerjes së investimeve për masat e propozuara;
  - dh) kontributin e masave në reduktimin e emetimeve të gazeve serrë;
  - e) informacion mbi instrumentet financiare të disponueshme, duke përfshirë grantet, subvencionet, kreditë dhe skemat mbështetëse;
  - ë) udhëzime praktike për zbatimin e masave të eficientës së energjisë, duke përfshirë

- f) procesin e aplikimit dhe hapat teknikë;
  - f) modele standarde të kontratave dhe dokumenteve orientuese për zbatimin e projekteve të efikasitetit të energjisë;
  - g) të dhëna të agreguara mbi projektet e realizuara dhe rezultatet e tyre;
  - gj) lidhje me programe kombëtare dhe ndërkombëtare mbështetëse për efikasitetin e energjisë.
  - h) shërbime të dedikuara për personat e prekur nga varfëria energjetike, klientët vulnerabël dhe njerëzit në familje me të ardhura të ulëta.
13. Platforma mundëson gjithashtu:
- a) krahasimin e opsioneve të ndryshme të investimeve në efikasitetin e energjisë;
  - b) lidhjen e përdoruesve me ofruesit e shërbimeve dhe aktorët e tregut;
  - c) aksesin në të dhëna të personalizuar dhe rekomandime për përmirësimin e performancës energjetike;
  - d) ndërveprimin me institucione publike dhe private përmes shërbimeve elektronike.
14. Për qëllim të promovimit të këtij shërbimi, AKSHI merr masa për të siguruar që platforma të jetë lehtësisht e aksesueshme dhe e dukshme për çdo person fizik ose juridik që përdor portalin, duke përfshirë integrimin e saj në ndërfaqet kryesore të aksesit dhe promovimin aktiv të përdorimit të saj.
15. Platforma zhvillohet dhe operohet në përputhje me kërkesat për mbrojtjen e të dhënave personale, sigurinë kibernetike dhe aksesueshmërinë për personat me aftësi të kufizuara.
16. Platforma mund të integrohet me sisteme të tjera shtetërore për të mundësuar automatizimin e proceseve të aplikimit për skema mbështetëse.

## **Neni 26**

### **Fuqizimi dhe mbrojtja e klientëve në nevojë dhe adresimi i varfërisë energjetike**

1. Ministria përgjegjëse për energjinë, në bashkëpunim me agjencinë përgjegjëse për efikasitetin e energjisë dhe ministrinë përgjegjëse për mbrojtjen sociale, propozon te Këshilli i Ministrave dhe përditëson periodikisht një plan për mbrojtjen dhe fuqizimin e personave të prekur nga varfëria energjetike, klientëve në nevojë, familjeve me të ardhura të ulëta dhe përdoruesve fundorë, sipas rastit.
2. Plani i përmendur në pikën 1 të këtij neni, miratohet nga Këshilli i Ministrave, me qëllim përfshirjen ose marrjen në konsideratë të tij gjatë hartimit ose përditësimit të dokumenteve strategjike kombëtare për energjinë dhe klimën.
3. Plani përfshin dhe merr në konsideratë, ndër të tjera:
  - a) identifikimin e kategorive të përfituesve dhe indikatorëve të varfërisë energjetike;
  - b) masa për përmirësimin e efikasitetit të energjisë në banesa, në veçanti për familjet në nevojë dhe banesat sociale;
  - c) masa financiare mbështetëse, duke përfshirë grante, subvencione dhe instrumente të tjera financimi;
  - ç) masa për përmirësimin e efikasitetit të energjisë me qëllim zbutjen e efekteve të politikave dhe masave të tjera, përfshirë masat fiskale dhe mekanizmat e çmimit të karbonit në sektorët e ndërtesave dhe transportit;
  - d) masa për përdorimin sa më efektiv të fondeve publike në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, përfshirë instrumentet financiare përkatëse, për mbështetjen prioritarë të investimeve në përmirësimin e efikasitetit të energjisë;
  - dh) investime të hershme dhe parandaluese në masat e përmirësimit të efikasitetit të energjisë, përpara shfaqjes së efekteve negative të politikave dhe masave të tjera;
  - e) promovimin e asistencës teknike dhe zhvillimin e instrumenteve financiare mbështetëse, duke përfshirë skema të pagesës përmes faturave mujore, fonde

- garancie, mekanizma për mbulimin e rrezikut dhe instrumente të dedikuara për rinovime të thelluara dhe përmirësime me kursime minimale të garantuara të energjisë;
- ë) mbështetjen e asistencës teknike për aktorët socialë, me qëllim nxitjen e përfshirjes aktive të klientëve në nevojë në tregun e energjisë dhe promovimin e ndryshimeve pozitive në sjelljen e tyre në përdorimin e energjisë;
  - f) sigurimin e aksesit në financa, grante dhe subvencione të lidhura me arritjen e niveleve minimale të kursimit të energjisë, si dhe lehtësimin e aksesit në kredi bankare me kosto të përballueshme ose linja të dedikuara kredie.
  - g) masa për adresimin e barrierave që lidhen me ndarjen e kostove dhe përfitimeve ndërmjet pronarëve dhe përdoruesve të ndërtesave;
  - gj) indikatorët për monitorimin dhe vlerësimin e zbatimit të planit.
4. Plani bazohet në të dhëna dhe indikatorë të verifikueshëm dhe synon reduktimin progresiv të varfërisë energjetike.
  5. Raportimi mbi zbatimin e planit realizohet në përputhje me kërkesat e raportimit të parashikuara nga mekanizmi qeverisës sipas Ligjit Nr. 155/2020 “Për Ndryshimet Klimatike”.
  6. Kryeministri urdhëron ngritjen e grupit të punës me profesionistë nga sektorë të ndryshëm, si shëndetësia, ndërtimi dhe shërbimet sociale, me qëllim mbështetjen e hartimit, zbatimit, monitorimit dhe përditësimit të planit për adresimin e varfërisë energjetike, si dhe për të asistuar vendimmarrjen në nivel vendor dhe kombëtar në lidhje me masat e përmirësimit të efijencës së energjisë, asistencën teknike dhe instrumentet financiare.
  7. Përbërja e grupit të punës siguron përfaqësim të balancuar dhe gjithëpërfshirës, duke marrë në konsideratë barazinë gjinore dhe reflektimin e perspektivave të të gjitha grupeve të shoqërisë.

## **KREU VII EFIJENCA NË SHPËRNDARJEN E ENERGJISË**

### **Neni 27 Vlerësimi dhe planifikimi i ngrohjes dhe ftohjes**

1. Për të nxitur efijencën e energjisë në ngrohje dhe ftohje, përfshirë kogjenerimin me efijencë të lartë, ministria, nëpërmjet agjencisë përgjegjëse për efijencën e energjisë, kryen një vlerësim gjithëpërfshirës të potencialit për aplikimin e kogjenerimit me efijencë të lartë, si dhe të ngrohjes dhe ftohjes efijente, duke përfshirë përdorimin e burimeve të rinovueshme dhe shfrytëzimin e nxehtësisë së mbetur.
2. Rezultatet e vlerësimit të potencialit sipas pikës 1, të këtij neni i paraqiten Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë.
3. Elementet, kërkesat dhe parimet e përgjithshme të analizës së kostos dhe përfitimit të një vlerësimi të tillë, si dhe përmbajtja minimale e vlerësimit gjithëpërfshirës, miratohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për energjinë.
4. Palët e interesuara që ndikohen nga vlerësimi gjithëpërfshirës i përmendur në pikën 1 marrin pjesë lirisht në përgatitjen e planeve të ngrohjes dhe ftohjes, vlerësimin gjithëpërfshirës dhe politikat dhe masat, duke siguruar në të njëjtën kohë ruajtjen e sekreteve tregtare ose sekreteve të biznesit, që identifikohen si të tilla prej tyre.
5. Vlerësimi gjithëpërfshirës i përmendur në pikën 1 të këtij neni, shoqërohet me një analizë kosto-përfitim që mbulon të gjithë territorin e vendit, në bazë të kushteve klimatike, fizibilitetit ekonomik dhe përshtatshmërisë teknike. Analiza kosto-përfitim do të jetë në gjendje të lehtësojë identifikimin e zgjidhjeve më efijente për burimet dhe koston për

plotësimin e nevojave për ngrohje dhe ftohje, duke marrë parasysh parimin "Efiçenca në krye", sipas nenit 5 të këtij ligji.

6. Ministri përgjegjës për energjinë me propozimin e agjencisë përgjegjëse për efiçencën energjetike, miraton kërkesat specifike për realizimin e analizës së kosto-përfitimit për vlerësimin gjithëpërfshirës të potencialit të ngrohjes dhe ftohjes efiçente."
7. Për të shfrytëzuar potencialin e identifikuar si rezultat i vlerësimit të kryer në përputhje me pikën 1 të këtij neni, në rastet kur përfitimet tejkalojnë kostot, në Planin Kombëtar të Energjisë dhe Klimës përfshihen masa dhe politika për të mundësuar realizimin e tij, si dhe për të siguruar zhvillimin e infrastrukturës dhe instalimeve përkatëse.
8. Këto politika dhe masa përmbajnë të paktën elementët e përcaktuara në udhëzimin e pikës 3 të këtij neni dhe raportohen si pjesë e raportit të progresit mbi Planin Kombëtar të Energjisë dhe Klimës."
9. Në varësi të potencialit të vlerësuar në përputhje me pikën 1 të këtij neni, njësitë e qeverisjes vendore hartojnë planin lokal të ngrohjes dhe ftohjes. Plani lokal për ngrohjen dhe ftohjen:
  - a) bazohet në informacionin dhe të dhënat e dhëna në vlerësimet gjithëpërfshirëse të kryera në përputhje me paragrafin 1 dhe të sigurojë një vlerësim dhe hartë të potencialit për rritjen e efikasitetit të energjisë, duke përfshirë gatishmërinë për ngrohje qendrore në temperaturë të ulët, kogjenerimin me efikasitet të lartë, ngrohjen e mbeturinave rikuperimi dhe energjia e rinovueshme në ngrohje dhe ftohje në atë zonë të caktuar;
  - b) është përputhje me parimin "Efiçenca në krye";
  - c) përfshinë një strategji për përdorimin e potencialit të identifikuar sipas pikës (a);
  - ç) përgatitet me përfshirjen e të gjithë aktorëve përkatës rajonale ose lokale dhe mundëson pjesëmarrjen e publikut të gjerë, duke përfshirë operatorët e infrastrukturës energjetike vendore;
  - d) merr parasysh infrastrukturën përkatëse ekzistuese të energjisë;
  - dh) merr parasysh nevojat e përbashkëta të komuniteteve vendore dhe njërive apo rajoneve të shumta administrative lokale ose rajonale;
  - e) vlerëson rolin e komuniteteve të energjisë dhe nismave të tjera të udhëhequra nga konsumatorët që mund të kontribuojnë në mënyrë aktive në zbatimin e projekteve lokale të ngrohjes dhe ftohjes;
  - ë) përfshinë një analizë të pajisjeve dhe sistemeve të ngrohjes dhe ftohjes në stokun e ndërtesave lokale, duke marrë parasysh potencialet specifike të zonës për masat e efiçencës së energjisë dhe duke adresuar ndërtesat me performancën më të keqe dhe nevojat e familjeve në nevojë;
  - f) vlerëson mënyrën e financimit të zbatimit të politikave dhe masave dhe identifikon mekanizmat financiarë që lejojnë konsumatorët të kalojnë në ngrohje dhe ftohje me burime të rinovueshme;
  - g) përfshinë një trajektore për të arritur qëllimet e planeve në përputhje me neutralitetin klimatik dhe monitorimin e ecurisë së zbatimit të politikave dhe masave të identifikuara;
  - gj) synon zëvendësimin e pajisjeve të vjetra dhe joefikase të ngrohjes dhe ftohjes në organet publike me alternativa me efiçencë të lartë energjetike, me synim largimin gradual të karburanteve fosile;
  - h) vlerëson sinergjitë e mundshme me planet e autoriteteve rajonale ose lokale fqinje për të inkurajuar investimet e përbashkëta dhe kosto-përfitimin.
10. Planet vendore për ngrohjen dhe ftohjen integrohen në plane të tjera të qeverisjeve vendore për aq kohë sa përfshihen kërkesat e parashikuara në pikën 9.
11. Për zbatimin e planeve lokale të ngrohjes dhe ftohjes dhe shfrytëzimin e potencialit të

identifikuar, ministria përgjegjëse për energjinë harton udhëzimin për mbështetjen e njësive të qeverisjes vendore në zbatimin e politikave dhe masave për ngrohjen dhe ftohjen efçente dhe të bazuar në burime të rinovueshme në nivel vendor dhe rajonal, si dhe i mbështet ato, në masën më të madhe të mundshme, përmes asistencës teknike dhe skemave të mbështetjes financiare.

12. Planet lokale të ngrohjes dhe ftohjes përpara miratimit nga Këshilli Bashkiak vlerësohen nga një ministria përgjegjëse për energjinë dhe agjencia përgjegjëse për efçencën energjetike dhe, nëse është e nevojshme, ndiqen nga masat e duhura për zbatim.

## Neni 28

### Furnizimi me ngrohje dhe ftohje

1. Për të siguruar konsum më efçent të energjisë primare dhe për të rritur peshën e energjisë së rinovueshme në furnizimin me ngrohje dhe ftohje që hyn në rrjet, një sistem efçent i ngrohjes dhe ftohjes qendrore nga 1 janari 2028, çdo sistem i instaluar për ngrohjen qendrore përdor vetëm energji nga rrjeti elektroenergjetik, energji të rinovueshme, nxehtësi të mbetur, nxehtësi nga një impiant kogjenerimi me efçencë të lartë ose një kombinim të tyre.
2. Qendrat e të dhënave me një input total të vlerësuar të energjisë që tejkalon 1 MW detyrohen të përdorin nxehtësinë e mbetur ose mundësojnë aplikime të tjera të rikuperimit të nxehtësisë së mbetur, përveç rasteve kur vërtetojnë se nuk është teknikisht ose ekonomikisht e realizueshme në përputhje me vlerësimin e përmendur në pikën 3.
3. Për të vlerësuar fizibilitetin ekonomik të rritjes së efçencës energjetike të furnizimit me ngrohje dhe ftohje, subjektet realizojnë një analizë kosto-përfitim për instalimin, kur instalimet e mëposhtme janë planifikuar rishtas ose janë rinovuar në mënyrë thelbësore:
  - a) një impiant kogjenerimi me një input total mesatar vjetor të energjisë që tejkalon 10 MW, me qëllim vlerësimin e kostove dhe përfitimeve të funksionimit të tij si instalim kogjenerimi me efçencë të lartë;
  - b) një instalim industrial me një input mesatar vjetor total të energjisë që tejkalon 8 MW për të vlerësuar përdorimin e nxehtësisë së mbetur në vendndodhje dhe jashtë tij;
  - c) një impiant shërbimi me një input total mesatar vjetor të energjisë që tejkalon 7 MW, të tilla si objektet e trajtimit të ujërave të zeza dhe objektet GNL, me qëllim vlerësimin e përdorimit të nxehtësisë së mbetur në vendndodhje dhe jashtë tij;
  - ç) një qendër të dhënash me një input total të vlerësuar të energjisë që tejkalon nivelin 1 MW për të vlerësuar analizën e koston dhe përfitimit, duke përfshirë, por pa u kufizuar në, fizibilitetin teknik, efikasitetin e koston dhe ndikimin në efçencën e energjisë dhe kërkesën lokale për ngrohje, duke përfshirë ndryshimin sezonal, të përdorimit të nxehtësisë së mbetur për të përmbushur kërkesën e justifikuar ekonomikisht, dhe të lidhjes së atij instalimi me një rrjet të ngrohjes qendrore ose një sistem ftohjeje qendrore efikas/të bazuar në BRE ose mbetje të tjera aplikacionet e rikuperimit të nxehtësisë.

Kjo analizë do të marrë në konsideratë zgjidhjet e sistemit të ftohjes që lejojnë heqjen ose kapjen e nxehtësisë së mbetur në nivelin e temperaturës së dobishme me inpute minimale të energjisë ndihmëse.
4. Ministri përgjegjës për energjinë miraton udhëzimin për realizimin e analizës së kosto-përfitimit. Analiza kosto-përfitim kryhet nga audituesit energjetik për instalime industriale në bashkëpunim me shoqëritë përgjegjëse për operimin e instalimit.
5. Instalimi i pajisjeve për kapjen e dioksidit të karbonit të prodhuar nga një instalim me djegie, me qëllim depozitimin e tij gjeologjik, nuk konsiderohet si rinovim i

- konsiderueshëm për qëllimet e shkronjave (b) dhe (c) të pikës 3 të këtij neni.
6. Kushtet, kriteret dhe kategoritë e instalimeve që përjashtohen nga kërkesat e pikës 3 të këtij neni miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave dhe i komunikohen Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë.
  7. Impiantet për ngrohjen dhe ftohjen qendrore pajisen me leje ndërtimi në përputhje me procedurat e parashikuara nga Ligji për Nxitjen e Përdorimit të Energjisë nga Buimet e Rinovueshme dhe marrin në konsideratë rezultatet e vlerësimit gjithëpërfshirës, si dhe rezultatet e analizës kosto-përfitim, duke siguruar përmbushjen e kërkesave të këtij neni.
  8. Kërkesat e këtij neni zbatohen edhe për instalimet që i nënshtrohen legjislacionit në fuqi për emetimet industriale, pa cenuar kërkesat e parashikuara në atë legjislacion.
  9. Subjektet përkatëse raportojnë analizat kosto-përfitim pranë ministrisë përgjegjëse për energjinë, e cila siguron mbledhjen dhe përpunimin e informacionit përkatës. Ky informacion përfshin, të paktën, të dhëna mbi sasinë e disponueshme të furnizimit me nxehtësi dhe parametrat e saj, numrin e orëve të planifikuara të operimit në vit dhe vendndodhjen gjeografike të instalimeve.
  10. Ministria përgjegjëse për energjinë siguron publikimin e këtyre të dhënave, duke respektuar konfidencialitetin dhe ndjeshmërinë e tyre.
  11. Enti Rregullator i Energjisë merr masa që origjina e energjisë elektrike të prodhuar nga kogjenerimi me efikasitet të lartë të garantohet përmes një sistemi të garancisë së origjinës, të bazuar në kriteret objektive, transparente dhe jodiskriminuese.
  12. Për qëllim të pikës 11, Enti Rregullator i Energjisë miraton metodologjinë dhe rregulloren përkatëse, për përcaktimin e procedurave, kriterëve dhe informacionit që përmbajnë garancitë e origjinës.
  13. Garancitë e origjinës njihen reciprokisht me marrëveshje, si provë e informacionit që përmbajnë, ndërsa refuzimi i njohjes së tyre bazohet në kriteret objektive, transparente dhe jodiskriminuese dhe i komunikohet Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë, së bashku me arsyet përkatëse.
  14. Mbështetja ekonomike, financiare dhe teknike për kogjenerimin jepet vetëm në rastet kur energjia elektrike prodhohet nga kogjenerimi me efikasitet të lartë dhe kur nxehtësia e mbetur përdoret në mënyrë efektive për arritjen e kursimeve në energjinë primare. Mbështetja për kogjenerimin, si dhe për sistemet e prodhimit dhe rrjetet e ngrohjes dhe ftohjes qendrore, zbatohet në përputhje me rregullat në fuqi për ndihmën shtetërore.

## **Neni 29**

### **Efiçenca energjetike në transformim, transmetim dhe shpërndarje**

1. Enti Rregullator i Energjisë zbaton parimin “Efiçenca energjetike në krye” në ushtrimin e detyrave të tij rregullatore, veçanërisht në vendimmarrjen lidhur me funksionimin e infrastrukturës së gazit natyror dhe energjisë elektrike, përfshirë përcaktimin e tarifave të rrjetit.
2. Në ushtrimin e këtij funksioni, Enti Rregullator i Energjisë konsideron edhe efikasitetin e kostos, efikasitetin e sistemit, sigurinë e furnizimit dhe integrimin e tregut, duke garantuar njëkohësisht përmbushjen e objektivave kombëtare për klimën dhe qëndrueshmërinë.
3. Operatorët e sistemeve të transmetimit dhe shpërndarjes së gazit natyror dhe energjisë elektrike zbatojnë parimin “Efiçenca në krye” në planifikimin e rrjetit, zhvillimin e tij dhe në vendimmarrjet për investime.
4. Enti Rregullator i Energjisë, verifikon që metodologjitë e përdorura nga këta operatorë përfshijnë vlerësimin e alternativave në analizat kosto-përfitim dhe marrin në konsideratë përfitimet më të gjera të masave të efiçencës së energjisë, përfshirë veprimet që rregullojnë

konsumin energjetik të konsumatorëve fundorë sipas nevojave të sistemit si dhe aftësinë e sistemit energjetik për t'u përshtatur me ndryshimet në furnizimin dhe kërkesën për energji dhe investimet që kontribuojnë në zbutjen e ndryshimeve klimatike.

5. Enti Rregullator i Energjisë verifikon gjithashtu zbatimin e parimit "Eficienca në krye" gjatë miratimit, verifikimit dhe monitorimit të projekteve dhe planeve të zhvillimit të rrjetit.
6. Rregullorja për vlerësimin e alternativave në analizat kosto-përfitim miratohet nga Enti Rregullator i Energjisë, në bashkëpunim me operatorët e sistemeve të transmetimit dhe shpërndarjes.
7. Operatorët e sistemeve të transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike dhe gazit natyror monitorojnë dhe përlogarisin vëllimin total të humbjeve në rrjet dhe, kur është teknikisht dhe financiarisht e mundshme, optimizojnë rrjetet dhe përmirësojnë eficientësinë e tyre.
8. Operatorët sipas pikës 7 të këtij neni,
  - a) raportojnë pranë Entit Rregullator të Energjisë masat e marra dhe kursimet e pritshme të energjisë nga reduktimi i humbjeve në rrjet;
  - b) vlerësojnë masat për përmirësimin e eficientësisë së energjisë në sistemet ekzistuese;
  - c) përmirësojnë eficientësinë në projektimin dhe operimin e infrastrukturës, përfshirë zhvillimin e rrjeteve inteligjente.
9. Enti Rregullator i Energjisë nxit zhvillimin e zgjidhjeve inovative për përmirësimin e eficientësisë së energjisë në sistemet ekzistuese dhe tek ato të planifikuara, përmes mekanizmave rregullatorë të bazuar në stimuj, në përputhje me parimet e tarifimit në sektorin e energjisë.
10. Enti Rregullator i Energjisë përfshin në raportin vjetor një seksion të veçantë mbi progresin e arritur në përmirësimin e eficientësisë së energjisë në operimin e infrastrukturës së gazit natyror dhe energjisë elektrike.
11. Në këtë raport, Enti Rregullator i Energjisë paraqet një vlerësim të eficientësisë së përgjithshme të operimit të infrastrukturës, masat e ndërmarra nga operatorët e sistemeve të transmetimit dhe shpërndarjes dhe, sipas rastit, jep rekomandime për përmirësimin e mëtejshëm të eficientësisë së energjisë, përfshirë alternativa me kosto efektive për reduktimin e ngarkesave maksimale dhe konsumit total të energjisë elektrike.
12. Rregullimi i rrjetit dhe tarifat e rrjetit për energjinë elektrike miratohen në mënyrë të tillë që të mundësojnë realizimin e investimeve të nevojshme në rrjet, duke garantuar qëndrueshmërinë dhe funksionimin e tij afatgjatë. Në këtë kuadër, Enti Rregullator i Energjisë siguron që rregullimi dhe tarifat e rrjetit të reflektojnë parimet e eficientësisë së energjisë dhe të nxisin zhvillimin dhe operimin efikas të sistemit.
13. Enti Rregullator i Energjisë siguron eliminimin e stimujve në tarifat e transmetimit dhe shpërndarjes që cenojnë eficientësinë e energjisë në prodhimin, transmetimin, shpërndarjen dhe furnizimin me energji elektrike dhe gaz natyror. Ministria përgjegjëse për energjinë, në bashkëpunim me Entin Rregullator të Energjisë, siguron që projektimi i infrastrukturës dhe operimi i saj të kryhen në mënyrë efikase dhe që strukturat tarifore të mundësojnë veprimet që rregullojnë konsumin energjetik të konsumatorëve fundorë sipas nevojave të sistemit.
14. Kërkesat për eficientësinë e energjisë për operatorët e sistemeve të transmetimit dhe shpërndarjes miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave dhe zbatimi i tyre në ushtrimin e veprimtarisë monitorohet nga Enti Rregullator i Energjisë.

15. Enti Rregullator i Energjisë, miraton ose përditëson, sipas rastit, rregullat për lidhjen në rrjet të prodhuesve të energjisë elektrike nga bashkëprodhimi me efikasitet të lartë.
16. Rregullat sipas pikës 15 të këtij neni, përcaktojnë të paktën:
  - a) rregullat standarde për përballimin dhe ndarjen e kostove të përshtatjeve teknike të nevojshme për integrimin në rrjet të prodhuesve të energjisë elektrike nga bashkëprodhimi me efikasitet të lartë, përfshirë lidhjen në rrjet, përfundimin e rrjetit, zhvillimin e rrjeteve të reja dhe përmirësimin e funksionimit të rrjetit;
  - b) rregullat për zbatimin objektiv, transparent dhe jodiskriminues të kodeve të rrjetit për këta prodhues;
  - c) informacionin që operatorët e sistemeve të transmetimit dhe shpërndarjes duhet t'u japin prodhuesve të rinj që kërkojnë lidhje në rrjet, përfshirë vlerësimin e detajuar të kostove të lidhjes, afatet për pranimin dhe shqyrtimin e kërkesës, si dhe afatin orientues për realizimin e lidhjes;
  - ç) afatin maksimal të procesit të lidhjes në rrjet, i cili nuk duhet të tejkalojë njëzet e katër (24) muaj nga data e paraqitjes së kërkesës së plotë, përveç rasteve të justifikuara objektivisht për arsye teknike, të sigurisë së sistemit ose rrethana të tjera të arsyeshme;
  - d) procedurat e standardizuara dhe të thjeshtuara për lidhjen e prodhuesve të shpërndarë të energjisë elektrike nga bashkëprodhimi me efikasitet të lartë.
17. Rregullat sipas pikës 15 të këtij neni bazohen në kritere objektive, transparente dhe jodiskriminuese, marrin në konsideratë kostot dhe përfitimet si rezultat i lidhjes së këtyre prodhuesve në rrjet dhe mund të parashikojnë lloje të ndryshme lidhjeje, sipas karakteristikave teknike të instalimit dhe rrjetit.
18. Autoritetet përgjegjëse, në kuadër të raportimit sipas legjislacionit në fuqi për instalimet industriale, marrin në konsideratë përfshirjen e informacionit mbi nivelet e efikasitetit të energjisë të instalimeve që kryejnë djegie karburantesh me fuqi termike të instaluar prej 50 MW ose më shumë.

## **KREU VIII**

### **FONDI KOMBËTAR PËR EFIÇENCËN ENERGETIKE**

#### **Neni 30**

#### **Themelimi**

1. Fondi Kombëtar për Efikasitetin e Energjisë, krijohet me këtë ligj si agjenci autonome, person juridik publik, në kuptim të legjislacionit në fuqi për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore.
2. Fondi ka selinë në Tiranë dhe ushtron veprimtarinë e tij në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.
3. Fondi ka për mision mobilizimin, administrimin dhe përdorimin e burimeve financiare për nxitjen, mbështetjen, financimin dhe bashkëfinancimin e masave dhe projekteve të efikasitetit të energjisë, në përputhje me këtë ligj, strategjitë kombëtare të energjisë dhe klimës dhe dokumentet e tjera strategjike në këtë fushë.
4. Fondi gëzon autonomi administrative, organizative, teknike dhe financiare në ushtrimin e funksioneve të tij, në përputhje me këtë ligj, aktet nënligjore në zbatim të tij dhe legjislacionin në fuqi për menaxhimin financiar publik, kontrollin, auditimin, prokurimin publik, kontabilitetin dhe raportimin financiar.

5. Fondi është nën mbikëqyrjen funksionale të ministrit përgjegjës për energjinë. Ministria përgjegjëse për financat ushtron kompetencat e saj në lidhje me menaxhimin financiar publik, përdorimin e fondeve publike, instrumentet financiare, detyrimet shumëvjeçare dhe ndikimet buxhetore, sipas legjislacionit në fuqi.
6. Fondi i raporton ministrit përgjegjës për energjinë mbi veprimtarinë, performancën financiare dhe arritjen e objektivave, sipas afateve dhe formateve të përcaktuara në këtë ligj dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.
7. Fondi ka të drejtë të lidhë marrëveshje dhe kontrata, të fitojë të drejta dhe të marrë përsipër detyrime, të jetë palë në procese gjyqësore dhe administrative, të administrojë pasuritë dhe burimet financiare të tij, si dhe të hapë dhe të mbajë llogari bankare, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
8. Burimet e financimit të Fondit përcaktohen në nenin 43 të këtij ligji dhe përfshijnë fondet publike, financimet ndërkombëtare, kthimet nga investimet, kontributet e përcaktuara me ligj, të ardhurat nga tarifatat dhe pagesat, si dhe burime të tjera të ligjshme.
9. Fondi mund të përdorë instrumente financiare dhe mekanizma mbështetës për efikasitetin e energjisë, përfshirë grante, subvencione, financime të kthyeshme, hua të buta, garanci, asistencë teknike, mekanizma qarkullues dhe forma të tjera financimi, në përputhje me këtë ligj dhe legjislacionin në fuqi për veprimtarinë financiare dhe bankare.
10. Instrumentet financiare që përbëjnë veprimtari bankare ose financiare zbatohen drejtpërdrejt nga Fondi vetëm kur kjo lejohet shprehimisht nga legjislacioni në fuqi, ose nëpërmjet bankave, institucioneve financiare jobanka dhe institucioneve të tjera financiare të licencuara.
11. Statuti i Fondit miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të ministrit përgjegjës për energjinë dhe ministrit përgjegjës për financat. Statuti përcakton rregullat e hollësishme për organizimin dhe funksionimin e Fondit, në përputhje me këtë ligj.
12. Organizimi, funksionimi, organet drejtuese, procedurat e administrimit financiar, kriteret e përzgjedhjes së projekteve, mënyra e përdorimit të instrumenteve financiare, raportimi, auditimi dhe kontrolli i Fondit përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, në përputhje me këtë ligj.

### **Neni 31**

#### **Përshtatshmëria dhe pajtueshmëria**

1. Fondi financon ose bashkëfinancon vetëm masa, projekte dhe veprimtari që janë në përputhje me këtë ligj, dokumentet strategjike në fushën e energjisë dhe klimës, si dhe kriteret e përcaktuara në aktet nënligjore, programet dhe thirrjet përkatëse të Fondit.
2. Përfituesit e mbështetjes nga Fondi plotësojnë kriteret e përshtatshmërisë ligjore, financiare, teknike dhe institucionale, të përcaktuara në këtë ligj, aktet nënligjore, rregulloret e brendshme të Fondit dhe dokumentet e thirrjes respektive.
3. Të gjitha masat dhe projektet e mbështetura nga Fondi janë në përputhje me legjislacionin në fuqi për efikasitetin e energjisë, performancën energjetike të ndërtesave, energjinë e rinovueshme, prokurimin publik, ndihmën shtetërore, menaxhimin financiar publik, mbrojtjen e mjedisit, planifikimin dhe zhvillimin e territorit, sigurinë teknike, mbrojtjen nga zjarri, shëndetin dhe sigurinë në punë, si dhe me çdo kërkesë tjetër të zbatueshme sipas natyrës së projektit.
4. Në rastet kur projektet financohen ose bashkëfinancohen nga Bashkimi Evropian, institucionet financiare ndërkombëtare, partnerët zhvillimorë ose donatorët, Fondi dhe përfituesit zbatojnë edhe rregullat, kushtet, standardet dhe procedurat e përcaktuara në marrëveshjet përkatëse të financimit, për aq sa ato nuk bien ndesh me legjislacionin shqiptar.

5. Fondi siguron që çdo instrument financiar, grant, subvencion, financim i kthyesëm, garanci, asistencë teknike ose formë tjetër mbështetjeje të përdoret vetëm për qëllimin për të cilin është miratuar dhe në përputhje me kushtet e marrëveshjes së financimit.
6. Fondi kryen ose kërkon kryerjen e verifikimeve të nevojshme mbi përfituesit, projektet dhe shpenzimet e propozuara, përfshirë verifikimin e pronësisë, statusit ligjor, kapaciteteve financiare, konfliktit të interesit, përmbushjes së detyrimeve fiskale dhe çdo elementi tjetër të nevojshëm për të garantuar përdorimin e ligjshëm dhe efektiv të fondeve.
7. Fondi vendos në marrëveshjet me përfituesit detyrime të qarta për raportimin, ruajtjen e dokumentacionit, aksesin në kontroll dhe auditim, përdorimin e fondeve sipas qëllimit, respektimin e standardeve teknike dhe realizimin e kursimeve të energjisë të parashikuara.
8. Fondi merr masa për parandalimin, identifikimin dhe trajtimin e mashtrimit, korrupsionit, konfliktit të interesit, keqpërdorimit të fondeve, deklarimeve të rreme, financimeve të dyfishta dhe çdo praktike tjetër që cenon integritetin e veprimtarisë së tij.
9. Në rast konstatimi të shkeljeve, parregullsive, deklarimeve të rreme, përdorimit të fondeve në kundërshtim me qëllimin e miratuar ose mospërmbushjes së kushteve të marrëveshjes, Fondi ka të drejtë të zbatojë, në mënyrë proporcionale dhe të arsyetuar, një ose disa nga masat e mëposhtme: pezullimin e disbursimit, kërkesën për kthimin e fondeve, aplikimin e penaliteteve, zgjidhjen e marrëveshjes, përjashtimin e përfituesit nga financimet e ardhshme, si dhe njoftimin e organeve kompetente, sipas legjislacionit në fuqi.
10. Kriteret e detajuara të përshtatshmërisë, dokumentacioni i kërkuar, procedurat e verifikimit, rastet e papërshtatshmërisë, masat korigjuese dhe procedurat për trajtimin e parregullsive përcaktohen në rregulloret e brendshme të Fondit.

### **Neni 32**

#### **Organizimi i Fondit**

1. Organet drejtuese të Fondit janë Bordi Drejtues dhe Drejtori Ekzekutiv.
2. Bordi Drejtues është organi më i lartë vendimmarrës dhe mbikëqyrës i Fondit, përgjegjës për mbikëqyrjen e përgjithshme të veprimtarisë së tij, në përputhje me mandatin e parashikuar në këtë ligj dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.
3. Bordi Drejtues përbëhet nga shtatë (7) anëtarë me të drejtë vote, si në vijim:
  - a) dy (2) përfaqësues të ministrisë përgjegjëse për energjinë;
  - b) një (1) përfaqësues i ministrisë përgjegjëse për financat;
  - c) një (1) përfaqësues i agjencisë përgjegjëse për efikasitetin energjetik;
  - ç) një (1) përfaqësues i njësisë të vetëqeverisjes vendore, i propozuar nga shoqata përfaqësuese e tyre;
  - d) dy (2) përfaqësues të pavarur me përvojë profesionale në auditimin dhe menaxhimin energjetik.
4. Anëtarët e Bordit Drejtues emërohen me urdhër të Kryeministrit, me propozim të ministrit përgjegjës për energjinë, pas marrjes së propozimeve nga institucionet përkatëse.
5. Procedura, kriteret dhe dokumentacioni për përzgjedhjen e anëtarëve të Bordit Drejtues përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.
6. Anëtarët e Bordit Drejtues emërohen për një mandat pesë (5) vjeçar, me të drejtë riemërimi vetëm një herë. Pas përfundimit të mandatit, anëtari qëndron në detyrë deri në emërimin e anëtarit zëvendësues, por jo më shumë se gjashtë (6) muaj.
7. Kryetari i Bordit Drejtues zgjidhet nga anëtarët e Bordit, me shumicën e votave të të gjithë anëtarëve me të drejtë vote, në mbledhjen e parë të Bordit të sapokonstituuar. Bordi zgjedh edhe Zëvendëskryetarin, i cili ushtron funksionet e Kryetarit në mungesë të tij. Deri në zgjedhjen e Kryetarit, anëtari më i vjetër në moshë shërben si ushtrues i detyrës së kryetarit.

8. Kryetari thërret, kryeson dhe siguron mbarëvajtjen e rregullt të mbledhjeve të Bordit Drejtues.
9. Drejtori Ekzekutiv merr pjesë në mbledhjet e Bordit Drejtues pa të drejtë vote. Drejtori Ekzekutiv përjashtohet nga mbledhja kur Bordi shqyrton çështje që lidhen me konfliktin e interesit ose vlerësimin e performancës së tij.
10. Përfaqësues të donatorëve, institucioneve financiare ndërkombëtare, partnerëve zhvillimorë ose institucioneve të tjera mund të marrin pjesë në mbledhjet e Bordit Drejtues si vëzhgues, pa të drejtë vote, në përputhje me marrëveshjet përkatëse të financimit dhe rregullat e brendshme të Fondit.
11. Anëtarët e Bordit Drejtues nuk mund të jenë zyrtarë të zgjedhur, të emëruar politikë apo persona që kanë mbajtur pozita të zgjedhura ose udhëheqëse në cilëndo parti politike gjatë njëzet e katër (24) muajve para emërimit të tyre.
12. Anëtarët e Bordit Drejtues duhet të jenë individë me integritet të dalluar, arsimim adekuat dhe së paku pesë (5) vite përvojë profesionale relevante për veprimtarinë e Fondit, në fushat e financave, ekonomisë, inxhinierisë ose disiplinave të ngjashme.
13. Anëtarët e Bordit Drejtues kompensohen për pjesëmarrjen në mbledhjet e Bordit, sipas rregullave, masës dhe procedurës së përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave.
14. Pozicionet e Fondit që ushtrojnë funksione publike janë pjesë e shërbimit civil dhe rregullohen sipas legjislacionit në fuqi për nëpunësin civil. Punonjësit administrativë dhe mbështetës, që nuk ushtrojnë funksione publike, trajtohen sipas Kodit të Punës..
15. Rregullat e hollësishme përcaktohen në statutin e Fondit, në përputhje me nenin 30 të këtij ligji.

### **Neni 33**

#### **Kompetencat e Bordit Drejtues**

1. Bordi Drejtues është organi më i lartë vendimmarrës dhe mbikëqyrës i Fondit dhe ushtron kompetencat e mëposhtme:
  - a) propozon pranë ministrit përgjegjës për energjinë kriteret e posaçme profesionale për pozicionin e Drejtorit Ekzekutiv dhe, sipas rastit, paraqet vlerësime ose propozime lidhur me ecurinë në detyrë të tij, në përputhje me legjislacionin për nëpunësin civil;
  - b) miraton drejtimet strategjike të veprimtarisë së Fondit, programet shumëvjeçare dhe vjetore të financimit, si dhe treguesit kryesorë të performancës;
  - c) miraton buxhetin vjetor të Fondit, planin financiar, raportin vjetor të veprimtarisë dhe pasqyrat financiare vjetore;
  - ç) miraton politikat, programet dhe instrumentet financiare të Fondit, përfshirë grantet, subvencionet, financimet e kthyeshme, garancitë, asistencën teknike dhe mekanizmat qarkullues, në përputhje me këtë ligj dhe legjislacionin në fuqi;
  - d) miraton kriteret kryesore të pranueshmërisë së përfituesve, masave dhe projekteve që mund të mbështeten nga Fondi;
  - dh) miraton politikat e monitorimit, raportimit dhe verifikimit të rezultateve të projekteve të financuara nga Fondi, përfshirë kursimet e energjisë dhe përfitimet e tjera të matshme;
  - e) miraton lidhjen e marrëveshjeve të rëndësishme të financimit, bashkëpunimit ose partneritetit, sipas kufijve dhe procedurave të përcaktuara në statutin dhe rregulloret e brendshme të Fondit;
  - ë) autorizon Drejtorin Ekzekutiv për nënshkrimin e marrëveshjeve, kontratave ose akteve të tjera juridike, në rastet kur kjo kërkohet sipas statutit, rregulloreve të brendshme ose vendimeve të Bordit;

- f) miraton vendimet për administrimin, përdorimin, blerjen ose tjetërsimin e pasurisë së Fondit, sipas kufijve dhe procedurave të përcaktuara në legjislacionin në fuqi;
- g) miraton vendosjen e fondeve të lira të Fondit në llogari bankare ose instrumente të sigurta financiare, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe rregullat e menaxhimit financiar;
- gj) propozon ose miraton tarifën, pagesat ose ngarkesat e tjera që zbatohen nga Fondi, kur këto parashikohen nga ky ligj ose aktet nënligjore në zbatim të tij;
- h) miraton emërimin e audituesit të jashtëm të Fondit, në përputhje me legjislacionin në fuqi;
- i) shqyrton raportet periodike të Drejtorit Ekzekutiv mbi zbatimin e programeve, performancën financiare, ecurinë e projekteve dhe administrimin e riskut;
- j) miraton rregulloret e brendshme, manualët operacionale dhe procedurat e nevojshme për funksionimin e Fondit, në përputhje me këtë ligj, statutin dhe aktet nënligjore në zbatim të tij;
- k) ushtron kompetenca të tjera të përcaktuara në këtë ligj, statutin dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

### **Neni 34**

#### **Shkarkimi i anëtarëve të Bordit Drejtues**

1. Anëtari i Bordit Drejtues shkarkohet nga detyra kur:
  - a) nuk plotëson më kriteret e përcaktuara në nenin 32 pikat 11 dhe 12 të këtij ligji;
  - b) është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale me burgim 24 muaj ose më shumë;
  - c) është i paaftë të ushtrojë funksionet e mandatit për shkak të paaftësisë mendore ose fizike që ka zgjatur për më shumë se gjashtë (6) muaj;
  - ç) ka munguar në tri (3) mbledhje të njëpasnjëshme të Bordit Drejtues pa arsytim të qëndrueshëm.
2. Anëtari i Bordit Drejtues shkarkohet gjithashtu kur është angazhuar në veprimtari që përbëjnë shkelje të standardeve të integritetit, të rregullave për parandalimin e konfliktit të interesit ose të kodit të etikës së Fondit.
3. Shkarkimi i anëtarit të Bordit Drejtues vendoset me urdhër të Kryeministrit, me propozim të ministrit përgjegjës për energjinë. Procedura e shkarkimit përcaktohet në statutin e Fondit.
4. Anëtari i Bordit Drejtues ka të drejtë të japë dorëheqje nga detyra me njoftim paraprak me shkrim prej së paku një (1) muaj drejtuar Kryetarit të Bordit Drejtues, duke specifikuar datën efektive të dorëheqjes.
5. Në rastin e shkarkimit, dorëheqjes ose mbarimit të parakohshëm të mandatit për çdo arsye tjetër, vendi vakant plotësohet sipas procedurës së përcaktuar në nenin 32 të këtij ligji, brenda një afati jo më të gjatë se tre (3) muaj nga data e lindjes së vakancës.

### **Neni 35**

#### **Mbledhjet e Bordit Drejtues**

1. Mbledhjet e Bordit Drejtues kryesohen nga Kryetari, dhe në mungesë të tij, nga Zëvendëskryetari.
2. Bordi Drejtues mblidhet të paktën katër (4) herë në vit.
3. Mbledhjet e Bordit Drejtues thirren dhe njoftohen për të gjithë Anëtarët e tij nga Kryetari, i cili vendos rendin e ditës sipas propozimit të Drejtorit Ekzekutiv.
4. Mbledhjet mund të thirren edhe me kërkesë me shkrim të dy (2) anëtarëve të Bordit

Drejtues.

5. Thirrja për mbledhje u dërgohet të gjithë anëtarëve të paktën dhjetë (10) ditë pune para datës së mbledhjes, duke komunikuar kohën, vendin, rendin e ditës dhe dokumentacionin përkatës. Në raste urgjente, ky afat mund të shkurtohet.
6. Secili anëtar ka një votë. Në rast votash të barabarta, vota e Kryetarit është vendimtare.
7. Kuorumi arrihet me katër (4) anëtarë të pranishëm, ku njëri prej tyre është Kryetari ose Zëvendëskryetari.
8. Vendimet merren me shumicë të thjeshtë të anëtarëve të pranishëm. Mbledhjet dhe votimet me telekonferencë janë të lejuara, me kusht që të paktën dy (2) mbledhje në vit të mbahen me prani fizike.
9. Në përputhje me kriterin e kuorumit sipas pikës 7 të këtij neni, asnjë akt apo procedim i Bordit Drejtues nuk shfuqizohet për shkak të ekzistimit të një apo më shumë vendeve të lira në Bordin Drejtues.
10. Bordi Drejtues vendos krijimin e Komitetit të Auditimit, Komitetit të Menaxhimit të Riskut dhe, sipas nevojës, të komiteteve të tjera teknike ose këshillimore. Përbërja, funksionet dhe mënyra e funksionimit të tyre përcaktohen në statutin e Fondit.

### **Neni 36** **Drejtori Ekzekutiv**

1. Drejtori Ekzekutiv është organi drejtues ekzekutiv i Fondit, me kohë të plotë, përgjegjës për menaxhimin e përgjithshëm dhe vendimet operacionale të Fondit.
2. Drejtori Ekzekutiv ka statusin e anëtarit të trupës së nëpunësve civilë të nivelit të lartë drejtues, në kuptim të legjislacionit në fuqi për nëpunësin civil dhe organizimin e administratës shtetërore.
3. Drejtori Ekzekutiv caktohet në detyrë nga ministri përgjegjës për energjinë pas propozimit të Bordit Drejtues lidhur me profilin profesional dhe kriteret e posaçme, në përputhje me legjislacionin në fuqi për nëpunësin civil.
4. Kriteret, procedura e përzgjedhjes dhe caktimit në detyrë të Drejtorit Ekzekutiv përcaktohen në përputhje me legjislacionin në fuqi për trupën e nëpunësve civilë të nivelit të lartë drejtues.
5. Drejtori Ekzekutiv është përgjegjës për:
  - a) zbatimin e vendimeve dhe politikave të Bordit Drejtues dhe përfaqësimin e Fondit në marrëdhëniet me të tretët;
  - b) përgatitjen dhe propozimin për miratim të planit strategjik, planeve vjetore, buxhetit dhe pasqyrave financiare të Fondit, tek Bordi Drejtues;
  - c) hartimin dhe propozimin e politikave investuese, instrumenteve financiare dhe kriterëve të pranueshmërisë për miratim nga Bordi Drejtues;
  - ç) angazhimin dhe menaxhimin e personelit të Fondit, në përputhje me këtë ligj dhe legjislacionin në fuqi;
  - d) përgatitjen e raporteve periodike për Bordin Drejtues mbi zbatimin e programeve, performancën financiare dhe arritjen e treguesve të performancës;
  - dh) ofrimin e rekomandimeve për Bordin Drejtues për përmirësimin e veprimtarisë së Fondit dhe përputhshmërinë me legjislacionin në fuqi;
  - e) ushtrimin e veprimtarive të tjera në përputhje me këtë ligj, statutin dhe rregulloret e brendshme të Fondit.
6. Kompensimi i Drejtorit Ekzekutiv përcaktohet në përputhje me legjislacionin në fuqi për kategorinë e nëpunësve civilë të nivelit të lartë drejtues.

### **Neni 37**

## **Shkarkimi i Drejtorit Ekzekutiv**

1. Lirimi ose largimi i Drejtorit Ekzekutiv nga detyra bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi për nëpunësin civil dhe trupën e nëpunësve civilë të nivelit të lartë drejtues.
2. Bordi Drejtues mund t'i propozojë ministrit përgjegjës për energjinë fillimin e procedurës së lirimit të Drejtorit Ekzekutiv, kur konstaton mospërbushje të rëndë ose të përsëritur të detyrave të parashikuara në nenin 36 të këtij ligji.
3. Drejtori Ekzekutiv ka të drejtë të japë dorëheqje nga detyra në përputhje me legjislacionin në fuqi për nëpunësin civil.

## **Neni 38 Parimet funksionale**

1. Fondi funksionon në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe, varësisht nga burimi i fondeve, në përputhje me rregullat dhe kushtet e marrëveshjeve ndërkombëtare të financimit, kur Fondi shfrytëzon fonde të tilla.
2. Funksionimi i Fondit bazohet në parimet themelore të mëposhtme:
  - a) transparenca e plotë gjatë funksionimit, përfshirë transparencën ndaj publikut;
  - b) transparenca në prokurim dhe menaxhim të burimeve financiare;
  - c) respektimi i plotë i parimeve të llogaridhënies dhe raportimit financiar;
  - ç) mosdiskriminimi, paanësia dhe mundësitë e barabarta për të gjithë parashtruesit e kërkesave;
  - d) promovimi i partneritetit dhe bashkëpunimit me sektorin privat, partnerët ndërkombëtarë dhe institucionet shtetërore të nivelit qendror dhe vendor;
  - dh) integrimi i parimit të barazisë dhe përfshirjes sociale, duke siguruar që masat e financuara të jenë të aksesueshme për grupet e cënueshme dhe familjet me të ardhura të ulëta.
3. Investimet e Fondit të realizuara nëpërmjet thirrjeve për propozime bazohen në meritat teknike të projektit dhe të aplikuesit, sipas kriterëve të përcaktuara në thirrjen përkatëse.
4. Fondi operon në baza trevjeçare dhe vjetore programore, në përputhje me planet kombëtare të efikasitetit të energjisë dhe marrëveshjet ndërkombëtare të zbatueshme.
5. Fondi promovon përdorimin e sistemeve të menaxhimit të energjisë dhe auditimeve energjetike si bazë për vendimmarrje në investime.
6. Fondi operon në baza të qëndrueshme financiare, me tarifa ose burime të mjaftueshme për të mbuluar kostot administrative dhe operative.
7. Personeli i Fondit respekton dhe vepron në përputhje me parimet funksionale dhe kodin e etikës të miratuar nga Bordi Drejtues.

## **Neni 39 Komponentët qarkullues dhe joqarkullues**

1. Për të siguruar qëndrueshmëri financiare, Fondi funksionon si mekanizëm qarkullues, sipas përkufizimit të këtij ligji.
2. Fondi mban paralelisht një komponent joqarkullues për të ofruar grante, garanci të pjesshme dhe instrumente të tjera financiare të parapërtëritshme, si dhe për të mbuluar kthimet e fondeve të ofruara nga institucionet financuese me kushte kthimi.
3. Buxheti i komponentit joqarkullues është i mjaftueshëm për të mbuluar të gjitha shpenzimet administrative dhe operative të lidhura me këtë komponent.
4. Alokimi i fondeve në komponentin qarkullues ose joqarkullues përcaktohet në marrëveshjet përkatëse të financimit, para transferimit të fondeve në Fond.

5. Të dy komponentët monitorohen ndaras, duke përdorur sisteme të ndara monitorimi dhe kontabiliteti.
6. Transferimi i fondeve ndërmjet komponentit qarkullues dhe atij joqarkullues bëhet me vendim të Bordit Drejtues, i arsyetuar plotësisht, dhe kërkon miratimin paraprak të ministrisë përgjegjëse për energjinë, ministrisë përgjegjëse për financat, si dhe të donatorit ose institucionit ndërkombëtar financiar që ka ofruar fondet përkatëse, kur kjo është e aplikueshme.

#### **Neni 40**

#### **Tipet e instrumenteve të financimit**

1. Fondi, me vendim të Bordit Drejtues dhe pas marrjes së pëlqimit të ministrisë përgjegjëse për energjinë dhe ministrisë përgjegjëse për financat, zhvillon dhe ofron instrumente financiare të ndryshme nën komponentët qarkullues dhe joqarkullues, që promovojnë investime në fushën e efikasitetit të energjisë, përfshirë produkte të dedikuara kreditimi, skema garancie, mekanizma të ndarjes së riskut dhe instrumente të kombinuara financimi.
2. Çdo instrument financiar miratohet dhe zbatohet duke respektuar legjislacionin në fuqi dhe marrëveshjet ndërkombëtare të financimit, kur këto janë të aplikueshme.
3. Për çdo financim të miratuar, Fondi dhe përfituesit nënshkruajnë marrëveshje që përcaktojnë të drejtat dhe detyrimet e palëve.
4. Instrumentet financiare dhe marrëveshjet e ndërlidhura mund të përfshijnë, ndër të tjera:
  - a) Marrëveshje për Shërbime Energjetike për projekte që zbatohen nëpërmjet Fondit, sipas nenit 42 të këtij ligji;
  - b) marrëveshje financimi, të kombinuara ose jo me grante, për konsumatorë të kualifikuar rezidentë dhe përfitues të tjerë të pranueshëm;
  - c) instrumente të tjera financimi që synojnë konsumatorët e sektorit publik dhe privat për mbështetjen dhe zbatimin e masave të efikasitetit energjetike;
  - ç) instrumente financiare të posaçme, përfshirë grante, për mbështetjen e grupeve të cenueshme dhe familjeve në varfëri energjetike.
5. Instrumentet financiare të Fondit mund të kombinohen me asistencë teknike për zhvillimin e projekteve, me qëllim rritjen e cilësisë dhe realizueshmërisë së investimeve.
6. Fondi mbështet zhvillimin e programeve të financimit për sistemet e ngrohjes dhe ftohjes, përfshirë sistemet qendrore, me synim dekarbonizimin e tyre dhe rritjen e efikasitetit energjetike.

#### **Neni 41**

#### **Kushtet e përgjithshme për zbatimin e projekteve të mbështetura nga Fondi**

1. Fondi monitoron zbatimin e marrëveshjeve me përfituesit për të siguruar përmbushjen e të gjitha kushteve të përcaktuara në to, në mënyrë transparente dhe profesionale.
2. Fondi siguron mbështetje teknike për përfituesit potencialë në zhvillimin, përgatitjen dhe strukturimin e projekteve të efikasitetit të energjisë.
3. Procedurat e vlerësimit dhe përbërja e komiteteve të vlerësimit për procedurat e prokurimit të realizuara nga Fondi ose nga përfituesit e tij përcaktohen në thirrjen për propozime ose dokumentet standarde të tenderit. Komitetet e vlerësimit përfshijnë detyrimisht të paktën një ekspert të pavarur me ekspertizën e duhur për projektin që shqyrtohet, i cili vërteton përmbushjen e kushteve minimale teknike dhe specifikimeve të përcaktuara në thirrjen për propozime ose dokumentet standarde të tenderit. Komitetet e vlerësimit përdorin atje ku është e mundur metodën e kostos totale gjatë gjithë jetëgjatësisë të masës.

4. Fondi realizon pagesat vetëm pas plotësimit të kushteve përkatëse të marrëveshjes dhe zbaton penalitete në rast të mospajtueshmërisë me kushtet e saj.

#### **Neni 42**

#### **Marrëveshjet për Shërbime Energjetike**

1. Marrëveshjet për Shërbime Energjetike përbëjnë instrumentin kryesor të Fondit për zbatimin e investimeve të efikasitetit të energjisë, në kuadër të komponentit qarkullues.
2. Marrëveshja për Shërbime Energjetike lidhet ndërmjet Fondit dhe personit fizik ose juridik, publik ose privat, përfitues dhe rregullon financimin e investimeve në efikasitetin e energjisë nga Fondi, si dhe kthimin e investimit mbi bazën e kursimeve të realizuara në kostot e energjisë.
3. Përzgjedhja e projekteve dhe procedura e lidhjes së Marrëveshjes për Shërbime Energjetike kryhen në përputhje me rregullat e përcaktuara në nenin 48 të këtij ligji.
4. Marrëveshja për Shërbime Energjetike përcakton, të paktën:
  - a) vlerën e investimit të financuar nga Fondi;
  - b) kursimet e projektuara të energjisë dhe afatin e kthimit të investimit;
  - c) mënyrën, afatet dhe kushtet e kthimit të investimit ndaj Fondit;
  - ç) periudhën e kthimit të investimit, numrin dhe shumën e kësteve, të cilat bazohen në kursimet e projektuara të energjisë dhe nuk tejkalojnë pesëmbëdhjetë (15) vjet;
  - d) mundësinë e përshtatjes së periudhës së kthimit të investimit ose shumës së kësteve në rast ndryshimi të çmimit të energjisë, pa tejkalar afatin maksimal të përcaktuar në shkronjën (ç) të pikës 4 të këtij neni.
5. Verifikimi i kursimeve të realizuara kryhet në përputhje me metodologjinë e miratuar nga Këshilli i Ministrave dhe përbën bazë për fillimin e kthimit të investimit nga përfituesi ndaj Fondit, sipas kushteve të marrëveshjes.
6. Marrëveshjet për Shërbime Energjetike të lidhura sipas këtij neni nuk konsiderohen borxh publik, në kuptim të legjislacionit në fuqi për menaxhimin e borxhit publik.

#### **Neni 43**

#### **Burimet e financimit të Fondit**

1. Burimet e financimit të Fondit përfshijnë:
  - a) fondet nga Buxheti i Shtetit, përfshirë kapitalin fillestar të nevojshëm për themelimin dhe vitet e para të funksionimit të Fondit;
  - b) kontributet në formë granti ose subvencionit nga Qeveria Shqiptare dhe donatorët;
  - c) kontributet në natyrë nga Qeveria Shqiptare;
  - ç) kthimet nga investimet e realizuara nëpërmjet instrumenteve financiare të Fondit;
  - d) të ardhurat nga interesi i kapitalit dhe aktiveve të Fondit;
  - dh) kontributet nga subjektet e detyruara për përmbushjen e detyrimeve të kursimit të energjisë, sipas nenit 10 të këtij ligji;
  - e) financimet nga institucionet financiare ndërkombëtare, partnerët zhvillimorë dhe donatorët, nëpërmjet programeve, projekteve ose marrëveshjeve të financimit;
  - ë) huatë;
  - f) burime të tjera të ligjshme.
2. Fondi ndërmerr masa për mobilizimin e financimit privat për investimet në efikasitetin e energjisë, në përputhje me misionin dhe instrumentet e tij financiare të parashikuara në këtë ligj.

## **Neni 44**

### **Tarifat**

1. Fondi propozon tarifa për shërbimet që ofron, me qëllim sigurimin e qëndrueshmërisë financiare të veprimtarisë së tij, si në komponentin qarkullues ashtu edhe në atë joqarkullues.
2. Tarifat miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave me propozim të ministrit përgjegjës për energjinë dhe ministrit përgjegjës për financat, pas propozimit të Bordit Drejtues, në përputhje me nenin 33 të këtij ligji, duke u bazuar në parimet e racionalitetit, efikasitetit dhe sigurimit të operimit të qëndrueshëm të Fondit.
3. Tarifat publikohen në faqen zyrtare të internetit të Fondit.

## **Neni 45**

### **Raportimi financiar dhe auditimi**

1. Fondi mban llogaritë dhe regjistrat në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar dhe mban llogari të ndara për çdo instrument financiar.
2. Viti financiar i Fondit fillon në ditën e parë të janarit dhe përfundon në ditën e fundit të dhjetorit.
3. Fondi përgatit pasqyrat vjetore financiare në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar. Pasqyrat financiare auditohen dhe publikohen jo më vonë se data 30 qershor e vitit pasues.
4. Llogaritë, librat dhe pasqyrat financiare të Fondit auditohen nga një auditor i jashtëm i pavarur, i emëruar nga Bordi Drejtues në përputhje me legjislacionin në fuqi për auditimin ligjor. I njëjti auditor i jashtëm ose firmë auditimi nuk mund të angazhohet për më shumë se tre (3) vite të njëpasnjëshme.
5. Drejtori Ekzekutiv i dorëzon Bordit Drejtues pasqyrat financiare të audituara, së bashku me raportin e auditimit, të paktën pesëmbëdhjetë (15) ditë para datës së shqyrtimit të tyre. Bordi Drejtues shqyrton pasqyrat financiare të audituara dhe merr vendim për miratimin e tyre ose për kërkimin e sqarimeve, plotësimeve apo korrigjimeve të nevojshme.
6. Fondi publikon raportin vjetor dhe pasqyrat e audituara financiare në faqen e vet zyrtare të internetit pas miratimit nga Bordi Drejtues.
7. Raporti vjetor përfshin, ndër të tjera:
  - a) të gjitha informacionet relevante mbi veprimtarinë dhe objektivat e arritura në lidhje me synimet e efikasitetit të energjisë, penetrimin e burimeve të ripertitshme të energjisë dhe reduktimit të CO<sub>2</sub> gjatë vitit të raportimit;
  - b) listën e projekteve të financuara dhe burimet financiare të investuara, të kthyer dhe në dispozicion;
  - c) volumin e investimeve publike në efikasitetin e energjisë;
  - ç) nivelin e mobilizimit të financimit privat;
  - d) të dhëna mbi instrumentet financiare të përdorura;
  - dh) përshkrimin e skemave financiare dhe praktikave më të mira të zbatuara.
8. Fondi ia dërgon raportin vjetor, së bashku me pasqyrat financiare të audituara dhe raportin e auditimit, ministrit përgjegjës për energjinë dhe Këshillit të Ministrave jo më vonë se data 30 qershor e vitit pasues.
9. Fondi i nënshtrohet auditimit nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Auditimi nga Kontrolli i Lartë i Shtetit nuk përjashton detyrimin për auditimin e jashtëm të pavarur sipas këtij neni.
10. Të dhënat e raportuara nga Fondi sipas këtij neni përdoren nga ministria përgjegjëse për energjinë për përmbushjen e detyrimeve kombëtare dhe ndërkombëtare të raportimit në

fushën e energjisë dhe klimës

## **KREU IX**

### **AGJENCIA PËR EFIÇENCËN E ENERGJISË DHE SHËRBIMET ENERGJETIKE**

#### **Neni 46**

#### **Agjencia për Efiçencën e Energjisë**

1. Agjencia për Efiçencën e Energjisë, në vijim Agjencia, është person juridik publik, në varësi të ministrit përgjegjës për energjinë.
2. Agjencia financohet nga Buxheti i Shtetit dhe burime të tjera financimi jashtë Buxhetit të Shtetit, përfshirë burimet e financimeve të huaja, nëpërmjet programeve apo projekteve të ndryshme për promovimin e efiçencës dhe kursimit të energjisë.
3. Agjencia është përgjegjëse për zbatimin e politikave dhe nxitjen e masave për efiçencën e energjisë dhe ka detyrat e mëposhtme:
  - a) të përgatisë, të zbatojë dhe të monitorojë politikat dhe programet për përdorimin efiçent të energjisë në sektorët rezidencialë të shërbimeve, të industrisë, të transportit dhe të bujqësisë;
  - b) të përgatisë dhe të monitorojë Planin Kombëtar të Veprimit për Efiçencën e Energjisë;
  - c) t'i paraqesë çdo vit ministrit një raport të hollësishëm lidhur me zbatimin e Planit Kombëtar të Veprimit për Efiçencën e Energjisë;
  - ç) të bashkëpunojë me autoritetet qendrore dhe vendore, shoqëritë që operojnë në objektet industriale dhe organizatat e ndryshme jofitimprurëse për krijimin dhe përditësimin e bazës së nevojshme të të dhënave të energjisë, përfshirë llogaritjen e treguesve të efiçencës së energjisë, si dhe për zbatimin e masave për nxitjen e efiçencës së energjisë;
  - d) të përgatisë dhe t'i propozojë ministrit aktet e nevojshme nënligjore për nxitjen e efiçencës së energjisë, siç parashikohet në këtë ligj;
  - dh) të përgatisë standardet, normat dhe rregulloret teknike, me qëllim rritjen e efiçencës së energjisë së pajisjeve, aparaturave dhe makinerive që përdoren për prodhimin, transportin, shpërndarjen dhe konsumin e energjisë në sektorët rezidencialë të shërbimeve, të industrisë, të transportit e të bujqësisë;
  - e) të vlerësojë teknikisht projektet e investimeve në fushën e efiçencës së energjisë, të paraqitura pranë Fondit nga subjektet e interesuara;
  - ë) të propozojë lidhjen e marrëveshjeve vullnetare sipas përcaktimeve të nenit 44, të këtij ligji;
  - f) t'i propozojë Fondit dhënien e mbështetjes financiare për projektet që aplikojnë për financime nga Buxheti i Shtetit dhe burime të tjera të brendshme ose të jashtme për marrjen e masave për efiçencën e energjisë;
  - g) të përgatisë kontrata standarde për shërbime energjetike që financohen nga Fondi, të cilat miratohen nga ministri dhe t'i publikojë ato në faqen e saj zyrtare;
  - gj) të koordinojë programet e efiçencës së energjisë, të financuara nga institucionet ose organizatat ndërkombëtare, mbështetur në marrëveshjet qeveritare;
  - h) të bashkëpunojë me institucionet dhe organizatat vendase dhe ndërkombëtare, me qëllim përdorimin me efiçencë të energjisë dhe reduktimin e ndikimit negativ në mjedis;
  - i) të këshillojë autoritetet e administratës publike vendore, administratorët e ndërtesave publike dhe atyre me destinacion banimi për përgatitjen dhe zbatimin e projekteve të efiçencës së energjisë;

- j) të bashkëpunojë me organet akredituese, për marrjen e informacionit mbi rezultatet e testeve dhe matjeve, për përmbushjen e standardeve kombëtare të efikasitetit të energjisë;
- k) të zhvillojë dhe të koordinojë programet e trajnimit mbi efikasitetin energjetik;
- l) të këshillojë konsumatorët fundorë për programet e efikasitetit të energjisë të ndërmarra prej tyre;
- ll) të mbështesë dhe të këshillojë kryerjen e fushatave të ndërgjegjësimit publik dhe veprimtarive të tjera edukative lidhur me nxitjen e efikasitetit dhe kursimit të energjisë;
- m) të verifikojë, në rast se e çmon të nevojshme, saktësinë e të dhënave të raporteve të hartuara nga një auditues energjetik;
- n) të vendosë masat administrative, sipas nenit 54 të këtij ligji.

#### **Neni 47**

#### **Shoqëritë e shërbimeve energjetike**

1. Shoqëri e shërbimeve energjetike (ESCO) është çdo person juridik i certifikuar për ofrimin e shërbimeve energjetike ose masave për përmirësimin e performancës energjetike në objektet ose ambientet e klientëve përfundimtarë dhe që mbart riskun teknik dhe financiar në lidhje me realizimin e këtyre shërbimeve ku shpërblimi lidhet tërësisht ose pjesërisht në funksion të kursimeve të verifikuara të energjisë ose të përmirësimit të performancës energjetike të arritur.
2. Shoqëritë e shërbimeve të energjisë ofrojnë, ndër të tjera:
  - a) auditime energjetike;
  - b) projektim dhe zbatim të masave të efikasitetit të energjisë;
  - c) financim ose bashkëfinancim të investimeve për efikasitetin e energjisë;
  - ç) monitorim dhe verifikim të kursimeve të energjisë.
3. Këshilli i ministrave, me propozim të ministrisë përgjegjëse për energjinë miraton në përputhje me standardet evropiane dhe ndërkombëtare në fuqi, kapacitetet minimale teknike, financiare, organizative dhe profesionale për certifikimin e shoqërive që ofrojnë shërbime energjetike (ESCO).
4. Agjencia përgjegjëse për efikasitetin energjetik në bashkëpunim me agjencinë përgjegjëse për prokurimin publik promovon shërbimet energjetike për të gjithë palët e interesuara, duke shpërndarë informacion të qartë dhe lehtësisht të aksesueshëm mbi:
  - a) kontratat dhe klauzolat e disponueshme të shërbimeve energjetike që përfshihen në kontrata të tilla për të garantuar kursimin e energjisë dhe të drejtat e klientëve fundorë;
  - b) instrumentet financiare, stimujt, grantet, fondet qarkulluese, garancitë, skemat e sigurimit dhe kreditë për të mbështetur projektet për rritjen e efikasitetit përmes shërbimeve energjetike;
  - c) ofruesit e disponueshëm të shërbimeve energjetike, të tilla si ESCO, që janë të kualifikuar ose të certifikuar, në përputhje me pikën 3 të këtij neni;
  - ç) metodologjitë e disponueshme të monitorimit dhe verifikimit dhe skemat e kontrollit të cilësisë.
5. Informacioni sipas pikës 4 të këtij neni, vendoset në dispozicion të palëve të interesuara përmes faqes zyrtare të internetit, udhëzimeve ose manualeve.

6. Agjencia për Eficiencën e Energjisë krijon dhe mirëmban një regjistër publik të ofruesve të certifikuar të shërbimeve energjetike, i cili përditësohet menjëherë pas çdo ndryshimi dhe është i aksesueshëm për publikun në përputhje me pikën 4 shkronja “c” të këtij neni.
7. Format i regjistrit publik të ofruesve të certifikuar të shërbimeve energjetike miratohet me urdhër të ministrit përgjegjës për energjinë.
8. Agjencia përgjegjëse për eficiencën energjetike krijon dhe administron një mekanizëm të përhershëm për monitorimin e tregut të shërbimeve energjetike me qëllim identifikimin e barrierave rregullatore dhe jo-rregullatore dhe propozimin e masave për eliminimin e tyre.
9. Agjencia përgjegjëse për eficiencën energjetike harton çdo dy vjet raportin e vlerësimit të tregut dhe barrierat e identifikuara për zhvillimin e kontratave të performancës së energjisë.
10. Në kuadër të procesit të monitorimit të përcaktuar në pikën 8, Agjencia përgjegjëse për eficiencën e energjisë vlerëson edhe ndikimin e aktiviteteve të operatorëve të shpërndarjes së energjisë, operatorëve të sistemeve të shpërndarjes dhe shoqërive të shitjes së energjisë me pakicë në funksionimin e tregut të shërbimeve energjetike, duke identifikuar çdo praktikë që mund të pengojë kërkesën ose ofrimin e shërbimeve energjetike dhe masave të eficiencës, të kufizojë zhvillimin e kontratave të performancës së energjisë (ESCO), apo të shtrembërojë konkurrencën, përfshirë përjashtimin e operatorëve të tjerë ose abuzimin me pozicionin dominues, si dhe propozon masat përkatëse për eliminimin e tyre.
11. Agjencia përgjegjëse për eficiencën e energjisë siguron dhe vë në dispozicion të autoriteteve publike dhe aktorëve të tregut informacion mbi praktikat më të mira për zbatimin e kontratave të performancës së energjisë, duke përfshirë, kur është e disponueshme, analiza kosto-përfitim të bazuara në qasjen e kostos së ciklit jetësor, si dhe promovon, krijon dhe mirëmban një bazë të dhënash publike për projektet e zbatuara dhe në zbatim të këtyre kontratave, e cila përfshin, të paktën, kursimet e parashikuara dhe ato të arritura të energjisë dhe është e aksesueshme për publikun.
12. Adresimi i barrierave që pengojnë zhvillimin e tregut të shërbimeve energjetike kryhet në përputhje me nenin 52 të këtij ligji.

#### **Neni 48**

#### **Kontraktimi i performancës energjetike**

1. Kontraktimi i performancës energjetike nënshkruhet ndërmjet autoriteteve publike dhe shoqërive të certifikuara që ofrojnë shërbime energjetike (ESCO) sipas legjislacionit për prokurimin publik, si kontrata shërbimi me elemente investimi të financuara kryesisht nga operatori ekonomik (ESCO), ku pagesat lidhen me performancën energjetike..
2. Kontratat e performancës së energjisë (EPC) mund të lidhen për një periudhë shumëvjeçare, në përputhje me analizën ekonomike të projektit. Detyrimet financiare që rrjedhin nga këto kontrata trajtohen në përputhje me legjislacionin në fuqi për menaxhimin financiar dhe rregullat përkatëse për klasifikimin fiskal, duke marrë në konsideratë natyrën e kushtëzuar të pagesave dhe transferimin e riskut.
3. Pagesat ndaj operatorit kryhen kryesisht në funksion të kursimeve të energjisë të verifikuara gjatë zbatimit të kontratës dhe nuk përbëjnë detyrim të pakushtëzuar apo borxh publik për autoritetin kontraktues.
4. Operatori ekonomik (ESCO) mban përgjegjësinë gjatë gjithë kohëzgjatjes së kontratës për realizimin e investimit, operimin, mirëmbajtjen dhe arritjen e kursimeve të garantuara, duke përballuar risqet përkatëse teknike dhe financiare.

5. Masat, pajisjet dhe investimet e realizuara në kuadër të kontratës së performancës energjetike kalojnë në pronësi të autoritetit kontraktues në përfundim të kontratës, sipas kushteve të përcaktuara në kontratë.”.
6. Transferimi i aseteve në përfundim të kontratës kryhet në përputhje me kushtet kontraktore dhe nuk krijon detyrime të reja financiare përtej atyre të parashikuara në kontratë.
7. Këshilli i Ministrave, me propozim të përbashkët të ministrisë përgjegjëse për energjinë dhe agjencisë përgjegjëse për prokurimit publik, miraton modelet standarde të kontratës së performancës energjetike (KPE).
8. Kontrata sipas pikës 7 të këtij neni përmban të paktën:
  - a) Gjetjet dhe rekomandimet e përcaktuara në analizat dhe auditimet energjetike të kryera përpara lidhjes së kontratës, që mbulojnë përdorimin e energjisë së ndërtesës ose instalimit, me qëllim identifikimin dhe zbatimin e masave për përmirësimin e efikasitetit të energjisë;
  - b) Një përshkrim të qartë dhe transparent të masave të efikasitetit të energjisë që do të zbatohen, ose të rezultateve të performancës energjetike që do të arrihen;
  - c) Kursimet e garantuara të energjisë që do të arrihen si rezultat i zbatimit të masave të kontratës;
  - ç) Kohëzgjatjen e kontratës, fazat kryesore të zbatimit, si dhe kushtet dhe afatet e njoftimit për përfundimin ose ndryshimin e saj;
  - d) Një përcaktim të qartë dhe transparent të detyrimeve dhe përgjegjësisë të secilës palë kontraktuese;
  - dh) Përcaktimin e nivelit bazë të konsumit të energjisë (baseline), metodologjinë për llogaritjen e tij dhe datat referuese mbi të cilat maten kursimet e arritura;
  - e) Një përshkrim të detajuar të hapave për zbatimin e masave ose paketës së masave, si dhe, sipas rastit, kostot përkatëse të lidhura me to;
  - ë) Detyrimin për zbatimin e plotë të masave të parashikuara në kontratë, si dhe dokumentimin e çdo ndryshimi të bërë gjatë fazës së zbatimit;
  - f) Detyrimin që çdo nënkontraktim me palë të treta të përfshijë kërkesa të barasvlershme me ato të përcaktuara në këtë kontratë;
  - g) Një paraqitje të qartë dhe transparente të implikimeve financiare të projektit, përfshirë strukturën e financimit, shpërndarjen e kursimeve monetare ndërmjet palëve dhe ndarjen e riskut;
  - gj) Dispozita të qarta dhe transparente për matjen dhe verifikimin e kursimeve të garantuara, në përputhje me metodologji të njohura ndërkombëtare, si dhe kontrolle dhe garanci të cilësisë;
  - h) Dispozita për trajtimin e ndryshimeve në kushtet e jashtme që ndikojnë në zbatimin dhe rezultatet e kontratës, përfshirë ndryshimet në çmimet e energjisë dhe në intensitetin e përdorimit të ndërtesës ose instalimit;
  - i) Përcaktimin e detajuar të detyrimeve të palëve dhe të penaliteteve në rast të mosrespektimit të tyre.
9. Monitorimi dhe verifikimi i kursimeve të energjisë në kuadër të kontratave të performancës energjetike kryhet në përputhje me metodologjinë e miratuar nga Këshilli i Ministrave me propozimin e ministrisë përgjegjëse për energjinë.
10. Organet publike përdorin kontratat e performancës energjetike për rinovimin e ndërtesave në pronësi publike, kur kjo është teknikisht dhe ekonomikisht e realizueshme bazuar mbi rezultatet e studimit të fizibilitetit.

11. Për ndërtesat jorezidenciale me sipërfaqe totale të dobishme mbi 750 m<sup>2</sup>, organet publike kryejnë studimin e fizibilitetit për përdorimin e kontratave të performancës energjetike dhe të shërbimeve të tjera energjetike të bazuara në performancë..
12. Autoriteti përgjegjës për prokurimin publik nuk lejon shpalljen e procedurave që përfshijnë rinovimin e ndërtesave sipas pikave 10 dhe 11 të këtij neni, pa paraqitjen paraprake nga autoriteti kontraktor të studimit të fizibilitetit sipas pikës 4 të nenit 49, i cili përfshin detyrimisht analizën e zbatueshmërisë së kontratave të performancës së energjisë (ESCO) dhe të shërbimeve të tjera energjetike të bazuara në performancë.

### **Neni 49**

#### **Lidhja e kontratës së performancës energjetike**

1. Objektet me potencial për përmirësimin e performancës së energjisë identifikohen kryesisht nga Autoriteti kontraktues ose përmes programeve kombëtare për rritjen e performancës energjetike.
2. Identifikimi bazohet në analiza paraprake të konsumit të energjisë dhe nevojave për përmirësim.
3. Përpara çdo veprimi kontraktual, për objektet publike kryhet studimi i fizibilitetit i cili shërben si bazë për vendimmarrjen mbi përdorimin e shërbimeve ESCO për përmirësimin e performancës.
4. Studimi i fizibilitetit për kontratat e performancës së energjisë realizohet nga auditues të certifikuar të energjisë dhe përfshin të paktën:
  - a) analizën e gjendjes ekzistuese dhe konsumit aktual të energjisë;
  - b) përcaktimin e konsumit energjetik bazë për qëllime krahasimi;
  - c) identifikimin e masave të mundshme për përmirësimin e efikasitetit të energjisë;
  - ç) vlerësimin e kursimeve të pritshme të energjisë dhe të kostove përkatëse;
  - d) analizën ekonomike dhe financiare të projektit, përfshirë periudhën e rikuperimit të investimit;
  - dh) vlerësimin e mundësisë së zbatimit të kontratës EPC, përfshirë analizën krahasuese me opsione alternative të financimit;
  - e) vlerësimin e neutralitetit fiskal dhe të ndikimit në financat publike;
  - ë) identifikimin dhe shpërndarjen e risqeve ndërmjet palëve;
  - f) përcaktimin paraprak të metodologjisë së matjes dhe verifikimit të kursimeve të energjisë;
5. Në përcaktimin e konsumit bazë të energjisë (baseline), mund të merret në konsideratë edhe konsumi i munguar ose i pashfaqur, kur ky lidhet me nivelin e pamjaftueshëm të shërbimit, mosfunksionimin ose mungesën e sistemeve, si dhe me nevojën për arritjen e kushteve minimale të përdorimit dhe komfortit sipas standardeve të përcaktuara.
6. Ministri përgjegjës për energjinë përgatit udhëzimin për formatin e studimit të fizibilitetit për kontraktimin e performancës energjetike.
7. Punonjësit e institucioneve publike përgjegjëse përfitojnë shpërblim të veçantë, kur hartojnë studime fizibiliteti për llogari të institucioneve publike si dhe kur realizojnë oponentin.
8. Rregullat për organizimin dhe funksionimin, shpërblimet e veçanta për punonjësit dhe niveli i tarifave të shërbimeve që ofrohen nga institucionet përgjegjëse për studimin e

- fizibilitetit dhe oponentin e kontratave të performancës energjetike, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.
9. Vendimi për përdorimin e kontratës EPC merret duke u bazuar në rezultatet e studimit të fizibilitetit, duke marrë në konsideratë realizueshmërinë teknike dhe ekonomike të masave për rritjen e performancës.
  10. Autoriteti kontraktues përgatit dokumentet e tenderit në përputhje me legjislacionin për prokurimin publik dhe modelin standard EPC.
  11. Procedura e përzgjedhjes zhvillohet sipas legjislacionit për prokurimin publik dhe ofertat vlerësohen mbi bazën e:
    - a) nivelit të kursimeve të garantuara;
    - b) kostos dhe përfitimeve ekonomike;
    - c) elementeve teknike dhe financiare.
  12. Autoriteti kontraktues zgjedh ofertën ekonomikisht më të favorshme dhe lidh kontratën EPC me operatorin ekonomik të shpallur fitues.
  13. Operatori ekonomik realizon investimin dhe masat për përmirësimin e performancës së energjisë dhe mban përgjegjësinë për operimin, mirëmbajtjen dhe arritjen e kursimeve përgjatë gjithë kohëzgjatjes së kontratës.
  14. Kursimet e energjisë monitorohen dhe verifikohen gjatë gjithë kohëzgjatjes së kontratës dhe pagesat ndaj operatorit ekonomik kryhen në funksion të kursimeve të verifikuara të energjisë.
  15. Ndryshimet në kontratën e performancës energjetike lejohen vetëm nëse nuk ndryshojnë kushtet thelbësore mbi bazën e të cilave është përzgjedhur operatori ekonomik, nuk ndryshojnë natyrën e pagesës së lidhur me kursimet e energjisë dhe nuk krijojnë detyrime të pakushtëzuara buxhetore.
  16. Në përfundim të kontratës, autoriteti kontraktues merr në dorëzim masat dhe pajisjet e realizuara.
  17. Rregullat e detajuara për lidhjen dhe zbatimin e kontratave të performancës energjetike miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave me propozimin e ministrit përgjegjës për energjinë.

## **Neni 50**

### **Marrëveshjet vullnetare**

1. Marrëveshjet vullnetare lidhen ndërmjet konsumatorëve të mëdhenj të energjisë, bizneseve të vogla dhe të mesme industriale dhe pronarëve të ndërtesave me kompanitë e shërbimeve energjetike, sipas modelit të marrëveshjes së propozuar nga agjencia përgjegjëse për eficientësinë e energjisë dhe miratuar nga ministri përgjegjës për energjinë.
2. Marrëveshjet vullnetare kanë për qëllim mbështetjen e zbatimit të masave dhe aktiviteteve të eficientësinë e energjisë, për arritjen e objektivave kombëtare të sektorëve që mbulon eficientësinë e energjisë, si dhe të objektivave specifike të përcaktuar në marrëveshje.
3. Marrëveshjet vullnetare janë transparente, jodiskriminuese dhe të përmbajnë të paktën:
  - a) objektivat specifike dhe detyrimet e çdo subjekti për zbatimin e masave të eficientësinë e energjisë;
  - b) mënyrat dhe veprimet mbështetëse për arritjen e objektivave dhe zbatimin e masave të eficientësinë e energjisë;
  - c) metodologjinë që zbatohet për vlerësimin e kursimeve dhe të objektivave specifike;
  - ç) të drejtën e agjencisë përgjegjëse për eficientësinë e energjisë për monitorimin dhe

- vlerësimin e masave të efikasitetit të energjisë dhe detyrimin e palës tjetër për raportim;
- d) sanksionet në rast të mospërbashkimit të detyrimeve dhe procedurat e zgjidhjes së marrëveshjes.
4. Agjencia përgjegjëse për efikasitetin e energjisë ose çdo palë e tretë e pavarur dhe e emëruar nga kjo e fundit mund të marrë përsipër të kryejë një vlerësim të kostos dhe të përfitimit për marrëveshjen e propozuar vullnetare, në mënyrë që të konfirmojë se masat për efikasitetin e energjisë janë me kosto optimale, në përputhje me praktikën më të mirë ndërkombëtare.
  5. Agjencia përgjegjëse për efikasitetin e energjisë ndërmerr aktivitete për rritjen e shkallës së ndërgjegjësimit për përfitimet nga marrëveshjet vullnetare dhe nxit subjektet e mundshme të marrin pjesë në këto marrëveshje.

## **KREU X DISPOZITA HORIZONTALE**

### **Neni 51**

#### **Skemat e kualifikimit, akreditimit dhe certifikimit**

1. Ministria përgjegjëse për energjinë merr masa për miratimin e skemave të certifikimit dhe kualifikimit, përfshirë programet e trajnimit, për profesionet që lidhen me efikasitetin e energjisë, në bashkëpunim me institucionet përkatëse dhe partnerët socialë, si dhe në përputhje me nevojat e tregut.
2. Nga përcaktimet e pikës 1 të këtij neni, përjashtohen audituesit e energjisë në ndërtesa, industri dhe transport, ofruesit e shërbimeve të energjisë (ESCO) dhe vlerësuesit e sistemeve teknike, të cilët rregullohen me akte nënligjore të veçanta, në përputhje me këtë ligj.
3. Skemat e kualifikimit dhe certifikimit hartohen, miratohen dhe zbatohen në përputhje me legjislacionin në fuqi për akreditimin dhe standardizimin.
4. Informacioni mbi skemat e certifikimit dhe programet e trajnimit bëhet publik dhe i aksesueshëm për të gjithë palët e interesuara nga agjencia përgjegjëse për efikasitetin energjetike.
5. Ministria përgjegjëse për energjinë nxit pjesëmarrjen në skemat e certifikimit dhe programet e trajnimit dhe siguron që ato të jenë të aksesueshme në mënyrë të barabartë dhe pa diskriminim.
6. Skemat e certifikimit dhe programet e trajnimit bazohen në standardet përkatëse evropiane dhe ndërkombëtare, kur ato janë të disponueshme.
7. Ministria përgjegjëse për energjinë vlerëson periodikisht nëse këto skema garantojnë nivelin e nevojshëm të kompetencave, përmbushin nevojat e tregut dhe identifikon boshllëqet ndërmjet kërkesës dhe ofertës për profesionet përkatëse.

### **Neni 52**

#### **Monitorimi dhe adresimi i barrierave të efikasitetit energjetike**

1. Agjencia përgjegjëse për efikasitetin energjetike monitoron zbatimin e politikave dhe masave për efikasitetin energjetike dhe identifikon dhe vlerëson barrierat rregullatore dhe jorregullatore që pengojnë zbatimin e tyre.
2. Agjencia përgjegjëse për efikasitetin energjetike bashkëpunon me institucionet publike,

entet rregullatore, autoritetet kontraktore dhe palët e interesuara për identifikimin dhe adresimin e barrierave në të gjithë sektorët.

3. Në kuadër të pikës 1 të këtij neni, agjencia përgjegjëse për efikasitetin energjetik identifikon dhe vlerëson barrierat që:
  - a) burojnë nga legjislacioni në fuqi, kuadri rregullator, praktikat administrative dhe instrumentet financiare, të cilat pengojnë përmirësimin e efikasitetit energjetik dhe zbatimin e parimit “efikasiteti energjetik në krye”;
  - b) pengojnë integrimin e parimit “efikasiteti energjetik në krye” në planifikimin, politikën dhe vendimmarrjen për investime, përfshirë mungesën e metodologjive, kapaciteteve institucionale dhe procedurave përkatëse;
  - c) lidhen me prokurimin publik, buxhetimin dhe kontabilitetin vjetor, të cilat kufizojnë realizimin e investimeve për efikasitetin energjetik, përdorimin e kontratave të performancës energjetike dhe financimin nga palë të treta;
  - ç) lidhen me ndarjen e kostove dhe përfitimeve ndërmjet palëve, përfshirë pronarët dhe qiramarrësit, si dhe bashkëpronarët e ndërtesave;
  - d) pengojnë zhvillimin e tregut të shërbimeve energjetike dhe përdorimin e zgjidhjeve që përfshijnë veprime që rregullojnë konsumin energjetik të konsumatorëve fundorë sipas nevojave të sistemit;
  - dh) kufizojnë ushtrimin e të drejtave të konsumatorëve fundorë dhe përdoruesve fundorë në tregun e energjisë;
  - e) pengojnë përdorimin e nxehtësisë së mbetur dhe zgjidhjeve të tjera për përmirësimin e efikasitetit energjetik në sistemet energjetike.
4. Agjencia përgjegjëse për efikasitetin energjetik harton dhe i paraqet çdo vit ministrisë përgjegjëse për energjinë një raport që përfshin:
  - a) barrierat rregullatore dhe jorregullatore të identifikuara;
  - b) vlerësimin e ndikimit të tyre në konsumin e energjisë, efikasitetin energjetik dhe sistemet energjetike;
  - c) vlerësimin e zbatimit dhe përfitimeve si rezultat i parimit “efikasiteti energjetik në krye” në sistemet energjetike, veçanërisht në lidhje me konsumin e energjisë;
  - ç) rekomandime për adresimin e barrierave të identifikuara.
5. Agjencia përgjegjëse për efikasitetin energjetik merr masat e përshtatshme për të mbështetur një dialog shumëpalësh ndërmjet partnerëve përkatës, si autoritetet vendore dhe rajonale, partnerët socialë, organizatat e pronarëve dhe qiramarrësve, organizatat e konsumatorëve, shpërndarësit e energjisë ose shoqëritë e shitjes me pakicë të energjisë, shoqëritë e shërbimeve energjetike (ESCO), komunitetet e energjisë së rinovueshme, komunitetet energjetike qytetare, si dhe autoritetet dhe agjencitë publike, me qëllim hartimin e propozimeve për masa, stimuj dhe udhëzime të dakorduara bashkërisht që lidhen me adresimin e ndarjes së përfitimeve dhe kostove ndërmjet pronarëve dhe qiramarrësve ose ndërmjet pronarëve të një ndërtese apo njësie ndërtese.
6. Ministri përgjegjës për energjinë miraton formatin dhe përmbajtjen minimale të raportit vjetor për efikasitetin e energjisë.
7. Ministria përgjegjëse për energjinë, mbi bazën e raportit sipas pikës 4 të këtij neni:
  - a) propozon masat e nevojshme për heqjen ose reduktimin e barrierave të identifikuara, përfshirë ndryshime në kuadrin ligjor dhe nënligjor;
  - b) integron masat e propozuara në politikën, strategjitë dhe dokumentet përkatëse kombëtare;
  - c) përfshin informacionin për barrierat dhe masat e ndërmarra në raportet kombëtare të energjisë dhe klimës dhe në detyrimet përkatëse ndërkombëtare.
8. Barrierat e identifikuara dhe masat për adresimin e tyre merren në konsideratë në hartimin dhe përditësimin e politikave, planeve dhe akteve ligjore dhe nënligjore në fushën e

energjisë dhe sektorët e ndërlidhur.

9. Ministria përgjegjëse për energjinë raporton tek Sekretariati i Komunitetit të Energjisë mbi masat e ndërmarra për adresimin e barrierave në përmirësimin e efikasitetit energjetik, në kuadër të raportimit periodik sipas dokumenteve kombëtare për energjinë dhe klimën dhe detyrimeve ndërkombëtare.
10. Në përputhje me pikën 9 të këtij neni, ministria përgjegjëse për energjinë raporton çdo detyrim të ndërmarrë nga republika e Shqipërisë që shkon përtej kontributit të dakordësuar në nivel të Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë.
11. Ministria përgjegjëse për energjinë, në bashkëpunim me Agjencinë përgjegjëse për Efikasitetin e Energjisë, Fondin, ministrinë përgjegjëse për financat, Bankën e Shqipërisë, Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare dhe institucionet e tjera përgjegjëse, mbledh dhe përpunon të dhënat e nevojshme për raportimin kombëtar mbi financimin e efikasitetit të energjisë.
12. Të dhënat sipas pikës 11 të këtij neni, përfshijnë të paktën:
  - a) investimet publike për efikasitetin e energjisë dhe financimin shtesë të mobilizuar prej tyre;
  - b) kreditë dhe produktet e tjera financiare të dhëna për masa të efikasitetit të energjisë;
  - c) programet kombëtare të financimit, skemat mbështetëse dhe praktikatat më të mira për financimin e efikasitetit të energjisë.
13. Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për energjinë miraton rregullat, metodologjinë, formatet e raportimit, periodicitetin, përgjegjësitë institucionale dhe mënyrën e aksesimit, mbledhjes, përpunimit dhe agregimit të të dhënave sipas pikës 11 të këtij neni. Këto rregulla hartohen duke marrë në konsideratë detyrimet ekzistuese të publikimit dhe raportimit të institucioneve financiare, përfshirë kërkesat për financimin e qëndrueshëm dhe raportimin e rreziqeve mjedisore, sociale dhe të qeverisjes, si dhe udhëzimet përkatëse të Komisionit Evropian dhe të Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë.

### **Neni 53**

#### **Faktorët e konvertimit dhe faktorët e energjisë primare**

1. Për qëllime të krahasimit të kursimeve të energjisë dhe konvertimit në një njësi të krahasueshme, vlerat kalorifike neto dhe faktorët e energjisë primare miratohen me urdhër të ministrit përgjegjës për energjinë.
2. Faktorët e energjisë primare përdoren kur kursimet e energjisë llogariten në terma të energjisë primare duke përdorur një qasje nga poshtë lart bazuar në konsumin përfundimtar të energjisë.
3. Në urdhrin sipas pikës 1, në mënyrë që të llogariten me saktësi kursimet që rezultojnë nga konsumi primar i energjisë përcaktohet koficienti:
  - a) për kursimet në kWh energji elektrike;
  - b) për kursimet në kWh të bartësve të tjerë të energjisë
4. Koficientët përcaktohen përmes një metodologjie transparente në bazë të rrethanave kombëtare, rajonale ose lokale që ndikojnë në konsumin primar të energjisë. Rrethanat duhet të jenë të vërtetuara, të verifikueshme dhe të bazuara në kritere objektive dhe jodiskriminuese.
5. Gjatë përcaktimit të koficientëve marret në konsideratë përzierja e energjisë e përfshirë në përditësimin e planeve të integruara kombëtare për energjinë dhe klimën.
6. Nëse koficientët devijojnë nga vlerat e paracaktuar, ministria përgjegjëse njofton koficientin e përdorur tek Sekretariati i Komunitetit të Energjisë së bashku me metodologjinë e llogaritjes dhe të dhënat themelore në ato përditësime dhe plane të mëvonshme.

## **KREU XI DISPOZITA TË FUNDIT**

### **Neni 54 Kundërvajtjet administrative**

1. Shkeljet e mëposhtme, kur nuk përbëjnë vepër penale, konsiderohen kundërvajtje administrative dhe dënohen si më poshtë:
  - a) Për mosplotësim të kërkesave të parashikuara në pikën 4, të nenit 11, të këtij ligji, palët e detyruara dënohen me gjobë administrative në masën 3 000 000 lekë;
  - b) Për mosplotësim të kërkesave të parashikuara në pikën 6, të nenit 11; pikën 1, të nenit 28; ose pikat 7 dhe 8, të nenit 29, të këtij ligji, subjektet përkatëse përgjegjëse dënohen me gjobë administrative në masën 2 000 000 lekë;
  - c) Për mosplotësim të kërkesave të parashikuara në pikën 2, të nenit 14; pikat 6 dhe 7, të nenit 17; pikën 3, të nenit 18; pikën 2, të nenit 28; ose pikën 3, të nenit 28, të këtij ligji, subjektet përkatëse përgjegjëse dënohen me gjobë administrative në masën 1 500 000 lekë;
  - ç) Për mosplotësim të kërkesave të parashikuara në pikën 5, të nenit 14; pikat 1 dhe 4, të nenit 15; pikën 1, të nenit 16; pikën 7, të nenit 18; pikat 1 dhe 11, të nenit 19; pikat 1, 2, 3 dhe 4, të nenit 20; pikat 1, 2, 3, 5, 6 dhe 8, të nenit 21; pikat 1, 4 dhe 8, të nenit 22; pikat 1, 6 dhe 7, të nenit 23; pikën 9, të nenit 28; ose pikën 1, të nenit 47, të këtij ligji, subjektet përkatëse përgjegjëse dënohen me gjobë administrative në masën 1 000 000 lekë.
  - d) Për mosplotësim të kërkesave të parashikuara në pikat 6, 7, 10, 11, 12 dhe 14, të nenit 14; pikën 3, të nenit 15; pikat 1, 10 dhe 12, të nenit 24; ose pikat 10 dhe 12, të nenit 27, të këtij ligji, subjektet përkatëse përgjegjëse dënohen me gjobë administrative në masën 500 000 lekë.
  - dh) Për mosplotësim të kërkesave të parashikuara në pikat 3 dhe 4, të nenit 16, të këtij ligji, menaxherët e energjisë dënohen me gjobë administrative në masën 100 000 lekë.
2. Në rast përsëritjeje të së njëjtës kundërvajtje administrative brenda dy viteve nga data kur vendimi për dënimin administrativ ka marrë formë të prerë, masa e gjobës administrative dyfishohet.
3. Vendosja e gjobës administrative nuk e përjashton subjektin nga detyrimi për të përmbushur kërkesën ligjore të papërmbushur, brenda afatit të përcaktuar në vendimin përkatës të organit kompetent.
4. Gjobat administrative sipas këtij neni vendosen nga agjencia përgjegjëse për eficientësi energjetike, përveç rasteve kur shkelja lidhet me subjekte të licencuara ose të rregulluara nga Enti Rregullator i Energjisë, në të cilin rast gjoba vendoset nga Enti Rregullator i Energjisë, sipas fushës së përgjegjësisë.
5. Për shkeljet e kryera nga audituesit energjetikë, menaxherët e energjisë ose ekspertët e certifikuar, përveç gjobës administrative, mund të zbatohen edhe masat e pezullimit ose revokimit të certifikatës, në përputhje me këtë ligj dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.
6. Shqyrtimi i kundërvajtjeve administrative, ankimi dhe ekzekutimi i vendimeve bëhen në përputhje me ligjin nr. 10 279, datë 20.5.2010, "Për kundërvajtjet administrative".
7. Të ardhurat e realizuara nga zbatimi i masave administrative, sipas këtij neni, derdhen në Buxhetin e Fondit.

## **Neni 55**

### **Akte nënligjore**

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave që, brenda 18 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të miratojë aktet nënligjore në zbatim të neneve 5 pika 5; 8 pika 3; 9 pika 9; 10 pika 3; 13 pika 2; 17 pika 3; 18 pika 1; 19 pika 9; 28 pika 6; 29 pika 14; 30 pika 11; 30 pika 12; 32 pika 5; 32 pika 13; 44 pika 2; 47 pika 3; 48 pika 7; 48 pika 9; 49 pika 8; 49 pika 17; dhe 52 pika 13, të këtij ligji.
2. Ngarkohet ministri përgjegjës për energjinë që, brenda 20 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të miratojë aktet nënligjore në zbatim të neneve 6 pika 13; 7 pika 2; 8 pika 15; 13 pika 13; 14 pika 12; 14 pika 13; 15 pika 8; 21 pika 4; 21 pika 7; 23 pika 3; 25 pika 11; 26 pika 2; 26 pika 6; 27 pika 3; 27 pika 6; 27 pika 11; 28 pika 4; 46 pika 3, shkronja “g”; 47 pika 7; 49 pika 6; 50 pika 1; 52 pika 6; dhe 53 pika 1, të këtij ligji.
3. Ngarkohet Enti Rregullator i Energjisë që, brenda 18 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të miratojë aktet nënligjore në zbatim të neneve 22 pika 2; 28 pika 12; 29 pika 6; dhe 29 pika 15, të këtij ligji.
4. Ngarkohet Kryeministri që, brenda 12 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, me propozim të ministrit përgjegjës për energjinë, të nxjerrë urdhrat për emërimin e anëtarëve të Bordit Drejtues të Fondit, në përputhje me nenin 32 pika 4 të këtij ligji, me qëllim funksionalizimin e Fondit.
5. Me qëllim zbatimin e dispozitave të këtij ligji në lidhje me Fondin Kombëtar për Eficiencën e Energjisë, Bordi Drejtues i Fondit miraton rregulloret e brendshme, manualët operacionale dhe procedurat e nevojshme për funksionimin e Fondit, brenda 6 muajve nga data e konstituimit të Bordit Drejtues, në përputhje me këtë ligj, statutin e Fondit dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.
6. Bordi Drejtues miraton, të paktën, rregulloret dhe aktet e brendshme në vijim:
  - a) kodin e etikës dhe parimet e përgjithshme të veprimtarisë së Fondit;
  - b) rregulloren për organizimin operacional të brendshëm të Fondit;
  - c) rregulloren e brendshme;
  - ç) rregulloren për përgatitjen dhe administrimin e buxhetit vjetor të Fondit;
  - d) rregulloren për kriteret e përshtatshmërisë, dokumentacionin, procedurat e verifikimit, trajtimin e parregullsive dhe masat korigjuese për projektet dhe përfituesit e mbështetur nga Fondi;
  - dh) rregulloren për përgatitjen, miratimin dhe shpalljen e thirrjeve për propozime;
  - e) manualët operacionale dhe procedurat e monitorimit, raportimit dhe verifikimit të rezultateve të projekteve të financuara nga Fondi;
  - ë) rregullore dhe vendime të tjera të brendshme, sipas nevojës, në përputhje me këtë ligj, statutin e Fondit dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.
7. Përveç sa më sipër, Bordi Drejtues miraton dhe shpall, sipas rastit, thirrjet për propozime për produktet, programet ose instrumentet specifike të Fondit.

## **Neni 56**

### **Dispozita kalimtare**

1. Aktet nënligjore, që janë miratuar në përputhje me ligjin nr. 124/2015, datë 12.11.2015, “Për Eficiencën e Energjisë” i ndryshuar, qëndrojnë në fuqi nëse nuk bien ndesh me këtë ligj ose deri kur të zëvendësohen nga akte të tjera nënligjore respektivisht këtij ligji.
2. Ministria përgjegjëse për energjinë, në bashkëpunim me institucionet përkatëse, siguron mbledhjen dhe raportimin vjetor të të dhënave mbi prodhimin e energjisë elektrike dhe nxehtësisë nga kogjenerimi me eficiencë të lartë dhe të ulët, në raport me prodhimin total

të energjisë elektrike dhe nxehtësisë tek Sekretariati i Komunitetit të Energjisë. Raportimi përfshin gjithashtu të dhëna mbi kapacitetet e instaluara dhe karburantet e përdorura për kogjenerimin, si dhe mbi prodhimin dhe kapacitetet e sistemeve të ngrohjes dhe ftohjes qendrore.

3. Ministria përgjegjëse për energjinë siguron gjithashtu raportimin e kursimeve në energjinë primare të arritura nga përdorimi i kogjenerimit, në përputhje me metodologjinë e miratuar.
4. Institucionet përgjegjëse, përfshirë Fondin Kombëtar për Efiçencën e Energjisë, marrin masa për të lehtësuar krijimin dhe përdorimin e mekanizmave financiarë për mbështetjen e masave të përmirësimit të efiçencës së energjisë.
5. Këta mekanizma synojnë maksimizimin e përfitimeve nga kombinimi i burimeve të ndryshme të financimit, përfshirë grantet, instrumentet financiare dhe asistencën teknike.
6. Me aderimin e Shqipërisë në Bashkimin Evropian, Sekretariati i Komunitetit të Energjisë zëvendësohet nga Komisioni Evropian, Komuniteti i Energjisë zëvendësohet nga vendet anëtare të Bashkimit Evropian.

### **Neni 57** **Shfuqizime**

Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, ligji nr 124, datë 12.11.2015 “Për Efiçencën e Energjisë”, i ndryshuar, së bashku me nenin 26 të ligjit 27/2025 “Për Performancën Energjetike të Ndërtesave”, shfuqizohet.

### **Neni 58** **Hyrja në fuqi**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare